

PËRGJEGJËSIA E INTELEKTUALIT



Dija është elementi kryesor, e cila e dallon njeriun prej krijesave të tjera. Njeriu lind inorant, mirëpo me kalimin e kohës mëson dhe e largon nga vetja këtë ves. Aq sa më shumë mëson njeriu, aq edhe më lart ai do të ngjitet. Aq sa më shumë di njeriu, po aq edhe përgjegjësitë e tij rriten. E kur flasim për fenë, atëherë ata që e mësojnë fenë dhe ata që flasin në emër të fesë, përgjegjësitë edhe më shumë iu shtohen atyre, kjo për disa arsye:

Mundësia e gabimit në atribuimin e disa qëndrimeve Fesë.

Mundësia e heshtjes të disa gjërave të rëndësishme nga Feja.

Mundësia e keqkuptimit të gjërave që i sqaron Feja.

Mundësia e gabimit në përzgjedhjen e mënyrës së komunikimit me masën, sidomos masën tonë, e cila për një kohë të gjatë ka jetuar nën komunizëm e ateizëm dhe akoma infrastruktura e informacionit të tyre është kryesisht ateiste dhe jofetare.

Për këtë shkak dijetarët në përgjithësi dhe ata të fesë në veçanti e kanë detyrë të veçantë sqarimin e qëndrimeve fetare dhe mos heshtjen e tyre, sidomos të gjërave që kanë të bëjnë me elemente themelore të besimit, sepse për këtë edhe janë zotuar: **“Dhe kur Allahu mori zotimin nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithqysh t’ua publikoni atë njerëzve, e të mos e fshihni, por ata e lanë pas dore atë për pak send të kësaj jete; pra, bënë punë të keqe”**. (Ali Imran: 187).

Kurse ata që e thyejnë këtë zotim dhe nuk janë në nivelin e përgjegjësisë, të cilën e kanë marrë automatikisht me nxënien e dijes dhe arritjen e gradave të larta në dije i gjen ajo që na tregohet nga Allahu, në Kuranin Fisnik: **“Për shkak se ata e thyen zotimin e tyre, Ne i mallkuam ata dhe zemrat e tyre i bëmë të forta (të shtangura). Ata i ndryshojnë fjalët nga domethënia e tyre dhe braktisën një pjesë me të cilën ishin urdhëruar. Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një pjese të tyre, përpos një pakice nga ata. Pra, falju dhe hiqju tyre. Allahu i do ata që bëjnë mirë.”** (Maide: 13).

Intelektuali i vërtetë nuk guxon as t’i shtrembërojë faktet për të fituar lëvdata ose duartrokitje, por ai duhet t’u mbetet besnik parimeve shkencore dhe argumenteve mbi të cilat ndërtohet feja, në emër të së cilës flet.

Çdo intelektual që mundohet ta kryejë detyrën e tij sinqerisht dhe përgjegjësinë që ka marrë përsipër, e në këtë rast dijetarët e Fesë Islame, të cilët këtë përgjegjësi e kanë marrë nga Allahu Fuqiptotë, ata do të ballafaqohen me sfida dhe peripeci, me kurthe dhe lajka, mirëpo duhet ta kenë vazhdimisht parasysh këtë porosi hyjnore: **“Dhe kështu (sikurse edhe ty) çdo pejgamberi i bëmë armiq disa nga njerëzit dhe nga xhinët e djallëzuar, që me fjalë të shkëlqyeshme në mënyrë të fshehtë nxisin njëri-tjetrin në mashtrime. E sikur të donte Zoti yt, ata nuk do ta bënin atë (armiqtësi), po ti lëri ata me ato trillime. Dhe që të anojnë (tek ato fjalë mashtruese) zemrat e atyre që nuk besojnë botën e ardhshme dhe që të kënaqen e ngarkohen me atë që janë duke u ngarkuar (ty nuk të dëmtojnë asgjë). (Thuaj) A pos Allahut të kërkoj unë gjykatës (mes meje dhe juve)? Kur Ai është i zbritur prej Zotit tënd saktësisht, pra, mos u bëj prej atyre që dyshojnë. Fjalët e Zotit tënd janë plot të vërteta (për ato që lajmërojnë) dhe plot të drejta (për ato që gjykojnë). S’ka kush që të ndryshojë fjalët (vendimet) e Tij. Ai është që dëgjon e di. Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuesë që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e Allahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë. S’ka dyshim, Zoti yt e di më së miri për atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai është më i dijsmi për të udhëzuarit”**. (Enam: 112- 117).

Është e vërtetë se këto porosi Allahu Famëmadh ia ka dhënë Muhamedit, sallallahu alejhi ue selem, mirëpo ato vlejnë për çdo njeri, i cili mundohet të ketë rol konstruktiv në ndërtimin e popullit dhe të shoqërisë së vet.

Përgjegjësia e dijes na jep edhe një detyrë e obligim, e kjo është që çdo intelektual dhe hoxhë duhet t’i ndërtojë prioritetet e aktivitetit të tij, të cilat duhet t’i mbështesë në bazë të parimeve themelore të fesë dhe në bazë të nivelit të dijes që ka populli i vet dhe duke pasur parasysh çdo herë gatishmërinë e qarqeve të caktuara për të nxjerrë nga konteksti fjalët dhe idetë, qëndrimet dhe veprimet. E gjitha kjo që mos t’i lejojmë, smirëzinjtë e këqij shteg për të sulmuar figurat e rëndësishme të popullit tonë.

Dija e mirëfilltë dhe durimi i fuqishëm e bëjnë njeriun prijës, edhe pse mund të zgjasë pak kohë kjo gjë!

Në emër të redaksisë: Bekir HALIMI

AKTUALE

Njëvjetori i pavarësisë...

Kosova mes njohjes së perëndimit dhe mosnjohjes së arabëve **3-6**

Intervistë ekskluzive me imamin e njohur nga Shqipëria, Ahmed KALAJA

“Bashkoni zërin tuaj me ne” **7-9**

Projekti i parë i “Qendrës Shqiptare për Studime Islame” **10**

KËNDI IM

Mësoje Kuranin, pastaj tjerat **11-13**

Festimi i mevludit dhe kultura e imitimit **14-17**

Bëhu dhe mos u bëj **18**

AKIDE

Njihe Allahun **19-21**

FIKH

Kriza botërore financiare

Mësime dhe përvoja nga ekonomia kapitaliste pa moral **22-28**

Lënia e namazit - kufër i vogël apo i madh? **29-32**

AVANCIMI PERSONAL

Ku gjendesh tani? **33-37**

LIBRI

Namazi dhe dispozita për lënësin e tij **38-39**

FAMILJA

Për kë do të votoni o prindër! **40-42**

Si ti edukojmë fëmijët që ta duan namazin **43-45**

TEFSIR

“Fale namazin” Urdhër nga Allahu **46-47**

HADITH

“A e dëgjon ezanin, atëherë përgjigju!” **48-52**

FETVA DHE KONSULTIME

Rrreth namazit **53-55**

HISTORI

Metodologjitë bashkëkohore në shkrimin e historisë së perandorisë osmane **56-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor

Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI, Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI, Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: revista@albislam.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

Xhironlogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com

NJËVJETORI I PAVARËSISË...



KOSOVA MES NJOHJES SË PERËNDIMIT DHE MOSNJOHJES SË ARABËVE

Shkaqet e përkrahjes së SHBA-ve, duke pasur parasysh çudinë e madhe për këtë përkrahje, parashtrohet pyetja: përse SHBA-të e përkrahin pavarësinë e Kosovës? Çfarë përfitimi kanë ata në këtë rast?

ABDULLAH XHIBRIL

Para pak ditësh ishte njëvjetori i pavarësisë të Republikës së Kosovës, një ish-krahinë autonome e ish-Jugosllavisë, akoma s'është njohur arbitrarisht nga arabët, edhe pse pavarë-

sinë e vet e ka shpallur më 17 shkurt 2008, dhe shumica e banorëve të saj janë muslimanë. Ky realitet i hidhur i ka shtyrë që rreth pesëdhjetëmijë muslimanë të Shqipërisë të nënshkruajnë një petition dhe t'ia drejtojnë Konferencës Islamike, me shpresën që t'i inkurajojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës.

Agim Baçi një nga nënshkruesit e petitionit thotë: “Ne si muslimanë jemi të befashuar shumë me faktin se bota arabe deri tashti nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Ne jemi të bindur se shteteve të cilat në vitin 1999 i kanë ofruar popullit të Kosovës ndihma të ndryshme vëllazërore, duhet t’ju drejtojmë një kërkesë për njohje”.

Në luftën e egër, të cilën ndërmori Serbia kundër Kosovës në vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, arabët u rreshtuan në anën e Kosovës. Saudianët, kuvajtianët dhe emiratit organizuan aksione të mëdha për ofrimin e ndihmave banorëve të Kosovës. Gjithashtu egjiptianët dhe jordanezët ndihmuan në ndërtimin e forcave të rendit dhe sigurisë. Pas shpalljes së pavarësisë, të gjitha shtetet arabe dhe islame dërguan urime të përzemërta.

Gjer tani pavarësinë e Republikës së Kosovës e kanë njohur 55 vende, ku shumicën e përbëjnë shtetet e Bashkësisë Evropiane, duke shtuar edhe SHBA-të. Shtetet arabe dhe islame ngelën në urime dhe përhëndetje, me përjashtim të katër shteteve prej 57 shteteve muslimane, e ato janë: Turqia, Afganistani, Shqipëria dhe Senegali. Ndërsa nga vendet arabe; i vetmi shtet i cili e ka njohur Kosovën është shteti i Emirateve të Bashkuara Arabe!!

Përkundër mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës, Arabia Saudite ka marrë pjesë në konferencën e donatorëve më 11 korrik 2008 në kryeqytetin e Belgjikës, në Bruksel dhe me këtë rast janë mbledhur rreth një miliard e 200 milion €. Në këtë konferencë Arabia Saudite është radhitur në vendin e pestë me 32 milion euro, ndërsa Bashkimi Evropian ishte e para me shumën e afërsisht me gjysmë miliard euro.

Qëndrimi negativ i arabëve ndaj pavarësisë së Kosovës këta muajt e fundit

“Qëndrimi negativ i arabëve ndaj pavarësisë së Kosovës këta muajt e fundit ka lënë gjurmë tek udhëheqësit kosovarë dhe tek populli...”

ka lënë gjurmë tek udhëheqësit kosovarë dhe tek populli. Zyrtarët kosovarë këtë hap politik të lidërshiptit të vendeve arabe dhe islame e shpjegojnë si frika e tyre nga shqetësimi i Rusisë. Por këta zyrtarë thonë se shkak i diplomacisë serbe në kryeqytetet e vendeve arabe dhe islame, me qëllim që t’i kthejnë nga akti i njohjes së pavarësisë së Kosovës, duke pasur parasysh edhe ndihmën e aleatit të tyre të madh – Rusisë – në planin diplomatik.

Dr. Rexhep Boja, ish-myfti i Kosovës dhe i ngarkuari i Qeverisë së Kosovës si përfaqësues në vendet arabe, e bën të pamundur ekzistencën e çfarëdo shenje apo argumenti të njohjes së afërt të pavarësisë nga ana e shteteve arabe dhe islame. Dr. Boja thotë: “Si duket, shtetet arabe dhe islame janë të angazhuar me çështje të tjera, probleme të cilat tash po i preokupojnë dhe nuk lejojnë që të pranohet ngutshëm pavarësia e Kosovës.”

Ai vazhdon dhe thotë: “Ata (arabët) mendojnë se çështja e Kosovës ka përfunduar me vetë aktin e shpalljes së pavarësisë, ndërsa nga këndi i vështrimit të tyre, çështja e njohjes nuk është çështje e dobishme ose e mirë, përkundrazi mund të ndodhë që vonesa të jetë më e dobishme për Kosovën”.

Shkaqet e përkrahjes së SHBA-ve, duke pasur parasysh çudinë e madhe për këtë

përkrahje, parashtrohet pyetja: përse SHBA-të e përkrahin pavarësinë e Kosovës? Çfarë përfitimi kanë ata në këtë rast?

Sigurisht se nuk dihet i tërë plani amerikan për ndaljen e shtrirjes së Rusisë në Ballkan, dhe pengimi i vendosjes së sistemit mbrojtës raketor rus në rajon, si kundërpërgjigje ndaj sistemit mbrojtës raketor amerikan në Evropën Lindore.

Mirëpo disa analistë, njohës të mirë të Ballkanit, thonë se përkrahja e madhe e SHBA-ve e pavarësisë bëhet me qëllimin e depërtimit dhe shtrirjes më të madhe politike dhe ushtarake në zemër të Evropës.

Qëndrimi i Rusisë; Rusia nuk mund të rrijë duarkryq ndaj pranisë amerikane në këtë formë në rajon. Për këtë shkak ajo do ta kundërshtojë me gjithë fuqinë e saj pavarësinë e Kosovës. Dhe kjo ndodh jo për shkak të dashurisë ndaj Serbisë, por duke iu frikësuar goditjeve politike dhe ushtarake. Më primare është frika nga ndërmarrja e hapave nga ana e amerikanëve dhe evropianëve me të cilat kalohet vija e kuqe dhe rrezikohet siguria kombëtare e Rusisë, veçanërisht me praninë e forcave të NATO-s në rajon. Kështu Rusia e sheh pavarësinë e Kosovës, si fitore strategjike të SHBA-së në rajonin e Ballkanit, gjë e cila është në favor të amerikanëve dhe aleatëve evropianë.

Analistët politikë shtojnë se Rusia shqetësohet edhe nga mundësia e përhapjes së sindromës së Kosovës brenda Rusisë, si në Çeçeni dhe Dagestan. Këtë qëndrim e kanë edhe disa shtete tjera, të cilat kanë të njëjtën frikë, si Kina, India, Spanja, si dhe çdo shtet tjetër, i cili frikësohet nga shkapëputjet, që mund të ndodhin në vendet e tyre, duke u bazuar në arsyet kombëtare dhe historike.

Këta analistë veçojnë edhe një fakt:

lidhja historike mes Rusisë dhe Serbisë, gjë e cila e shtyn Moskën, që në rastin e pavarësisë së Kosovës, të veprojë sikur të ishte një çështje e brendshme ruse. Këta analistë thonë se duhet të kuptohen seriozisht kërcënimet e Rusisë për pengimin e pavarësisë së Kosovës. S'ka dyshim se Rusia ka mundësi ta bëjë këtë, sidomos duke i përdorur pasuritë e veta natyrore, në veçanti naftën dhe gazin, me qëllimin e ndryshimit të baraspeshës së forcave me Perëndimin në përgjithësi, e me Bashkimin Evropian në veçanti.

Këtu duhet të shtohet edhe konsolidimi i marrëdhënieve me vendet kundërshtarë të Perëndimit, siç janë Irani dhe Koreja Veriore, si dhe ndërmarrja e hapave në ngritjen e këtyre marrëdhënieve në një nivel më të lartë, kështu që të arrihen pikat mbështetëse për mbrojtje të Rusisë, dhe për kundërshtimin e Perëndimit në rajone të ndryshme.

Analistët e çështjeve ushtarake theksojnë rëndësinë e forcave ushtarake ruse të ripërtërira, me një doktrinë të re ushtarake, me të cilën janë aftësuar që t'i përgjigjen kërcënimeve amerikane, e sidomos ndaj sistemit mbrojtës raketor. Gjithashtu Rusia i ka përkrahur aktivisht dhe i ka ndihmuar forcat secesioniste në Gjeorgji, aleate të Perëndimit. Fjala është për provincat e Osetisë Jugore dhe Abhazisë, ndarjen e të cilave nga Gjeorgjia e kundërshtojnë fuqimisht SHBA-të dhe BE-ja. Rusia në mënyrë të drejtpërdrejt i ka mbështetur ushtarakisht me "forcat e egra" Osetinë jugore dhe Abhazinë, mirëpo sigurisht se i druhet konflikteve të drejtpërdrejta me SHBA-të.

Prezenca e NATO-s në Kosovë.

Rëndësinë e Kosovës e dëshmon prania e rreth shtatëmbëdhjetë mijë ushtarëve të NATO-s nga vende të ndryshme, qysh nga

viti 1999. Prej këtyre rreth 2500 janë ushtarë amerikan, çka paraqet edhe numrin më të madh të ushtarëve. Këto forca e kanë ndihmuar UÇK-në në luftën për çlirimin e Kosovës. UÇK-ja pas luftës është zëvendësuar nga TMK-ja, e cila tashti po transformohet në FSK, forca të cilat do të aftësohen ta mbrojnë Kosovën nga rreziqet, të cilat do t'i kanosen nga Serbia. FSK do të ketë 2500 ushtarë të rregullt dhe 800 ushtarë rezervistë. Këta ushtarë do të armatosen me armatim të lehtë dhe roli kryesor i tyre do të jetë angazhimi në fatkeqësitë natyrore dhe mbrojtja e qytetarëve.

Kosova në disa rreshta.

Kosova e shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008, nëntë vite pas qeverisjes së vendit nga ana e Kombeve të Bashkuara, të cilët kanë ardhur në Kosovë pas aksionit të bombardimeve të Serbisë nga ana e NATO-s në vitin 1999, për të ndaluar sulmet e egra dhe barbare të serbëve kundër popullit musliman të Kosovës. Këto sulme janë ndërmarrë pas angazhimit paqësor në planin diplomatik të emisarit ndërkombëtar Marti Ahtisarit.

Kosova kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Jo shumë larg, në rajon janë edhe Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Rumania dhe Kroacia. Kosova nuk ka dalje në asnjë det, përveç përmes Shqipërisë fqinje. (Këto ditë është arritur marrëveshja me Qeverinë e Shqipërisë që t'i akordohet një port për të plotësuar nevojat e Kosovës sh.p.)

Kosova ka një madhësi prej 10,887 km², me rreth 2,300,000 banorë, prej të cilëve 92 % janë shqiptarë muslimanë, 5.3 % pakica serbe, dhe 2.7 % pakica të tjera.

Pas ardhjes së Osmanlinjve në vitin 1389, Kosova ishte pjesë e Shqipërisë. Dhe

kështu vazhdoi deri në Luftërat Ballkanike dhe me këtë rast Kosova pushtohet nga Serbia.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore Kosova, si pjesë e pushtuar e Serbisë hyri në kuadër të Federatës Jugosllave me dhunë, pa pëlqimin e kosovarëve. Këtë lidhje me Federatën Jugosllave e shkëputi Slllobodan Milosheviqi në vitin 1989, ku edhe e shkeli kushtetutën e Kosovës me tankse dhe e mbajti nën pushtim me hekur e zjarr. Në këto rrethana muslimanët e Kosovës u çuan në kryengritje të armatosur, ku u themelua Ushtria për Çlirimin e Kosovës. Kosovarët u munduan edhe me mjete paqësore, i mbajtën disa herë zgjedhjet shumëpartiake. Në zgjedhjet e vitit 1992 fitoi Ibrahim Rugova, por bota mbeti e shurdhër dhe askush nuk i pranoi këto zgjedhje. Dhe pastaj u ngrit populli i Kosovës me në krye UÇK-në, që ta ndalë kasaphanën e egër të Serbisë ndaj qytetarëve shqiptar të pambrojtur të Kosovës. Në këtë mënyrë bota filloi të kthejë kokën në drejtim të tragjedisë së madhe njerëzore në Kosovë, e cila rezultoi me sulmet ajrore të NATO-s kundër mizorëve të paskrupullt serbë, në mars të vitit 1999. Me këto sulme, Serbia u detyrua ta lëshojë Kosovën në qershor të po atij viti. Pas një farë kohe filluan bisedimet për statusin përfundimtar të ish-Krahinës Autonome të Kosovës. Këto bisedime përfunduan me shpalljen e pavarësisë, me përkrahjen e madhe të SHBA-së, BE-së, të përcjellur me kundërshtimin e fuqishëm të Serbisë, Rosisë dhe disa shteteve të tjera. ■

Përktheu dhe përshtati: Zeki ÇERKEZI

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME IMAMIN E NJOHUR NGA SHQIPËRIA, AHMED KALAJA

“BASHKONI ZËRIN TUAJ ME NE”

Nisma më e freskët e një xhamie të kryeqytetit në mbështetje të njohjes së Republikës së Kosovës nga Organizata e Konferencës Islamike në njëvjetorin e pavarësisë. “Ju dhatë ndihma për kosovarët e dëbuar me dhunë e tashti ngurroni të njihni pavarësinë”, ky ishte edhe apeli i organizatorëve.

SHKRUAN: ROALD HYSA

Shqiptarët përpiqen edhe një herë tjetër t’ju vijnë në ndihmë shtetit më të ri të globit, Kosovës, mu në prag të shpalljes së pavarësisë pas një viti. Një grup përfaqësuesish dhe besimtarësh të xhamisë “Dine Hoxha” në Tiranë kanë vendosur të ndihmojnë sipas mundësive të tyre për njohjen ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në një mënyrë të thjeshtë dhe origjinale: me një peticion të firmosur nga besimtarët myslimanë shqiptarë drejtuar Organizatës së Konferencës Islamike (OKI). Të hënën më dy shkurt ata vendosën në trotuarin para xhamisë së tyre në “Rrugën e Kavajës” një tavolinë të mbuluar me flamurin e Kosovës dhe disa formularë ku mund të

firmosnin të gjithë ata që donin ta përkrahnin nismën e tyre “Bashkoni zërin tuaj me ne”. Pas pak ditësh rezultati ka qenë befasues. Në formular veç emrit, mbiemrit dhe firmës, shënohet dhe profesioni. Larmia e tyre ishte e pakufishme: akademikë, profesorë, gazetarë, shkrimtarë, aktorë, avokatë, inxhinierë, ekonomistë, pensionistë, studentë, të papunë etj. Pranë tavolinës rrinin dy studentë që udhëzonin qytetarët, të cilët kanë kërkuar vazhdimisht sqarime. Ky formular ka treguar edhe një herë harmoninë fetare që mbizotëron te muslimanët, ku atë e kanë firmosur edhe të krishterë. Një pjesë e madhe e firmatarëve ka qenë edhe nga komuniteti futbollistik shqiptar, ku mund të veçojmë këtu klubin e futbollit “Tirana”, së bashku me njërin nga sponsorët e tij kryesorë, z. **Refik Halili**, klubet “Besa” dhe “Vllaznia” etj. Kjo



veprimtari është mbyllur më datë 15 shkurt me një konferencë për shtyp, si dhe ka përshëndetur aktori **Reshat Arbana** me rastin e njëvjetorit të pavarësisë së Kosovës dhe prof. **dr. Aleksandër Kocani**. Këto firma iu drejtuan sekretarit të përgjithshëm të OKI-t, prof. dr. **Ekmeludin Ihsanoglu** dhe vendeve të tjera të organizatës që nuk e kanë njohur ende Pavarësinë e Kosovës. Më 17 shkurt u mbush plot një vit nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe organizatorët e peticionit drejtuar OKI-it janë të habitur nga indiferenca e vendeve anëtare të saj, kur dihet që Kosova është një vend me shumicë muslimane. Përveç kësaj, ata shikojnë një mospërputhje mes qëndrimit të vendeve të OKI-it gjatë kohës që Kosova ishte në luftë dhe pas shpalljes së pavarësisë së saj. Pas gati dy javësh që ky peticion është deklaruar i hapur atë e kanë nënshkruar më shumë se 50,000 persona. Gjeografia e këtij peticioni është shtrirë edhe në qytete të tjera përveç Tiranës, si në Shkodër, Elbasan, Kavajë, Fier, Patos etj. Ndërkaq autoritetet kosovare përgatitën festimet e rastit nën masa të rrepta sigurie dhe do të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të shtuar numrin e njohjeve të Kosovës.

Kur shpërtheu e ashtuquajtura kriza e refugjatëve kosovarë, të cilët u detyruan të kalojnë kufirin me Shqipërinë për t'i shpëtuar politikës së spastrimit etnik të diktatorit serb S. Millosheviç, vendet arabe ngritën kampe të posaçme për t'i ushqyer e strehuar ata. Kujtojmë këtu se gjatë emergjencës së viteve 1998-1999 imami S. Tota dhe Këshilli i Xhamisë "Dine Hoxha" hapën dyert dhe strehuan rreth 100 vëllezër kosovarë, duke i ndihmuar gjithashtu me veshje dhe ushqime e deri sa i përcollën të ktheheshin tashmë në Kosovën e çliruar përfundimisht. Më poshtë po ju përcjellim një intervistë të shkurtër me imamin aktual të xhamisë "Dine Hoxha" të rrugës Kavajës në Tiranë, **Ahmed Kalaja**:

AlbIslam: Ku u bazuat për këtë nismë?

Kalaja: Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit Mëshiruesit

Së pari, dua t'ju shpreh përshtypjet më të mira të lexuesit shqiptar të mbarë trojeve shqipfolëse për punën tuaj me këtë revistë edukativo-kulturore, që i është gjendur kaq pranë këtij auditori të gjerë, i cili padyshim ka gjetur në te burimin e freskët për të shuar etjen.

Së dyti, do të filloj të trajtoj pyetjen tuaj:

Normalisht që Feja Islame ka lënë hapësira për akte të tilla, që janë në dobi të shoqërisë njerëzore apo që ofrojnë bamirësi. Gjithashtu parimet e fesë për trajtimin e situatave të caktuara dhe gjykimit mes dëmit dhe dobisë, dhe ekuilibrit mes dobive dhe dëmeve, gjithashtu shërbejnë si argumente të mjaftueshme fetare. Më konkretisht ne jemi të urdhëruar në fenë tonë të bashkëpunojmë për çdo gjë në të cilën ka mirësi, jemi të mirëorientuar, që me sa të mundemi t'iu sjellim dobi njerëzve. Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë për **Besëlidhjen e el-Fudulit** (paraislame): *"Nëse do të ribëhet, unë do të jem pjesë e saj"*. Zoti thotë në Kuran: **"O ju njerëz. Ne ju krijuam prej një mashkulli e një femre e ju bëmë popuj e fise, që ju të njiheni mes jush, padyshim më i miri në mesin tuaj është ai që është më i devotshëm".**

Lufta që i ka shpallur Islami racizmit qysh në djepin e tij, duke e eliminuar si fenomen në qytetërimin islam është më se e mjaftueshme si argument për rastin në fjalë, sepse duke i njohur ata ashtu siç duan të njihen, ose përndryshe do të biem në njërin nga simptomat e racizmit.

Ata janë vëllezërit tanë të një gjaku dhe duhet t'i ndihmojmë me sa kemi mundësi. Ky është një rast që duhet shfrytëzuar, për t'u bërë pjesë e lobizmave në interes të Kosovës, po ky tashmë i një ngjyre tjetër, i ngjyrës së parimeve fetare dhe mësimave hyjnore, që burojnë nga Kurani Famëlartë dhe Tradita

“...Ne duam të përçojmë një mesazh te popujt e këtyre vendeve, që ashtu siç ndihmuat me ndihma humanitare në aparteidin e Kosovës, tashmë duhet të ndihmoni edhe në njohjen e pavarësisë së saj...”

Profetike, që janë edhe baza e inspirimit të këtij organizmi (OKI) që shtjellohet në pikën e shtatë të aktit të themelimit të saj. Sigurisht nëse do t'i rendisnim argumentet fetare këtu, nuk do të na mjaftonte kjo intervistë.

AlbIslam: A mendoni se do të ketë efekte pozitive kjo nismë e juaja për të përcjellë zërin e shqiptarëve në OKI?

Kalaja: Kur ngrihet një nismë e tillë pavarësisht se zanafillën e ka nga xhamia dhe besimtarët e xhamisë “Dine Hoxha” ajo u shtri më gjerësisht duke përfshirë të gjitha xhamitë dhe jo vetëm kaq, ajo u kthye në një nismë të shoqërisë shqiptare (e një pjese të mirë), një nisme qytetare ku u bashkëngjiten besimtarë, akademikë, historianë, politikanë, studentë dhe një pjesë e mirë e shoqërisë civile, që unë përfitoj nga rasti t'i përshëndes dhe t'i falënderoj, e kjo do të thotë se edhe llogaritë për të arritur qëllimin janë bërë mirë.

Pikë së pari, ne nëpërmjet këtij akti duam të sensibilizojmë shoqërinë civile dhe qarqet ndikuese në vendimmarrje të këtyre vendeve. Së dyti, ne duam të përçojmë një mesazh te popujt e këtyre vendeve, që ashtu siç ndihmuat me ndihma humanitare në aparteidin e Kosovës, tashmë duhet të ndihmoni edhe në njohjen e pavarësisë së saj. Ndërkohë që ne jemi të sigurt, se kjo nuk është dëshira e këtyre popujve, pra,

mosnjohja e pavarësisë së Kosovës. Së treti, janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që kjo nismë të ketë jehonën e saj në mediet vizive apo të shkruara ndër më prestigjiozet në botën arabe, që të ketë efektin e saj pozitiv në proces. Së katërti, kemi kontaktuar me trupin diplomatik të akredituar në Tiranë të këtyre vendeve, që ndikimi të jetë sa më i prekshëm. Së pesti, kemi shfrytëzuar për konsulencë një pjesë e mirë e trupit diplomatik shqiptar të akredituar në këto vende. Janë shfrytëzuar studentët shqiptarë në këto vende për t'i bërë jehonë kësaj nisme atje me shoqërinë studentore dhe civile. Normalisht janë krijuar dhe kontaktet e para me këtë organizëm, OKI, të cilët kanë shprehur përkrahjen e tyre dhe marrjen në konsideratë të këtij fakti.

AlbIslam: A keni ndonjë mesazh për shqiptarët e Kosovës me rastin e njëvjetorit të shpalljes së pavarësisë?

Kalaja: Mesazhet janë shumë, por duke i përmbledhur mendimet e mia do të thosha duke iu drejtuar pjesës tjetër të trupit tonë që prehet tashmë sovran dhe i pavarur se:

Pavarësia e Kosovës ishte pjesë e pamohueshme e vullnetit të Zotit dhe për këtë Ai duhet falënderuar. Pavarësia nuk do të thotë çlirim ndaj besimit apo normave të tij apo rebelim ndaj dispozitave. Besimi edukon te njeriu vlera dhe kodin etiko-moral, që e përsosin jetën e tij në këtë botë shumë të trazuar dhe e lumturojnë atë. Populli i Kosovës duhet të ndjehet krenar për besimin që keni, ky besim është qytetari dhe emancipim, jo prapambetje dhe denigrim, besoj se të gjithë e kemi të freskët fjalimin e mbajtur nga presidenti i SHBA-së **Barak Husejn Obama**. Populli i Kosovës duhet t'i thotë lamtumirë një herë e përgjithmonë ateizmit, që është teoria më shterpe që ka pjellë ndonjëherë mendja njerëzore. Zoti na udhëzoftë të gjithëve në gjëra që e kënaqim Atë dhe derdhtë mbi ne bekimet e Tij.

PROJEKTI I PARË I “QENDRËS SHQIPTARE PËR STUDIME ISLAME”

“Qendra Shqiptare për Studime Islame” pranë shoqatës qytetare për afirmim “Bamirësia” dëshiron që të informojë lexuesit e revistës Albislam rreth një pune, të cilën ka filluar ta bëjë disa vite me radhë. Ky aktivitet paraqet përcjelljen e shtypit ditor, javor dhe mujor dhe regjistrimin e arkivimin e teksteve dhe informatave që kanë të bëjnë me Islamin, myslimanët dhe çështjet që ndërlidhen me këto probleme. Këtë vit ky sektor dëshiron që këtë aktivitet që e ka kryer vitin e kaluar ta ndajë me ju, duke i dhënë disa informata themelore në lidhje me atë që është arkivuar dhe duke i bërë me dije opinionit të gjerë, se këto materiale janë të arkivuara dhe secili që dëshiron të bëjë ndonjë studim në lidhje me këto që po flasim mund të shërbehet me to pas marrëveshjes me përgjegjësit e kësaj qendre.

Materialet e mbledhura janë në gjuhën shqipe dhe maqedonase, pjesa më e madhe janë në format dokumenti, kurse pjesa tjera e skanuar si fotografi.

Materialet janë mbledhur nga pjesa më e madhe e shtypit ditor, javor dhe mujor, që domethënë se nuk ka mbuluar të gjithë shtypin ditor brenda kufijve të Maqedonisë.

Këto janë gazetat dhe revistat, të cilat janë përcjellë brenda vitit të kaluar: gazetat “Lajm”, “Koha”, “Fakti”, “Shqip”, “Utrinski Vesnik”, “Vreme”, “Shpic”, “Dnevnik”, “Nova Makedonija”, “Veçer”, revistat “Forum” e “Fokus” dhe gazeta e revista të tjera, por në mënyrë sporadike.

Numri i materialeve që kemi

grumbulluar është më shumë se 810 tekste, që flasin për Islamin, muslimanët dhe temat që kanë të bëjnë me këto dy elemente, që tregon se interesimi për Fenë Islame, atë që ndodh me Fenë Islame dhe myslimanët në vend, rajon dhe botë zë një hapësirë goxha të madhe në mediet tona.

Nga ky aktivitet që kemi bërë vitin e kaluar mund të vijmë edhe deri te një konstatim tjetër e ai është se medias së shtypur maqedonase u funksionojnë shumë mirë vebfaqet e tyre dhe aty mund të gjejmë të arkivuara të tërë tekstet që janë përzgjedhur për arkivim, për dallim nga vebfaqet e shtypit shqip, të cilat nuk e kanë këtë nivel funksionimi. Pa dyshim se ky dallim, i cili është teknik, na tregon edhe nivelin e përgatitjes profesionale për të mbuluar ndonjë ndodhi apo rast. Ky konstatim vlen për shtypin në Maqedoni.

Sa për kuriozitet dhe për të ngjallur optimizëm, teksti i parë i cili është arkivuar në vitin 2008 është teksti me titull “Shamitë mbeten në pasaporta“. Ky titull vjen si rezultat i aktivitetit që bënë shumë aktivistë nën ombrellën e shoqatës së grave “Islami dhe shkenca” dhe pas këtij aktiviteti u rregullua dalja e grave myslimane me shamia në dokumentacionin e identifikimit, patentë shoferi dhe pasaportë.

Ky shkrim ishte vetëm sa për informim, kurse për planin detal dhe projektet që mund të realizohen këtë vit do të flasim në ndonjë rast tjetër. ■

Shërbimi informativ pranë “Bamirësia”

MËSOJE KURANIN, PASTAJ TJERAT



Sa i përket përpjekjes për të mësuar Kuranin përmendësh në fillim, atëherë kjo do të thotë t'i japësh përparësi mbi shumë gjëra që njerëzit mendojnë se janë dituri, por në të vërtetë ato janë plotësisht të kota, apo janë pak dobiprurëse

SHEJH EBU ENES HAMAD EL UTHMAN

Hudhejfe ka thënë: I Dërguari i Allahut, alejhi salatu ue selam, na rrëfente neve ngjarje. E kam parë një prej tyre dhe jam duke pritur për tjetrën. Ai alejhi salatu ue selam na ka informuar: *“Besnikëria ishte dërguar poshtë thellë në zemrat e njerëzve, pastaj ata e mësuan atë nga Kurani, pastaj e mësuan atë nga Suneti.”*¹

Hafidh Ibën Haxheri ka thënë: “Thënia e tij alejhi salatu ue selam: *‘atëherë ata e mësuan atë nga Kurani, pastaj e mësuan atë nga Suneti’* përsëritet në këtë transmetim me fjalën përsëritëse *‘pastaj’*, që tregon e kushtëzon, se ata duhet të mësojnë Kuranin para se të mësojnë hollësitë e Sunetit. Dhe me

hollësitë e Sunetit ka si qëllim çdo gjë që ata do të mësojnë nga i Dërguari alejhi salatu ue selam, qoftë ajo e detyrueshme apo e pëlqyeshme.”²

Mejmuni thotë: E kam pyetur Ebu Abdullahun, (Imam Ahmedin): Cila gjë është më e dashur te ju, që unë të filloj t'i mësoj djalit tim Kuranin apo hadithin? Ai tha: **“Jo! Kuranin.”** Unë thashë: a t'ia mësoj të gjithë Kuranin? Ai u përgjigj: “Po, përveç nëse është shumë e vështirë, në atë rast mësoja atij një pjesë të Kuranit”. Pastaj ai më tha: “Nëse ai fillon së pari të lexojë, pastaj do të mësojë leximin korrekt dhe do të këmbëngulë në të.”

Ibën Tejmije thotë: “Sa i përket përpjekjes për të mësuar Kuranin përmendësh në fillim, atëherë kjo do të thotë t'i japësh përparësi mbi shumë gjëra që njerëzit mendojnë se janë

¹ Përcjellë nga Buhariu (nr. 7086)

² Fet'hul Bari (13/39)

dituri, por në të vërtetë ato janë plotësisht të kota, apo janë pak dobiprurëse. Gjithashtu ajo do të thotë t'i japësh përparësi në mësim veçanërisht nga ata që dëshirojnë të marrin dituri të Fesë, parimet e saj dhe hollësitë e saj. Kështu që ajo me çka e këshillojmë një person në këtë kohë është se duhet të fillojë me mësimin përmendësh të Kuranit, si bazë e burimeve të diturisë fetare. Kjo është e kundërt me atë çfarë kanë vepruar disa persona në risi: ata u preokupuan me pjesët e panevojshme të diturisë, sikurse janë **Kelami** (apologjetika) dhe diskutimi; apo çështje shumë të rralla të ndryshimeve; dhe pasimi i verbër, që është i panevojshëm; apo hadithe shumë të rralla dhe të çuditshme, të cilat nuk janë të përforcuara, pa asnjë dobi; apo shumë polemika që nuk ofrojnë prova. Dhe ai e braktis mësimin përmendësh të Kuranit, që është më i rëndësishëm se të gjitha këto që u përmendën”.³

Muhamed b. Fadël thotë: “E kam dëgjuar gjyshin tim duke thënë: “I kërkova leje babait tim që të studioj në filan vendin, ndërsa ai më tha: “Së pari, mëso Kuranin dhe pastaj unë do të jap leje”. Kështu që e mësova Kuranin përmendësh. Pastaj ai më tha: “Qëndro derisa t'i udhëheqësh njerëzit me të në namaz (p.sh. në taravi)”. Kështu veprova dhe pas udhëheqjes në namaz ai më dha leje dhe unë u largova për në Marv”.

Ibën AbdulBerri thotë: “Kërkimi i diturisë ka nivele dhe faza të ndryshme, të cilave nuk guxon t'iu shmangesh. Kushdo që i kalon ato në tërësi, atëherë ai ka kaluar rrugën e Sahabëve dhe të atyre që i kanë ndjekur ata. Kushdo që merr qëllimisht një rrugë tjetër përveç kësaj ka devijuar seriozisht. Sidoqoftë kushdo që kalon direkt në ixhtihad⁴, atëherë ai person ka gabuar. Kështu që njohuria e parë është mësimi përmendësh i Librit të Allahut

dhe përpjekja për ta kuptuar atë. Dhe është e detyrueshme kërkimi i çdo gjëje që të ndihmon në të kuptuarit e tij. Sido që të jetë, unë nuk them se është e detyrueshme që të mësohet krejt Kurani përmendësh, por them se është e detyrueshme dhe esenciale për këdo që dëshiron të bëhet dijetar – jo se një gjë e tillë është e detyrueshme në vetvete.”

Hatib Bagdadiu thotë: “Është e përshtatshme për një student, që ai të fillojë me mësimin përmendësh të Kuranit Fisnik, që është burimi më i madh i diturisë dhe të cilin duhet ta vendosim në vend të parë dhe t'i jepet përparësi”.

Hafëz Neveviu thotë: “Gjëja e parë me të cilën personi duhet të fillojë është memorizimi i Kuranit Fisnik, i cili është burimi më i rëndësishëm i diturisë. Sahabët dhe ata që i pasuan ata nuk ia mësonin hadithin apo fikhun përveç atij që e kishte memorizuar Kuranin. Kur e kishte memorizuar Kuranin, e paralajmëronin personin që të mos e preokuponte veten me hadith, fikh apo gjëra të tjera, deri në atë nivel, saqë të harronte çdo gjë nga Kurani apo diçka e tillë.”

Kërkimi i diturisë me bazat e duhura

Allahu xhele shanuhu thotë: “**Dhe** (ta shpallëm) **Kuranin që Ne e ndamë pjesë - pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një.**” (Isra, 106).

I Dërguari, alejhi salatu ue selam, i tha Abdullah b. Amër b. Asit: “*Lexoje Kuranin në çdo muaj.*” Unë i thashë: mendoj se kam forcë për më shumë se kaq. Ai, alejhi salatu ue selam, i tha: “*Lexoje atë çdo njëzet net.*” Unë i thashë: mendoj se kam forcë për më shumë se kaq. Ai alejhi salatu ue selam tha: “*Atëherë lexoje atë në çdo shtatë ditë dhe mos shko më shpejt se kaq.*”⁵

Abdullah b. Amër b. Asi gjithashtu përcjell

³ El Fetava elKubra (2/54-55).

⁴ Ixhtihad quhet gjykimi i bazuar në dituri që merr një dijetar i kualifikuar në përpjekje për të arritur të vërtetën.

⁵ Përcjellë nga Buhariu (nr. 5052) dhe Muslimi (nr. 1159) dhe teksti është nga Muslimi

nga i Dërguari alejhi salatu ue selam se ka thënë: “Nuk e kupton Kuranin ai që e lexon atë në më pak se tri ditë”⁶

Omer b. Vahidi, shoqërues i Euzait thotë: E lexuam Muvetanë tek Imam Maliku për dyzet ditë dhe ai na tha: “Një libër që më mori dyzet vjet jetë për ta përpiluar, ju e merrni prej meje për dyzet ditë! Sa pak që kuptoni prej tij.”

Hatib Bagdadiu thotë: “Është më e përshtatshme për atë që kujdeset në kërkimin e diturisë të mos marrë shumë qysh në fillim. Më mirë të mësojë nga pak për çdo kohë, aq sa mund të mbartë, ta memorizojë dhe të jetë i aftë ta kuptojë atë, sepse Allahu thotë: “**E ata që nuk besuan thanë: “Përse të mos i ketë zbritur atij (Muhamedit) Kurani menjëherë?” Ashtu e zbritëm pjesë-pjesë, që me të ta forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajet pas ajeti** (dalëngadalë).” (Furkan, 32).

Hatibi gjithashtu thotë: “Dhe dije se zemra është njëri prej organeve. Është e aftë të mbartë diçka dhe e paaftë të mbartë diçka tjetër – ashtu sikurse edhe pjesët e tjera të trupit. Pra, disa njerëz janë të aftë të mbartin njëqind kilogramë, ndërsa të tjerët janë të paaftë të mbartin qoftë edhe njëzet. Disa njerëz janë të aftë të ecin shumë kilometra në ditë pa u lodhur, ndërsa të tjerët janë të paaftë të ecin qoftë edhe një kilometër në ditë para se të lodhen... kështu që çdo njeri le ta kufizojë veten në atë që ai është i aftë për të bërë, pa i shpenzuar të gjitha energjitë e tij, sepse do ta ndihmojë më shumë atë në mësim me një mendje të mirë, nga një mësues solid dhe kompetent.

Të lutesh për shtimin e diturisë

Allahu xhele shanuhu thotë: “**Thuaj: Zoti**

im, më shto diturinë!” (Taha, 114)

Umu Seleme thotë: I Dërguari i Allahut, alejhi salatu ue selam, lutej në namazin e sabahut: “*O Allah! Të lutem Ty për dituri të dobishme, furnizim të mirë dhe vepra të pranuar*”. Enes b. Maliku thotë: e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, alejhi salatu ue selam, duke u lutur: “*O Allah! Më furnizo me dituri. Më mëso atë që do të më bëjë dobi dhe më ruaj nga ajo dituri që nuk kam dobi*”.⁷

Ebu Bekr Muhamed b. Xhaferi thotë: Unë e kam dëgjuar Ibën Huzejmen kur e kanë pyetur: Nga e ke marrë këtë dituri? Ai tha: “I Dërguari i Allahut alejhi salatu ue selam ka thënë: “*Uji i Zemzemit është për atë që pihet*”. Kështu që kur unë e kam pirë ujin e Zemzemit i jam lutur Allahut për dituri të dobishme.”⁸

Shejhul Islam Ibën Tejmije thotë: “Realiteti i kësaj çështjeje është se robi bën dallim në atë se çfarë kërkon nga dituria dhe udhëzimi dhe ajo se çfarë ai dëshiron të arrijë. Kështu që me përkujtimin e Allahut dhe kthimin tek Ai, Allahu e udhëzon njeriun, siç thotë Ai: “*O Robërit e mi! Të gjithë ju jeni të humbur, përveç atyre që unë i udhëzoj. Pra, kërkon i udhëzimi nga Unë*.”⁹

Dhe siç thoshte i Dërguari i Allahut alejhi salatu ue selam: “*O Allah! Zoti i Xhibrilit, Mikailit dhe Israfilit. Krijuesi i qiejve dhe i tokës. I Dijshmi i të fshehtës dhe të dukshmes. Ti gjykon ndërmjet robit Tënd në atë që ai dallon. Kështu që më udhëzo në atë që ata janë kundërshtuar nga e vërteta – me lejen Tënde. Me të vërtetë, Ti udhëzon atë që dëshiron në rrugën e drejtë*.”¹⁰ ■

**Përktheu dhe përshtati nga anglishtja:
Besnik ABRASHI**

⁶ Sahih Sunen Ebi Davud nr. 1294

⁷ Përcjellë nga Hakimi (1/510) dhe ai ka thënë: “Është i vërtetë sipas kushteve të Muslimit.” Dhehebiu pajtohet gjithashtu.

⁸ Mexhmuul Fetava (4/39)

⁹ Sahihu Muslim (nr. 2577)

¹⁰ Sahihu Muslim (nr. 770)

FESTIMI I MEVLUDIT DHE KULTURA E IMITIMIT

Nga kjo pasqyrë që po bëjmë brenda këtyre pak rreshtave, pa bërë ndonjë koment të veçantë, shohim një dëshmi të qartë për shpërndarjen, copëtimin dhe përçarjen e trishtueshme që kapluan Umetin Islam, si rezultat i shndërrimit të Fesë në një zinxhir traditash. Kjo pasqyrë imponon vetveten në tërë vatanin e madh Islam, gjë e cila na thërret të mendojmë thellë për çështjen e traditave të shpikura në emër të Fesë

FERIDUDIN AYDIN¹

Prej frazave të përhapura te njerëzit është “me të jemi rritur dhe me të jemi plakur”. Kjo frazë i përshtatet disa veprave të muslimanëve, të cilat nuk ishin të njohura për brezat e parë. Ajo gjë të cilën shfrytëzuesit dhe shpërdoruesit e ushtronin kot e kot midis umetit, dhe me atë pastaj, gjatë çdo periudhe shumë koka mediokre e pasuan me padije dhe me imitim të verbër, saqë me kalimin e kohës thuajse e shndërruan në një fe të shtrembëruar, të njëjtën gjë po e hasim edhe sot me veshje të çuditshme, dhe pamje që nuk i ngjajnë aspak thelbit të pastër dhe të kulluar.

Me siguri Pejgamberi, salAllahu alejhi ue selem, e parashikonte këtë fund të keq dhe kishte frikë për njerëzit e tij, prandaj tha: *“Ai që do të jetojë më shumë, do të shohë shumë kundërshtime. Kujdes nga gjërat e shpikura, sepse ato janë devijim. Kush prej jush e arrin atë kohë, le t'i mbahet rrugës sime dhe rrugës së kalifëve të drejtë dhe të udhëzuar. Kapuni fort në*

*këtë rrugë me dhëmballë”.*²

E shpërdori kush e shpërdori Islamin – për ndonjë qëllim të tijin – pas shekullit të tretë nga hixhreti, dhe abuzuan shumë prej atyre që i mashtroi vetja, jo me veshjen e një armiku të qartë, por me metodën e një shoku me dredhi dhe një miku me tradhti. Çdoherë që abuzonin me shigjeta të helmuara pas shpine, riktheheshin me manovra të holla për t'i dhënë gjajret muslimanëve para fytyre.

Adeti i Mevludit është vetëm një nga format e abuzimit me Islamin, e që për herë të parë u shfaq në një nga periudhat më të errëta të historisë, gjegjësisht në periudhën e shtetit **Ubejdij**, në kohën e udhëheqjes së **Muiz Lidinal Fatimiut**. Në këtë periudhë ndodhën edhe shumë ndryshime medhhebore, që mëtonin të theksojnë epërsinë e **shiave fatimi** në Egjipt. Ezanit i kishin shtuar edhe këtë fjali: “Hajj alal hajril amel – Ejani në punën më të mirë”; rekatit të dytë në namazin e xhumasë i kishin shtuar edhe një lutje të veçantë (kunut); në hutben (ligjëratën) e ditës së xhuma do të shtonin fjalët: “O Allahu ynë, çoi bekimet e Tua

¹ Studiues nga Turqia

² Tirmidhiu në Sunenin e tij, tema: Dija nga Resulullahu, salallahu alejhi ue selem.



mbi Muhamedin e zgjedhur, mbi Aliun me të cilin jemi të kënaqur, mbi Fatimen e lartë, mbi nipat e Pejgamberit, Hasanin dhe Husejnin, nga të gjithë këta Ti e largove ndyrësinë dhe i pastrove mirë”.

Ndonëse **shteti ejubit** i anuloi këto bidate, **Memalikët** i dhanë shumë rëndësi, sidomos manifestimeve me moton: “Ditëlindja e Pejgamberit” dhe vepruan për përhapjen dhe rrënjosjen e tyre. Më vonë erdhën **osmanlinjtë**, të cilët i preferuan dhe iu pëlqyen këto veprime, por ndoshta e përvetësuan nga “epidemia” që mund të vinte si rezultat i raporteve të ngushta ndërmjet osmanlinjve dhe shtetit Memalik. Mirëpo festat e mevludit në shoqërinë osmane, përgjatë tre shekujve të parë të saj, as që përmendeshin përkundër rrethanave që ishin me të vërtetë të përshtatshme. Nga rrethanat më të fuqishme ishte përhapja

e shumë tregimeve nga jeta e Pejgamberit dhe dhimbjet e familjes së Pejgamberit, të cilat i rrëfenin tregimtarët gojarisht nëpër mexhliset dhe festimet që kishin. Këto tregime letrarët turq i kanë përmbledhur në formë proze dhe poezie. Nga ato libërthi më i njohur është **“Vesiletu Nexhat – Mjeti për shpëtim”** që e përpiloi poeti turk **Sulejman Çelebi** në qytetin Bursa në vitin 1409 G. Ajo është një poemë lirike në gjuhën turke, por me dialekt osman dhe përmban 800 vargje. Aty poeti përmend mrekullitë dhe lëvdatat e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem. Sot, nuk ka turk sunij, që në shtëpinë e tij të mos ketë një kopje të këtij libërthi, i cili është i botuar me shkronja latine, por edhe me shkronja arabe, megjithëse ajo e para është më e përhapur. Shumica e “lexuesve të mevludit” këtë poemë e dinë

përmendësh, sidomos anëtarët e “Shoqatës së Mevludit të Pejgamberit” të cilët janë të specializuar për këndimin e kësaj poeme gjatë manifestimeve. Ata janë një grup, të cilët ftohen nga familjet e pasura, qoftë në raste gëzimi apo pikëllimi.

Kjo poemë te turqit sunij gëzon të njëjtën pozitë që gëzon “el Burde” tek arabët sufij. Aty ka tejkalime kufijsh sikurse ato që gjenden tek “el Burde”. Fatkeqësia më e madhe është fakti se mevludi në imagjinatën e shumë turqve gëzon një pozitë jo më të ulët se Kurani Fisnik. Te mevludi ata gjejnë bekimin dhe faljen për të vdekurit e tyre. Këto që po themi mund të shihen qartë në lutjet e tyre, kur ata lexojnë:

“İlahi ya rabbi, okumuş olduğumuz bu mevlidi şeriften hasıl olan sevabı Sevgili peygamberimizin ve bütûn geçmişlerimizin ruhlarına hediye eyledik sen vasil eyle”.

“Sa sevabe që u bënë prej këtij këndimi, më të dobishmit të gjithë njerëzve dhe më të mirit të gjithë pejgamberëve, shefaatbërësit në ditë t’mahsherit, Muhamed Mustafas, mubarek shpirtit t’tij hedije ja bëjm”.³ Kjo është një shpikje⁴ për të cilin Allahu nuk ka zbritur ndonjë argument.

Ritualet e mevludit në Turqi

Festimi i ditës së mevludit bëhet nëpër xhami, aty vjen Muftiu i Turqisë, hoxhallarë, politikanë, biznesmenë dhe shumë njerëz të tjerë. Mirëpo deri tani nuk është dëgjuar asnjë prej hoxhallarëve turq t’i ketë bërë ndonjë studim kritik

“...Tradita e “ditës së mevludit” është një shenjë që përfaqëson qëndrimin sufi dhe njëkohësisht qëndrimin fanatik medhhebor...”

kësaj poeme, nga këndvështrimi i besimit të drejtë. Ndërsa poemën arabe “el Burde” shumë hoxhallarë të vendeve arabe e kanë studiuar dhe kanë sqaruar vendet ku është tepruar apo ku është kundërshtuar besimi i Njësimit (Teuhidit) në Islam. Kjo aludon se hoxhallarët në Turqi kanë vetëm njohuri sipërfaqësore lidhur me Teuhidin, por ndoshta kjo ka të bëjë edhe me faktin se arabishten e njohin dobët. Më anon mendimi se distanca fetare dhe gjuhësore në shoqërinë turke ishte pengesa më e madhe për të kuptuar plotësisht Islamin, që nga dita kur e përqaftuan këtë Fe, edhe pse të shprehurit e përkatësisë dhe të qenit krenarë me këtë Fe është shumë e theksuar nga ana e tyre. Po ashtu dashuria e madhe ndaj Kur’anit dhe Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, është e dukshme... Ky problem i madh, medoemos duhet të studiohet nga ana e asociacioneve të ndryshme shkencore dhe të hulumtohet në thelb nga këndvështrime të ndryshme, në mënyrë që të gjejë shkaqet, të cilat sollën edhe probleme tjera, që po mundojnë edhe sot botën islame.

Dita e Mevludit për të parën herë u festua në periudhën e **Sulltan Muratit të**

³ Përkthimi që solla është teksti original nga kjo lutje, që lexohet në trojet shqiptare dhe jo përkthimi tekstual i tekstit të mësipërm.

⁴ Shpikje këtu numërohet: të shpresosh sevape nga një poemë dhe të njëjtat t’ia dhurosh Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem.

Tretë (1574 G – 1595 G), i cili është sulltani i dymbëdhjetë në radhë nga osmanlinjtë. Ai, sipas historianëve specialistë neutralë, kishte një biografi jo të mirë. Prej ndodhive më të rëndësishme që flasin për këtë janë: që në ditën kur u inaugurua sulltan, ai vrau pesë vëllezërit e tij, ishte i varur nga alkooli, i dhënë pas fjetjes me gra, shoqërohej me mendjelehtë, i shfrytëzonte pasanikët dhe harxhonte pa hesap nga arka e myslimanëve.

Në librin e vyer “Sulltanët Osmanlinj”, historiani **Reshat Ekrem Kuxhu** thotë: “Mbrëmjet gazmore që u organizuan me rastin e synetllëkut të djalit të tij Muhamedit, zgjatën 35 ditë, ndërsa harxhimet që u bënë brenda kësaj kohe arrinin sasinë e harxhimeve që u bënë për hapjen e kanalit të Suezit. Dita e mevludit u zyrtarizua me dekret sulltanor, të cilin e nxori Sulltan Murati i Tretë gjatë ditëve të këtyre mbrëmjeve gazmore në vitin 1582 G. Mjafton kjo për të demaskuar sekretin e asaj që njerëzit sot e quajnë “dita e mevludit”.

Poemat e mevludit në Turqi, dallohen gjuhësisht edhe nga dallimet etnike të Ehli Sunetit. Që të gjithë, arabë, kurdë, zazë dhe çerkezë e këndojnë mevludin në gjuhën e tyre, ndërsa më i përhapuri dhe më i njohuri është mevludi i autorit Sulejman Çelebiu, i cili fillon kështu:

**Allah emnin ta përmendim pa ia nda
Me nisë punën me të gjithkush borxh e ka⁵**

Pason mevludi i autorit kurd **Mela Bate**, i cili njihet edhe me emrin **Mulla Hasan Ertushi**. Mevludi i Ertushit në të kaluarën e afërt ishte i ndaluar të botohet dhe të shpërndahet, mirëpo më vonë pushteti e lejoi, në kuadër të kërkesave të

kurdëve dhe me presionin e jashtëm nga Bashkimi Evropian, ndaj të cilit Turqia kishte një nënshttrim të dukshëm.

Nga kjo pasqyrë që po bëjmë brenda këtyre pak rreshtave, pa bërë ndonjë koment të veçantë, shohim një dëshmi të qartë për shpërndarjen, copëtimin dhe përçarjen e trishtueshme që kapluan Umetin Islam, si rezultat i shndërrimit të Fesë në një zinxhir traditash. Kjo pasqyrë imponon vetveten në tërë vatanin e madh Islam, gjë e cila na thërret të mendojmë thellë për çështjen e traditave të shpikura në emër të Fesë.

Në këtë rast meriton të përmendet edhe fakti se secila pjesë e këtij Umeti merr një qëndrim kundrejt Islamit varësisht prirjeve dhe kulturave të trashëguara që nga injoranca, të cilat janë në kundërshtim – me përjashtime të vogla – me gjërat që ka vendosur Kur’ani dhe Suneti. Këto qëndrime shkurtimisht janë të përmbledhura në tri grupime kryesore: qëndrimi sufi (i dervishëve), qëndrimi fanatik medhhebor dhe qëndrimi filozofik. Por kjo është një temë, e cila duhet të studiohet në veçanti, ndërsa tradita e “ditës së mevludit” është një shenjë që përfaqëson qëndrimin sufi dhe njëkohësisht qëndrimin fanatik medhhebor, të sheshit turk në veçanti.

Pra, festimi i ditës së mevludit nuk qenka kryekëput një traditë, që debatohet vetëm fetarisht duke e përshkruar atë si një bidat, ndonëse ky shkak është më i forti, por është një çështje, e cila ka rrënjë historike, shoqërore dhe kulturore dhe ka nevojë për më shumë studim dhe hulumtim. ■

Përktheu: Omer BERISHA

⁵ I njëjti mevlud është i përhapur edhe në trojet shqiptare.

BËHU DHE MOS U BËJ

Bëhu musliman - dhe mos u bëj jobesimtar.

Bëhu pasues i sunetit (selefi) - dhe mos u bëj shpikës në Fe (bidatxhi).

Bëhu rob i Allahut - dhe mos u bëj rob i shejtanit.

Bëhu njeri që kërkon ndihmë nga Allahu - dhe mos u bëj njeri që kërkon ndihmë nga varrezat dhe xhindet.

Bëhu njeri që ha ushqimet e mira - dhe mos u bëj prej atyre që hanë ushqimet e fëlliqura.

Bëhu i tëri në Islam - dhe mos u bëj paqëndrueshëm.

Bëhu njeri që shpenzon në rrugë të Allahut - dhe mos u bëj njeri koprrac.

Bëhu njeri që rri larg kamatës - dhe mos u bëj njeri që je zhytur në kamatë.

Bëhu njeri që e do vëllanë tënd për hir të Allahut - dhe mos u bëj prej atyre që e do për shkak të epshit dhe gjërave materiale.

Bëhu lexues i Kuranit Fisnik - dhe mos u bëj prej atyre që e kanë braktisur atë.

Bëhu modest për Allahun - dhe mos u bëj nënshiro jomuslimanit.

Bëhu tolerant - dhe mos u bëj i ashpër e i vrazhdë.

Bëhu me xhematin e muslimanëve - dhe mos e kundërshtoj xhematin e muslimanëve.

Bëhu dijetar ose nxënës - e mos u bëj injorant e mendjemadh nga mësimet.

Bëhu gjuhëlagur duke e përmendur Allahun - dhe mos u bëj gojëfëlliqur.

Bëhu i sinqertë në punët tuaja - e mos bëj vepra për sy e faqe e për nam.

Bëhu fjalëdrejtë - dhe mos u bëj rrenacak.

Bëhu bartës i brengës së Islamit - dhe

mos ki brengë vetëm barkun dhe organin.

Bëhu mik i besimtarëve - dhe mos u bëj mik i jobesimtarëve.

Bëhu kumtues i Pejgamberit - dhe mos u bëj heshtës i të vërtetës.

Bëhu zbatues i premtimit - dhe mos u bëj mashtrues e tradhtar.

Bëhu mbështetës tek Allahu - dhe mos u bëj prej atyre që shkojnë tek magjistarët dhe fallxhorët.

Bëhu falënderues për begatitë e Allahut - dhe mos u bëj njeri mohues.

Bëhu njeri që flet fjalë të mira ose hesht - dhe mos u bëj llafazan.

Bëhu njeri që thërret në fe të Allahut me heshtjen tënde - e mos u bëj largues nga Islami me sjelljen tënde.

Bëhu në ndihmë të vëllait tënd - dhe mos u bëj njeri që i bën padrejtësi.

Bëhu njeri që ke zemër të kënaqur - e mos u bëj lakmues dhe lypës.

Bëhu i kujdesshëm ndaj farefisit - dhe mos u bëj shpërfillës ndaj familjes.

Bëhu bamirës ndaj prindërve - dhe mos u bëj keqbërës ndaj tyre.

Bëhu i buzëqeshur për fytyrën e muslimanit - dhe mos u bëj fytyrëzëmtë.

Bëhu konfirmues i të mirave - dhe mos u bëj mohues i begative.

Bëhu zemërpastër nga zilia - dhe mos u bëj përbuz dhuntitë e Allahut.

Bëhu krenar çdo herë me Fenë Islame - dhe mos u bëj frikacak e përçmues i vetvetes. ■

*Marrë nga forumi: My Role in Life
Përshtati: Bekir HALIMI*



NJIHE ALLAHUN...

Ndodh që mund të gjesh ndonjë profesor me gradë shkencore në biologji apo astronomi, person me intelekt të lartë, por që nga ana tjetër e gjen në një faltore duke qëndruar me kokë të ulur dhe i gjunjëzuar përpara një idhulli, të cilin e ka ndërtuar me duart e tij, tek i cili është shkruar edhe data e prodhimit: (1910)!!!

DR. SELMAN B. FEHD EL AUDE

“Allah”. Ky emër është nga emrat e të Lartë-Madhërishmit, madje emri më i madh i Tij tek disa, emër të cilin e përmend më së shpeshti Kurani dhe Suneti i të Dërguarit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.

“Allah”. Emri më i përhapur i Zotit, të cilin e shqiptojnë njerëzit dhe krijesat, edhe pse kanë gjuhë të ndryshme.

“Allah”. Ky emër tregon qenien madhështore, që përmban cilësitë e adhurimit dhe zotërimit. Ky është një emër që i përket vetëm Zotit, nuk shqiptohet për askënd tjetër dhe askush nga krijesat nuk e pretendon atë.

“Allah”. Është emër i Zotit, të cilin e adhurojnë, e falënderojnë dhe e madhërojnë krijesat, e madhërojnë dhe e lartësojnë Atë qiejt, toka dhe çfarë ka në to, nata dhe dita, njerëzit dhe xhindet, toka dhe deti. *“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës.”* Isra, 44.

“Allah”. Një emër i ndërtuar nga shkronja të lehta, të cilat i shqipton fëmija i vogël dhe i huaji i porsa futur në Islam. Sido që ta lakosh këtë emër, përsëri ai do të kthehet në kuptimin e adhurimit e të adhuruarit, pos të cilit nuk ka tjetër.

Por çfarë kuptimi përmban ky emër?

“Allah”. Është Zoti, të cilin e adhurojnë zemrat, tek i Cili prehen shpirtrat, Ai të cilin dashuria kërkon ta gjejë, përmendja e të Cilit e do dhe të kënaq. Për Të kanë nevojë të gjitha krijesat, në çdo moment e në çdo çast, për çdo të vogël e të madhe, për të tashmen e të ardhmen. Ai është që i filloi dhe do t'i kthejë ato, Ai që i shpiku dhe kujdeset për to, ndaj dhe ato e besojnë Atë, e pranojnë dhe kanë nevojë për Të në të gjitha çështjet e tyre.

Nuk ka krijesë, veçse e ndien se Allahu e ka rrethuar atë me mirësi e begati të shumta, ndaj dhe është vërtet një meritë, që zemra e njeriut të drejtohet për tek Allahu i Lartësuar, me dashuri, përgjërime e madhështi.

Nga kuptimet e emrit “Allah” është: Zoti, të cilin e adhurojnë zemrat e tek i cili prehen shpirtrat, ndaj dhe dashuria është një kuptim që gjendet në lidhjet midis krijesës dhe Krijuesit. Allahu i Lartësuar thotë: *“O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dini se Allahu do të sjellë një popull, që i do dhe që e duan”* Maide, 54.

“...Atë nuk mundet ta arrijnë që ta përfshinë mendjet dhe as që mund të shkojnë tek madhështia e Tij me hamendje, ndaj dhe për këtë logjika e Madhëron...”

Kështu që Allahu i do robërit e Tij, të cilët e duan dhe i binden, të cilët i përmbahen urdhrave dhe ligjeve të Tij, ndaj dhe Profeti, salallahu alejhi ue selem, e ka konsideruar dashurinë e Allahut nga gradat më të larta, të cilat përpiqet që t'i arrijë besimtari. Ai ka thënë: *“Nëse dikush ka tre cilësi do ta shijojë ëmbëlsinë e besimit: të jenë Allahu dhe i Dërguari i Tij më të dashur për të, se çdo gjë tjetër; ta dojë njeriun vetëm për hir të Allahut dhe të urrejë të kthehet në kufër pasi Allahu e shpëtoi prej tij, ashtu siç urren të hidhet në zjarr”.* Buhari dhe Muslimi

Kështu Profeti e ka bërë orbitën e arritjes së ëmbëlsisë së besimit me kuptime, të cilat lidhen të gjitha me dashurinë...

Ndjenja e dashurisë, është një ndjenjë e frytshme dhe e pashtershme, të cilën e ndjen besimtari për Zotin e tij, njëkohësisht duke shpresuar prej Zotit të tij që ta dojë, dhe atë që e do Allahu, atëherë mos ki më frikë për të, sepse dynjaja për të do të jetë veçse gëzim dhe hare, kënaqësi dhe lumturi. Ndërsa çështja e tij gjatë vdekjes dhe në botën tjetër do të jenë më të mira dhe më të këndshme, sepse Allahu nëse e do dikë, atëherë ia ngre atij pozitën në Xhenet dhe e afron pranë Vetes atë.

Nga kuptimet e emrit Allah është edhe Madhështia e qenies së Tij, Cilësive, Emrave dhe Krenarisë së Tij. Atë nuk mundet ta arrijnë që ta përfshinë mendjet dhe as që

mund të shkojnë tek madhështia e Tij me hamendje, ndaj dhe për këtë logjika e Madhëron. Sepse Allahu është i Pari pa fillim dhe i Fundit pa mbarim. Ai është i shfaquri mbi të cilin nuk ka asgjë, është i Fshehti nën të cilin nuk ka asgjë. Vërtet Ai zotëron atë Madhështi dhe Krenari, e cila nuk mund të përfytyrohet dhe që as nuk mund të llogaritet.

Për Allahun në horizont ka aq shumë argumente

Sa ndoshta ke më e vogla e saj është udhëzimi yt

Vetëm në qenien e njeriut ka aq argumente

Saqë habia s'do të reshtej nëse do t'i shihnin sytë.

Gjithësia është e mbushur me aq shumë të fshehta

Saqë përpjekja për t'i shpjeguar do t'ju mundonte.

Allah është Zoti i adhuruar, tek i Cili drejtohen sinqerisht me zemrat dhe adhurimet e tyre besimtarët.

“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve, Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij”.
Enam, 162-163.

Fjala e parë me të cilën njeriu hyn në portën e Islamit, me të cilën ngjit shkallët e teuhidit dhe që ngrihet në pedestalin e adhurimit është fjala: LA ILAHE IL-LALLAH.

Njeriu është i krijuar nga vetë natyra e tij që të adhurojë dikë. Në zemrën e tij ka çrregullime, shpërqendrim dhe nevojë të domosdoshme për këtë adhurim. **Kështu që njeriu ose do të adhurojë Zotin e tij, duke ecur kështu rrugës së drejtë nëpër të cilën ecën e gjithë gjithësia përreth tij, ose do të adhurojë dikë tjetër në vend të Allahut, i cili do t'i shkatërrojë fenë dhe dynjanë e tij.** Pamjet e idhujtarisë kanë qenë të hershme,

ku njerëzit adhuronin gurët apo pemët, duke shpresuar prej tyre në vështirësi.

Këto pamje të hershme të idhujtarisë vazhdojnë edhe sot e kësaj dite në shumë vende. Ato i gjen në mesin e injorancës dhe të prapambetjes. Ndosht që mund të gesh ndonjë profesor me gradë shkencore në biologji apo astronomi, person me intelekt të lartë, por që nga ana tjetër e gjen në një faktore duke qëndruar me kokë të ulur dhe i gjunjëzuar përpara një idhulli, të cilin e ka ndërtuar me duart e tij, tek i cili është shkruar edhe data e prodhimit: (1910)!!!

Ky lloj adhurimi mund ta fusë njeriun në dorë, nëse ai nuk jepet pas adhurimit të Allahut, ky adhurim mund ta çorientojë atë dhe i lë si pasojë shqetësimin, stresin, dobësinë dhe pasigurinë në jetën e vet, ashtu si thotë edhe Allahu në Kuran:

“Dëgjojeni këtë shembull që ka sjellë Allahu! Janë dy njerëz: njëri ka shumë bashkëpronarë që e kundërshtojnë njëri-tjetrin, ndërsa tjetri ka vetëm një pronar, të cilit i përkushtohet. A janë njësoj ata në krahasim?!...”Zumer, 29.

Allah është emri, i cili thërritet pa u fshirë prej tij asgjë: O Allah! Nuk ka kënaqësi për zemrën, nuk ka lumturi dhe as gëzim, vetëm nëse e bën Allahun, Zotin dhe formuesin tënd, atë që ti e adhuron dhe atë ku përfundojnë të gjitha qëllimet e tua.

Prej Tij kërkohet ndihma, tek Ai është strehimi nga e keqja e çdo gjëje. E gjithë çështja është vetëm e Tija, për Të është falënderimi, i tij është sundimi. E gjithë e mira është në duart e Tij dhe njerëzit asnjëherë nuk do të kenë mundësi ta madhërojnë Atë ashtu sikurse duhet. Vërtet Ai është sikurse e ka madhëruar vetveten e Tij. ■

Përshtati nga arabishtja: Bledar HAXHIU

KRIZA BOTËRORE FINANCIARE


MËSIME DHE PËRVOJA NGA EKONOMIA KAPITALISTE PA MORAL

Sistemet e reja po ta zbatonin këtë rregull hyjnor të drejtë, nuk do të kishin nevojë ta provonin socializmin, as kapitalizmin që po vërtetohet dështimi i tyre me kalimin e kohës, e për shkak të tyre tregjet po ballafaqohen me kolaps, kompanitë me falimentim etj., por siç thuhet “pas mosbesimit nuk ka më mëkat.”

HETLAN B. ALIJ EL HETLAN

(vijon nga numri i shkuar)

Nëse kthehemi mbrapa për 14 shekuj, do ta shohim se Islami e ka kufizuar atë liri, e cila nuk kultivon kujdes për të varfrin dhe të vobektin. Atë liri, e cila e respekton individin në kurriz të shoqërisë. Prandaj Islami e ka të ndaluar kamatën dhe huan me fajde, për shkak se këto të çojnë në gjëra që kanë ndikim negativ dhe që janë të rrezikshme për varfanjakët dhe për mbarë ekonominë e përgjithshme. Islami po ashtu i ka ndaluar kontratat, që përmbajnë shitblerjen e mallrave që nuk janë në dispozicion, shitblerjen përmes bixhozit, shitblerjen e mallrave të panjohura. Në anën tjetër Islami i



ka lejuar shitblerjet e gjërave të njohura, që janë të lejuara. I ka lejuar shoqëritë aksionare, dhënien e mallrave në shfrytëzim me kundërvlerë në mënyrë që të materializohet drejtësia dhe solidariteti ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë, duke qarkulluar pasuria ndërmjet tyre dhe duke mos e monopolizuar atë një kategori e caktuar njerëzish, siç thotë Allahu: **“...në mënyrë që ajo të mos qarkullojë vetëm në duart e të pasurve nga mesi juaj.”** (Hashër, 7)

Ka lejuar borxhin, por nën kornizat e nevojave dhe me kritere të ligjshme që parandalojnë krizat dhe ndodhjen e kolapseve, që i dëmtojnë vet të pasurit dhe i kanoset dëmi edhe ekonomisë së përgjithshme.

Ja sot e shohim krizën e llogarive të hapura



në Amerikë dhe viktimat që ka lënë në mbarë botën, pastaj shpërndarjen e kësaj krize “falas” nëpër banka, kompani dhe individë nëpërmjet famëkëqijave “letrave me vlerë”. Prandaj për këtë arsye e shohim se si Sheriati ka vendosur rregulla të shumta për huan, të cilat pengojnë rreziqet e saj. E lejon përdorimin e huas për përfitime në masë të caktuar, që nuk i sjell dëm individit e as shoqërisë. Kemi tekste të shumta nga Kur’ani dhe Suneti, të cilat sinjalojnë rrezikun e huas, siç kemi rastin kur i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, lutej që ta ruante Allahu nga mbytja në borxhe dhe nga vështirësitë e tij. Buhariu përcjell se “i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, lutej: *“O Zot, kërkoj mbrojtjen tënde nga preokupimi dhe dëshpërimi, nga*

pamundësia dhe përtacia, nga frika dhe koprracia dhe nga vështirësia e borxhit dhe mposhtja e njerëzve!” Po ashtu Buhariu përcjell se i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, gjatë namazit lutej:

- *“O Zot, kërkoj mbrojtjen tënde nga mëkatimi dhe futja në borxhe!”*

- Një njeri e pyeti: pse lutesh aq shumë që të mbrohesh nga futja në borxh?

- I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, tha: *“Njeriu kur futet në borxhe gënjen kur flet dhe nuk e zbaton atë që e premtton.”*

Nesaiu përcjell se i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, lutej me këto fjalë: *“O Zot, kërkoj mbrojtjen tënde për mua nga mbytja e borxhit, mundja e armikut dhe nga gëzimi i armiqve me fatkeqësinë tonë!”*

Ne sot shohim se si borxhet dhe kreditë kanë përmbysur banka dhe kompani gjigante dhe i kanë futur në falimentim. Pa dyshim se fjala “mbytje” në lutjet e lartpërmendura është një fjalë e saktë, që na sinjalojnë mrekullinë profetike në kuptimin e fjalës dhe në përmbajtjen e dimensioneve të saj nga ai që ishte dalluar me “fjalët e shkurtra e kuptimplote”, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të.

Për rrezikshmërinë e borxhit sinjalojnë vetë mosfalja e të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, namazin e xhenazes atij që i kishin mbetur borxhe të pashlyera. Madje rrezikun e borxhit e ka treguar, kur ka bërë të ditur se ai është prej gjërave që Allahu nuk ia falë njeriut sado i mirë të jetë, ashtu siç na përcjell Muslimi fjalën e të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të: *“Shehidit i falet çdo mëkat, përveç borxhit.”*

Dihet përkushtimi i Sheriatit për shuarjen e pasojave të borxhit dhe për përfundimin e rezultateve të hidhura të tij mbi individin dhe shoqërinë. **Bejtul Mali** i muslimanëve e ka marrë përsipër shlyerjen e borxheve të

individëve, që nuk kanë mundësi pagese të borxheve të tyre. Bejtul Mali sot mund të quhet edhe Ministria e Financave. Gjithë ky përkushtim i Sheriatit bëhet vetëm për t'u ruajtur pasuritë e muslimanëve nga humbja dhe për të shmangur rrezikun e falimentimit të pjesëtarëve të shoqërisë, institucioneve dhe kompanive të ndryshme. Në hadithin që e përcjellin Buhariu dhe Muslimi përmendet se: *"I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, kur lajmërohej se një i vdekur kishte borxhe të pakryera pyeste: "A ka lënë diçka nga pasuria, që i mjafton ta lajë borxhin?"*, kur ndodhte që i vdekuri të kishte lënë një masë të mjaftueshme pasurie, ia falte namazin e xhenazes, e nëse nuk i mbulonte pasuria e tij borxhet thoshte: *"Faljani namazin shokut tuaj!"* E kur Allahu ia hapi dyert e mirësisë me zgjerimin e shtetit islam thoshte: *"Unë jam më primar për muslimanët se vetja e tyre, prandaj kush vdes dhe i mbeten borxhe, unë do t'ia shlyej ato."*

Për ta vetëdijesuar muslimanin për detyrimin e kthimit të borxhit, Sheriati detyron në përmirësimin e njetit me rastin e kërkimit të borxhit kur është i nevojshëm. Buhariu përcjell se i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Kush merr pasurinë e njerëzve me qëllimin për ta kthyer atë, Allahu do ta ndihmojë për ta kthyer borxhin. Ndërsa kush merr pasuri të huaj me qëllim shkatërrimin e saj, Allahu do ta shkatërrojë atë."* Në këtë hadith shohim një kërcënim për huamarrësin, i cili në vetvete ka qëllimin e keq, duke synuar të mos e lajë borxhin. Ky kërcënim bëhet për ta ruajtur pasurinë dhe për ta siguruar atë nga duart e mendjelehtëve, si dhe duke aspiruar në mos-ekspozimin e shoqërisë në trazira të vrullshme, si pasojë e borxheve të akumuluar. Për këtë arsye Sheriati Islam i ka ndaluar të aftit për pagesë zvarritjen e larjes së borxhit. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Zvarritja nga i pasuri*

është padrejtësi; e lejon nderin (duke u përgojuar) *dhe dënimin e tij* (duke u burgosur)."

Në anën tjetër Islami e ka lejuar huan me kriteret e caktuara. Ka lejuar huan e mirë (pa kamatë) me qëllim që të përhapet në mesin e pjesëtarëve të tij shpirti i dashurisë dhe i solidaritetit. Prandaj edhe e ka ndaluar huan me kamatë, sepse një gjë e tillë është një zhvatje e nevojtarit, që e ka detyruar nevoja të futet në huamarrje.

Përderisa sistemi kapitalist lejon sistemin e kredive me kamatë, ai njëkohësisht e ka dëmtuar vetveten në tregjet financiare, për shkak se ato kredi me kamatë shkaktuan tërmetin më të vrullshëm që mbahet mend ndonjëherë nga kompanitë dhe bankat amerikane, pasi atmosfera në Amerikë është e ngarkuar me kredi dhe kështu ka vazhduar pamundësia e larjes së kredive dhe topi i dëborës është rrokullisur derisa është bërë shumë i madh dhe rastet e falimentimit po ndodhin njëpasnjëshëm. Kështu do të ishte natyrshme, që ekonomia njerëzore të ballafaqohej me trazira të vrullshme, me goditje të dhimbshme, të cilat bëjnë që të humbi kontrolli mbi vetveten, të lëkundeshin tregjet e tyre financiare, kompanitë dhe institucionet e tyre bankare dhe të duken me pamjen e atij, që djalli e ka çmendur me prekjen e vet: *"...sepse ata thonë se tregtia është njëlloj si kamataria."* (Bekare, 275)

Ndërsa ekonomia islame i ngjason një peme të mirë, e cila e ka rrënjën të fortë në tokë, kurse degët nga qielli. Për këtë arsye ajo do të mbetet kulmore në përjetësi, përderisa të mos e njollosin atë vetë muslimanët, sepse ajo përqendrohet mbi parime dhe baza që e largojnë nga të ekspozuarit e saj para trazirave dhe e bën atë të sigurt nga rënia në krizë.

Aspekte të organizimit islam të ekonomisë

Islami e ka organizuar jetën ekonomike duke vendosur një ligj kompakt nga Krijuesi i

“Islami lejon tregtinë dhe ndalon monopolizimin e mallrave, sepse monopoli ua nxjerr kafshatën e bukës njerëzve nga gojët e tyre dhe e çon deri te ngritja e çmimeve...”

Madhërishtëm, që krijesat të gëzojnë një jetë ekonomike të sigurt, e cila e respekton të pasurin dhe të varfrin, që e ka në konsideratë interesin e përgjithshëm dhe atë individual dhe ua ruan njerëzve të drejtat e tyre. Kështu Sheriati Islam e ka lejuar shitblerjen. I ka lejuar transaksionet e ndryshme dhe vetëm disa ndalesa i ka përjashtuar, duke e zgjeruar në këtë mënyrë kufirin e së lejuarës. E ka ndaluar kamatën dhe huan me fajde, sepse kamata krijon kasta dhe ndarje në shoqëri, mbjell në mendjet e njerëzve varësinë dhe papunësinë në kurriz të tjerëve, e ngarkon atmosferën shoqërore me dashurinë e vetvetes dhe egoizmin e tepruar. Islami e ka ndaluar shitblerjen e letrave me vlerë, sepse ato ndihmojnë në ligjësimin e kamatës dhe në paketimin e saj në kallëpe letrash, në shpërndarjen e saj në numrin më të madh të mundshëm të pjesëtarëve të shoqërisë, që të njollosen të gjithë me bëzhdile dhe lëmishtet e saj. Po ashtu Islami e ndalon shitblerjen e mallrave të panjohur dhe joekzistues, shitblerjen nëpërmjet kumarit, sepse këto janë mënyra shfrytëzimi të padrejta të pasurive të njerëzve.

Islami lejon tregtinë dhe ndalon monopolizimin e mallrave, sepse monopoli ua nxjerr kafshatën e bukës njerëzve nga gojët e tyre dhe e çon deri te ngritja e çmimeve. Islami ka ndaluar që shitësi të shes prodhimin që nuk e zotëron, ose nuk e ka në pronësi, fitimin nga produkti që nuk garantohet, në

mënyrë që fitimin dhe humbjen ta ndajnë të gjithë së bashku. Ka ndaluar po ashtu rrezikimin në dallimin e çmimeve të tregut të mallrave me shifra marramendëse, të cilat nuk reflektojnë realitetin e kompanisë prodhuese, në mënyrë që tregu t'i shmangë veprimet imagjinare etj. Islami ka ndaluar blerjen e mallrave të njerëzve të largët, kur arrijnë afër tregut me qëllim që t'i shesin me çmime shumë më të shtrenjta më pas në atë treg, e ka ndaluar sepse një gjë e tillë e dëmton tregun, pasi çon në dominimin e mallrave, gjë që ndikon negativisht në ngritjen e çmimeve.

Sistemet e reja po ta zbatonin këtë rregull hyjnor të drejtë, nuk do të kishin nevojë ta provonin socializmin, as kapitalizmin që po vërtetohet dështimi i tyre me kalimin e kohës, e për shkak të tyre tregjet po ballafaqohen me kolaps, kompanitë me falimentim etj., por siç thuhet **“pas mosbesimit nuk ka më mëkat.”**

Kritikat na takojnë edhe neve muslimanëve, kur ecim pas të tjerëve dhe i braktisim mësimet e fesë tonë, e cila na erdhi prej Zotit të Urtë e të Gjithëdhjshëm.

Mësime të mëdha dhe këshilla vigane për të mençurit

1. Mësimi i parë:

Dalja në pah e normës së Allahut lidhur me ata që punojnë me kamatë. Allahu me të drejtë ka thënë: **“Allahu ia çrrënjos çdo përfitim kamatës.”** (Bekare, 276) Po, për Allahun! Kjo është çrrënjosje. Çfarë çrrënjosje? Çrrënjosje materiale dhe morale. Pasuria e kamatarit mund të jetë gjigante, por begatinë e ka të humbur. Dikush tjetër mund të ketë pasuri më pak, të ardhura të kufizuara, mirëpo nga ajo që ka ndoshta edhe kursen, për shkak se bereqeti i pasurisë së tij bën që ajo t'i mjaftojë për nevojat e veta. Pasuritë e kamatarëve, tregjet e ndërhuara me kamatë, ekonomitë kamatare etj., janë të çrrënjosura pa dyshim.

Po si mos të jenë të çrrënjosura, kur kamatarët i shpallin luftë më të fuqishmit,

Allahut?! Krijuesi, Furnizuesi a nuk thotë në librin e Tij: *“O ju që keni besuar! Ta keni frikë Allahun dhe hiqni dorë nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse nuk e bëni këtë, atëherë iu është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar. Në këtë mënyrë, nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni vetë.”*? (Bekare, 278-279) A mundet pra, dikush që t'i dalë përballë Allahut? E si do të ishte epilogu, sikur të përballej me Të -Allahu na ruajttë- ? Sa madhështore është Urtësia e Allahut! E sa i ashpër është zemërimi dhe dënimi i Allahut!

A do të pendohet ai që punon me kamatë dhe punon nëpër bankat me kamatë? A ka pendim të singërtë?! A do të pendohen shtetet që ekonomitë e tyre i kanë të ndërtuara mbi kamatë, mashtrim, kumar, liri të shfrenuar mizore dhe të përfitojnë nga ajo që ndodhi dhe të marrin mësim para se ta arrijnë atë që e arriti ekonomia më e madhe në botë? Normat e Allahut nuk e favorizojnë dikë e ta përjashtojnë dikë tjetër. Prandaj a ka dikush që merr këshillë? A ka dikush që merr mësim?

2. Mësimi i dytë:

Ajo që ka ndodhur është epilogu i keq i padrejtësisë. Po, për Allahun! Sa i ashpër është përfundimi i padrejtësisë dhe sa i keq dhe sa i shëmtuar është përfundimi i saj! Sa padrejtësi kanë bërë këto shtete tirane, sa njerëz kanë shkelur e kanë tiranizuar?! Sa janë mashtruar kur menduan se kanë fuqinë më të madhe ndër njerëzit?! *“Vallë, a nuk e dinin ata se Allahu që i kishte krijuar, është më i fuqishëm se ata?!”* (Fussilet, 15)

Vallë, sa shumë i ka dalë në ndihmë Amerika shtetit sionist me mizorinë dhe dhunën e tij kundër palestinezëve. E ka ndihmuar atë me armë, të cilat i ka përdorur për t'i vlarë të pafajshmit. Është pozicionuar me të nëpër organizata të ndryshme ndërkombëtare, duke i dalë në ndihmë dhe duke e mbrojtur atë në mizorinë dhe armiqësinë e tij. Është diçka e ditur ajo që po

“...Fuqia më e madhe e këtij shteti të madh ishte vetë forca ekonomike. Prandaj Allahu ua solli atyre dënimin nga nuk e prisnin. Po, për Allahun. Ata mendonin – dhe supozimi i tyre ishte i rrejshëm- se ekonomia e tyre si dhe politikat e tyre fiskale do t'i forconin ata edhe nga Allahu...”

bën Amerika në Irak dhe Afganistan, dhe fatkeqësitë e shumta që po ndodhin në këto vende, për shkak të saj, si vrasje, shkatërrim, zhvendosje, bonjakëri, vejëri, përhapje të imoralitetit dhe të dukurive negative, plaçkitje të të mirave, vjedhje të pasurisë, prishje të interesave të njerëzve, mbjellje të frikës dhe mospajtim të pasurisë, familjes dhe nderit të tyre etj.

Allahu ka thënë: *“Mos mendo kurrësi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen* (nga tmerret që do të shohin).” (Ibrahim, 42) Po ashtu ka thënë: *“I tillë është dënimi i Zotit tënd, kur ndëshkon vendbanimet që bënin gjynahe. Me të vërtetë, dënimi i Tij është i dhembshëm dhe i ashpër.”* (Hud, 102) Po ashtu ka thënë: *“Askush tjetër, përveç Tij, nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd.”* (Mudethir, 31)

Po kështu do të jetë përfundimi, dhe këto janë vetëm disa dënime të Allahut të Madhërisë: *“Me të vërtetë, Zoti yt dënon shpejt, por Ai është edhe Falës e Mëshirëplotë.”* (Arafë, 167) dhe *“Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e*

jobsimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!
(Ali Imran, 196-197)

Hoxha Abdurrahman Sa'dij, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Në këtë ajet është si qëllim dhënia gajret muslimanëve kur shikojnë se si mosbesimtarët mund të kenë nga të mirat e dynjasë, begatimi me to, lëvizja e tyre nëpër vende me lloje të ndryshme tregtie, përfitime, kënaqësi, pastaj me llojet e krenarisë dhe të mbisundimit nganjëherë. E gjithë kjo është “mirëqenie e shkurtër”, e cila nuk ka stabilitet dhe qëndrueshmëri, por kënaqen me to për një kohë të shkurtër, kurse dënohen për to për një kohë të gjatë. Kjo është gjendja më e favorshme e mundshme për mosbesimtarët.”

3. Mësimi i tretë:

Vështro lexues i nderuar, se si Allahu është hakmarrë ndaj këtij vendi të padrejtë dhe si e ka bërë ushtrinë e Tij të mbizotërojë mbi ta. **Nuk ua solli ndonjë armik i jashtëm që mundohet ta zhdukë farën e tyre me armë të shkatërrimit në masë, me prodhimin dhe zotërimin e të cilave i paraprin botës e të thuhet pastaj: “U shkatërruan atëherë kur nuk kishin eksperiencë me armë nga të cilat nuk ka mundësi të shpëtosh e as nga pasojat e tyre”. Allahu nuk iu çoi atyre uragane, tërmete dhe katastrofa, të cilat zhdukin të njomin dhe të thatin, edhe pse sprovohen nga pak me këto gjëra për çdo vit, e të thuhet pastaj: “U goditën nga katastrofa natyrore e jo nga gabimet e tyre shkencore, nga sistemet e tyre apo nga politikat e tyre”. Jo, por Allahu me urtësinë e Tij dhe me fuqinë e Tij i goditi nëpërmjet asaj që ata i mburreshin botës, u bënë marketing dhe e qarkullonin ndërmjet vetes. Madje premtonin dhe kërcënonin për shkak të saj. Luftonin dhe okuponin shtete, i lejonin vetes të mirat e tyre me pretekstin e zbatimit dhe përhapjes së saj në mesin e tyre. Pastaj i dënonin, iu venin embargo, ua**

kufizonin lëvizjet atyre që e refuzonin sistemin e tyre kapitalist liberal, ku pamjet më të theksueshme dalin në pah në lirinë e tregut dhe të ekonomisë.

Një gjë tjetër është se fuqia më e madhe e këtij shteti të madh ishte vetë forca ekonomike. Prandaj Allahu ua solli atyre dënimin nga nuk e prisnin. Po, për Allahun. Ata mendonin – dhe supozimi i tyre ishte i rrejshëm- se ekonomia e tyre si dhe politikat e tyre fiskale do t'i forconin ata edhe nga Allahu, e të mos flasim për njerëzit. Allahu kur foli për hebrenjtë e fisit Benu Nadir tha: **“Allahun e madhëron çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti. Është Ai, që i nxori nga shtëpitë e tyre ata që nuk besuan midis Ithtarëve të Librit në kohën e dëbimit të parë. Ju nuk mendonit se ata do të iknin, kurse ata mendonin se fortesat e tyre do t'i mbronin prej Allahut. Por dënimi i Allahut u erdhi andej nga ata nuk e pritnin, duke mbjellë në zemrat e tyre frikën, e cila bëri që ata t'i shkatërronin shtëpitë e veta me duart e tyre, si dhe me duart e besimtarëve. Prandaj mësoni nga kjo, o ju largpamës!”** (Hashër, 1 dhe 2)

Shumica e njerëzve menduan –dhe gabuan- se nuk ka mundësi që ekonomia amerikane do të shkojë në recesion, ose t'i ndodhë ndonjë krizë si kjo që i ka ndodhur **“ju nuk mendonit se ata do të iknin”**. Po ashtu vetë amerikanët kanë menduar se sistemi i tyre, ligjet e tyre të tregut, kapitalizmi, liberalizmi dhe liria e supozuar e tregut të tyre do t'i mbrojnë nga dënimi dhe zemërimi i Allahut, prandaj **“dënimi i Allahut u erdhi andej nga nuk e prisnin”**. Subhanallah! Tani kanë ndërhyrë në tregjet e tyre dhe ua kanë marrë atë “lirinë” e supozuar dhe “demokracinë” që e ndërtuan vetë. E kanë kundërshtuar kapitalizmin e tyre dhe i kanë thyer ndërtesën atij me duart e veta **“bëri që ata t'i shkatërronin shtëpitë e veta me duart e tyre”**. I Lartësuar qoftë Allahu, Krijuesi i

gjithësisë, Fuqiploti, që thotë: *“Askush tjetër, përveç Tij, nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd.”* (Mudethir, 31)

4. Mësimi i katërt:

Kjo që ka ndodhur është fillimi i rënies së sistemit kapitalist liberal dhe zbardhje e defekteve dhe e dështimeve të tij. Kjo krizë ka rrënuar shumë parime të liberalizmit ekonomik, për të cilat propagandonte Amerika. Ajo po ashtu vërtetoi se lënia e lirë e ekonomisë së tregut me vetërregullim, pa kurrfarë mbikëqyrje çon në katastrofa që e godasin për vdekje mbarë ekonominë, si rezultat i dëshirave të papërmbajtura të disa kapitalistëve lakmitarë për pasuri vigane, duke mos shikuar përfundimet e mundshme. Kjo solli që mbarë bota që po bie viktimë e kumarit që po luajnë disa biznesmenë në **Wall Street**, në mënyrë që të mësojnë të mashtruarit realitetin e hidhur të këtij sistemi dhe ta dinë se është i paaftë për t'i kënaqur nevojat e njerëzve. Ta dinë se e vërteta, e drejta, hairi dhe mëshira janë në programin islam unik, të zbritur prej Allahut, që njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithënjofuar. *“Sikur ithtarët e Librit të besonin dhe të ruheshin nga mohimi, Ne do t'ua mbulonim veprat e këqija dhe do t'i shpinim në kopshtet e kënaqësisë. Sikur ata t'i përmbaheshin Tevratit e Inxhilit dhe asaj që u është shpallur nga Zoti i tyre, ata do të kënaqeshin me frytet (që rriten) sipër dhe poshtë tyre. Disa prej tyre janë të matur, por shumë prej tyre bëjnë vepra të këqija.”* (Maide, 65-66)

Me besim në Allahun dhe në atë që ka ligjësuar, me realizimin e devotshmërisë ndaj Allahut dhe pasimin e Sheriatit të Tij, arrihen mirësitë, përfshijnë begatitë dhe zbret përdëllimi. Allahu thotë: *“Sikur të qëndronin në rrugën e vërtetë, Ne do t'u jepnim ujë të bollshëm, për t'i vënë ata me këtë në sprovë. Por këdo që largohet nga këshillat e Zotit të tij, Ai do ta hedhë në një dënim të ashpër.”* (Xhin, 16-17)

“Ajo po ashtu vërtetoi se lënia e lirë e ekonomisë së tregut me vetërregullim, pa kurrfarë mbikëqyrje çon në katastrofa që e godasin për vdekje mbarë ekonominë...”

5. Mësimi i pestë:

Autoritetet islame nëpër bankat islame, ose ato që kryejnë veprime të pjesshme islame të kenë kujdes dhe ta kuptojnë rrezikun e qartë dhe mëkatën e madh, që përmbajnë shumë prej transaksioneve kreditore të reja dhe të mos tolerojnë në emërtimin e tyre, si letra apo çeqe islame. Po ashtu mos të tolerojnë në lejimin e disa mënyrave të transaksioneve, të cilat i kanë ndaluar shumica e dijetarëve islamë bashkëkohorë, e të shkaktojnë –mos dhëntë Allahu- fatkeqësi ekonomike ose humbjen e pasurisë së njerëzve apo falimentimin e saj, në kohën kur disa ekspertë perëndimorë të ekonomisë po bëjnë thirrje për ndjekjen e ekonomisë islame dhe të praktikuarit e saj.

O Zot, zbutë gjendjen e muslimanëve në çdo vend!

O Zot, nxirri muslimanët nga kjo sprovë të shëndoshë, fitimtarë, të penduar dhe drejt Allahut të kthyer!

O Zot, kërkojmë mbrojtjen tënde nga sprovat e dukshme dhe ato të padukshme!

O Zot, largoje nga ne dhe nga gjithë muslimanët shtrenjtësinë, epideminë, recesionin dhe shkatërrimin dhe na mëshiro me mëshirën tënde, që ka përfshirë çdo gjë, o i Lartësuar! ■

Nga arabishtja: Muhamed DËRMAKU

LËNIA E NAMAZIT - KUFËR I VOGËL APO I MADH?



Për këtë temë është shkruar jashtëzakonisht shumë nga imamë të mëdhenj, prandaj detyra jonë mbetet që të bëjmë një pasqyrim sa më të qartë për çështjen në fjalë.

SHKRUAN: AGIM BEKIRI

Vendimi i sheriatit për lënësin e namazit është një temë e gjatë dhe e ndërlikuar, që ngërthen në vetvete shumë çështje. Lënia e namazit është kufër i madh apo i vogël, dënimi i lënësit të namazit, falja jashtë kohës së caktuar, falja e namazit me xhemat, kompensimi i namazeve të kaluara, cungimi i namazit, të gjitha këto janë vetëm disa prej problematikave që kërkojnë përgjigje.

Në këtë shkrim do të flasim për çështjen e parë, për atë se lënia e namazit a është vepër që të nxjerrë nga Islami (kufër i madh) apo është vetëm mëkat, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një shkrim modest i

përshtatshëm me rrethanat në të cilat shkruhet.

Për këtë temë është shkruar jashtëzakonisht shumë nga imamë të mëdhenj, prandaj detyra jonë mbetet që të bëjmë një pasqyrim sa më të qartë për çështjen në fjalë.

Në lidhje me këtë çështje dijetarët janë ndarë në dy mendime:

Mendimi se lënia e namazit nuk është kufër i madh.

Të këtij mendimi janë një numër i madh i dijetarëve të vjetër dhe bashkëkohorë, prej tyre: Ibën Shihab Zuhriu, Seid b. Musejebi, Omer b. Abdulazizi, Ebu Hanife, Maliku, Shafiu, Ahmed b. Hanbeli sipas një transmetimi, Davud b. Aliu, Muzeniu. Po

kështu këtij mendimi i bashkëngjitet edhe Muhamed Nasirudin Albani.

Disa prej argumenteve të tyre:

1. Ajeti: **“S’ka dyshim se Allahu nuk fal (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) fal këdo. Kush i përshkruan Allahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh”**. (Nisa – 48)

2. Hadithi: **“Janë pesë namaze, të cilat Allahu ua ka caktuar robërve, kush i kryen ai e ka premtimin prej Allahut, se do ta fusë në xhenet, ndërsa nëse nuk vjen me to ai nuk ka premtim tek Allahu. Nëse dëshiron Ai e dënon, ndërsa nëse dëshiron që t’ia falë, do t’ia falë”**.¹

3. Hudhejfe përcjell se Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: **“Islami do të dobësohet ashtu siç dobësohen rrobat e vjetra dhe shqyhen, derisa të vijë një kohë ku nuk dihet se ç’është agjërimi, namazi, haxhi apo zekati. Allahu do të urdhërojë që të ngrihet Kurani dhe nuk do mbetet në tokë asnjë ajet. Do të mbesin disa grupe njerëzish, ndonjë plak e plakë, të cilët do të thonë: prej baballarëve tanë kemi dëgjuar se thoshin këtë fjalë “la ilaha il-lallah” dhe ne e themi.”** Një person me emrin Sile i drejton një pyetje Hudhejfes: Ç’dobi kanë ata prej kësaj fjale, kur nuk e dinë se ç’është namazi e agjërimi?! Hudhejfe ia ktheu: Do t’i shpëtojë prej zjarri.²

4. Hadithi: **“Ai që dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një, që nuk ka shok dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, se Isa është rob dhe i Dërguari i Tij, është fjalë e Tij që Ai e ka vendosur te Merjemja dhe shpirt prej Tij, se xheneti është i vërtetë dhe se Zjarri është i vërtetë, Allahu do ta fusë në xhenet në pajtim me veprat e**

tij”

5. Hadithi: **“O Muadh!”** “Të përgjigjem, o i Dërguari i Allahut”, i kishte thënë ai dhe këtë e përsëriti tri herë e pastaj tha: **“Nuk ka asnjë rob që dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut e që Allahu të mos ia ndalojë zjarrin”**, “O i Dërguari i Allahut, a t’i njoftoj njerëzit lidhur me këtë që ata të gëzohen?” pyeti ai. Ai tha: **“Atëherë ata do të mbështeten në këtë”**. Lidhur me këtë fjalë Muadhi, radijallahu anhu ka folur kur ishte në shtratin e vdekjes, duke u frikësuar se do të bëjë ndonjë mëkat po të mos e thotë.⁴

6. Hadithi: **“Njeriu më i lumtur që e meriton shefatin Tim është ai që dëshmon sinqerisht prej zemrës se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut”**.⁵

7. Hadithi: **“Jam lutur për umetin Tim dhe më është pranuar ajo që sikur shumë prej tyre po ta kishin zbuluar do ta linin namazin (dhe do vinin të dëgjojnë)”**. Ebu Dherri i tha: “A t’i përgëzoj njerëzit?” Ai tha: **“Gjithsesi”**. Ai u nis, ndërsa Omeri, radijallahu anhu i tha: nëse i lajmëron njerëzit lidhur me këtë, ata do ta linin ibadetin. Pastaj i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, e thirri sërish dhe i tha që të kthehet dhe ai u kthye”.⁶ Ndërsa ajeti i përmendur (të cilin e kishte lexuar) është: **“Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit e Tu, e nëse i fal ata, Ti je i Gjithëfuqishmi, i Urti.”** (Maide, 118).

8. Hadithi: **“Gjëja e parë për të cilën robi do të japë llogari në Ditën e Gjykimit janë namazet e caktuara dhe nëse i ka kryer, ai ka arritur sukses, ndërsa nëse nuk i ka kryer, do t’i thuhet të shikojë, se a ka ndonjë nafile. Nëse ka ndonjë nafile, me to do të plotësohen farzet, ndërsa pastaj edhe me veprat tjera të**

¹ Hadithi është sahih.

² Ibën Maxhe

³ Buhariu dhe Muslimi

⁴ Buhariu dhe Muslimi

⁵ Buhariu dhe Muslimi

⁶ Hadithi është sahih. E shënon Ahmedi në ‘Musned’.

detyrueshme do të veprohet në të njëjtën mënyrë”⁷.

9. Hadithi: “Kush i ka fjalë të fundit La ilahe il-Allah, do të hyjë në xhenet”⁸. Në një thënie tjetër thotë: “Kush vdes duke e ditur se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, do të hyjë në xhenet”⁹.

10. Hadithi: “Allahu ia ka ndaluar zjarrin atij njeriu që thotë La ilahe il-Allah, duke dashur me këtë kënaqësinë e Allahut”¹⁰.

11. Në hadithin rreth shefatit thuhet se Allahu subhanehu ue teala, ka thënë: “Pasha krenarinë Time dhe Madhështinë Time, do ta nxjerr prej zjarrit atë që thotë la ilahe il-Allah”¹¹. Në këtë hadith gjithashtu thuhet: “Pastaj do ta nxjerr prej zjarrit atë që kurrë nuk ka punuar asnjë vepër të mirë”¹².

12. Në ‘Sunene’ dhe ‘Musnede’ përcillet tregimi i pronarit të kartelës, të cilit do t’i shpërndahen nëntëdhjetë e nëntë libra, ndërsa secili libër do të jetë i madh aq sa mbërrin shikimi, pastaj do të nxirret kartela në të cilën gjendet shehadeti “la ilahe il-Allah”, kështu që ai do të anojë në peshë mbi veprat e tij të këqija”¹³.

Mendimi se lënia e namazit është kufër i madh:

Këtë mendim e përfaqësojnë po ashtu një numër i madh i dijetarëve të hershëm dhe bashkëkohorë, prej tyre: Seid b. Xhubejri, Amir Shabiu, Ibrahim Nehaiu, Evzai, Ebu Ejub Sihtijani, Abdullah b. Mubareku, Is’hak b. Ra-hoja, Abdulmelik b. Habibi prej malikive. Ebu Muhamed b. Hazmi tregon se i këtij mendimi është Omer b. Hatabi, Muadh b. Xhebeli, Abdurrahman b. Aafi, Ebu Hurejre dhe sahabët e tjerë. Këtij mendimi i bashkëngjitet edhe Abdulaziz b. Bazi dhe Muhamed b. Salih

Uthejmini.

Pastaj këta dijetarë janë ndarë në mendime rreth asaj, se sa namaze duhet të lerë njeriu për t’u llogaritur kufër i madh. Disa prej tyre mendojnë se mjafton të lerë një namaz për të bërë kufër të madh, disa dy namaze, të tretët shumicën e namazeve.

Disa prej argumenteve të tyre:

1. Ajeti: “Ditën kur ashpërsohet çështja deri në kulm (në kiamet), e ata do të ftohen për të bërë sexhde, po nuk munden. Shikimet e tyre janë të përulura dhe ata i kaplon poshtërimi, kur dihet se ata kanë qenë të ftuar të bëjnë sexhde sa ishin të shëndoshë (e ata - talleshin)” (Kalem, 35-43).

2. Ajeti: “Secili njeri është peng i veprës së vet, përveç atyre të djathtëve, të cilët janë në xhenete dhe i pyesin kriminelët (e u thonë): “Çka u solli juve në Sekar?” Ata thonë: “Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënin namaz); Nuk kemi qenë që ushqenim të varfrit; Dhe kemi qenë që përziheshim me të tjerët në punë të kota. Dhe kemi qenë që nuk e besonim Ditën e Gjykimit, derisa na erdhi e vërteta (vdekja)” (Mudethir, 38-47).

3. Ajeti: “Falni namazin rregullisht, jepni zeqatin dhe respektoni të Dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni.” (Nur, 56).

4. Ajeti: “E pas tyre (të mirëve) erdhën pasardhës të këqij, që e lanë namazin, e u dhanë pas kënaqësive (trupore), e më vonë do të hidhen në çdo të keqe.” (Merjem, 59).

5. Ajeti: “Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezër në fe.” (Teube, 11).

6. Hadithi: “Ndërmjet njeriut dhe kufrit është lënia e namazit”¹⁴.

⁷ Hadith sahih e shënon Ebu Davudi

⁸ Hadith sahih e shënon Ebu Davudi

⁹ Muslimi

¹⁰ Buhariu dhe Muslimi

¹¹ Buhariu dhe Muslimi

¹² Buhariu dhe Muslimi

¹³ Sahih, e shënon Tirmidhiu

7. Hadithi: “Kontrata ndërmjet nesh dhe atyre është namazi, prandaj kush e lë atë, ai nuk ka besuar.”¹⁵

8. Hadithi: “Te rob i ndërmjet mosbesimit dhe besimit është namazi, nëse ai e lë atë, ka bërë shirk”¹⁶.

9. Hadithi: “Ai që e fal namazin tonë, kthehet nga kibra jonë dhe e han atë që ne e therim, është musliman. E tij është ajo që është e jona dhe kundër tij është ajo që është kundër neve (domethënë i takon ajo që na takon edhe neve)”¹⁷.

10. Na përcillet prej Mihxhen b. Edrea Eslemiut se ka qenë duke ndenjtur me të Dërguarin salAllahu alejhi ue selem. Ndërkohë ishte thirrur ezani për ta lajmëruar namazin. I Dërguari salAllahu alejhi ue selem u ngrit dhe kur u kthye, Mihxheni ende ishte në mexhllis. E pyeti: “Çfarë të pengoi që të falesh, a nuk je ti musliman?” Ai i tha: “Kuptohet se jam, por jam falur me familjen time”. Me këtë rast i Dërguari salAllahu alejhi ve selem i tha: “Kur të vish (në xhami), falu me njerëzit, edhe pse je falur më herët”¹⁸.

11. Ixhmaja e heshtur e sahabëve

Përmbyllje:

Këto janë dy mendimet e dijetarëve të Islamit dhe argumentet e tyre, në lidhje me lënien e namazit. S’do mend që polemika është më e thellë dhe për çdo argument të shtruar ka një kundërpërgjigje nga ithtarët e mendimit kundërshtar, porse një shtjellim i tillë nuk përputhet me natyrën e këtij shkrimi.

E rëndësishme është të dimë se:

1. Muslimanët janë të një mendimi, se lënia e qëllimshme e namazit në përgjithësi paraqet një prej mëkateve më të mëdha, madje më i madh se vrasja, zinaja (*kurvëria*), marrja pa të

“Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezër në fe...”

drejtë e pasurisë, vjedhja, konsumimi i alkoolit etj... dhe se kryerësi i këtij mëkati i ekspozohet dënimit të Allahut, si dhe përcëmitit si në këtë botë, ashtu edhe në ahiret.

2. Mendimi ndryshe në këtë çështje është një realitet i pranuar përgjatë historisë islame. Madje prej shembujve më tipikë për mospajtimin e Ehli Sunetit përmendet mu kjo çështje, rreth së cilës me shekuj është debatuar dhe asnjëherë nuk është arritur në një konsensus të deklaruar. Megjithatë ky mendim dhe të ngjashmit nuk kanë shkaktuar përçarjen apo etiketimin e palëve debatuese, porse siç thonë dijetarët: **Ehli Suneti është i bashkuar edhe kur kanë mendime të ndryshme.**

3. Mendimi se lënia e namazit është kufër i madh nuk nënkupton medoemos shpalljen qafirë të të gjithë atyre që deklarohen si muslimanë e që nuk falen, porse kjo shpallje që quhet “tekfir tarikis-salah” është një procedurë tjetër, që e bën gjyqi islam apo dijetarët e mirëfilltë, të cilët janë kompetentë për ta bërë një gjë të tillë. **Nga ana tjetër, mendimi se lënia e namazit nuk është kufër i madh, porse vetëm mëkat nuk është arsye për ata të cilët nuk falen.** Lënia e namazit edhe më tej mbetet prej veprave më të shëmtuara dhe ata që mundohen nëpërmjet këtij mendimi të pastrojnë veten, ata në fakt janë manipuluar nga shejtani. ■

14 Muslimi

15 Sahih, e përmend Tirmidhiu në ‘Kitabul iman’

16 Sahih, e përmend Lalikai në librin e tij ‘Sherh usuli ‘itikadi ehli-suneti vel xhemaati’

17 Buhariu

18 Zinxhiri i hadithit është sahih. E shënon Nesaiu



KU GJENDESH TANI?...

Ku je me jetën tënde, synimet e tua dhe prioritetet që do të japin drejtimin e jetës tënde personale. A je në lartësinë e duhur për të qenë pjesë aktive e jetës familjare dhe shoqërore njëkohësisht? Njihni potencialet dhe aftësitë që zotëron, nëse dëshironi që t'i zhvilloni më tutje dhe kjo është bazë nga e cila do të niseni për të ndërtuar ardhmërinë tuaj të ndritur me lejen e Allahut.

SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Atë ka rastisur ndonjëherë ta ftoh ndonjë mik për vizitë, ndërsa ai ka pasur nevojë që t'ia përshkruash lagjen ku jeton, si dhe rrugën se si të gjejë ai ty?

Cila është pyetja e parë që i ke drejtuar, në çastin kur të ka treguar se nuk është duke e gjetur shtëpinë tënde? Sigurisht që e ke pyetur: “Ku gjendesh tani dhe më përshkruaj pozicionin tënd.”

E njëjta gjë vlen edhe për ty në këtë botë, patjetër duhet të dish pozicionin tënd të tanishëm, që të kuptosh se në

ç'drejtim duhet lëvizur? Dhe sa kohë të nevojitet saktësisht për të arritur atje ku synon!

Njihe mirë veten

Pa e njohur pozicionin tënd të tanishëm në hartën e jetës nuk do të kesh mundësi të llogarisësh distancën (e afrimit ose largimit) drejt të ardhmes sate. Mbase tani po pyesni veten tuaj për formën e përcaktimit të pozicionit tuaj, duke dëshiruar të ishte ajo një instrument i ngjashëm me atë që mat koordinatat në tokë. Fatkeqësisht problemi nuk është edhe aq i thjeshtë. Mirëpo ju mund të mësoni përmes disa pyetjeve të thjeshta, që duhet t'i bëni vetes, për të kuptuar pozicionon tuaj në hartën e jetës, si p.sh.:

Çfarë ndryshimi mund dhe nuk mund të pranojë jeta ime?

Është mendjelehtësi të humbasësh kohë dhe mund në gjërat që në thelb nuk e pranojnë ndryshimin...

Çfarë mund të ndryshosh ti në veten tënde dhe çfarë ke dëshirë të ndryshosh te të tjerët?

Do të ndihesh i lodhur dhe i dëshpëruar po të tentoje në mënyrë vetjake të ndryshosh atë që nuk ka mundësi të ndryshojë, veçse me ndihmën e të tjerëve. Në anën tjetër, do ta privosh veten nga kënaqësia e suksesit dhe do të humbasësh autoritetin tënd duke kërkuar ndihmë nga të tjerët në gjërat që ke mundësi t'i kryesh vetë...

A je i kënaqur me gjërat që je duke i bërë?

Moskënaqësia do të bëjë që ty të rëndohet veprimtaria, të humbasësh

“Mos prit që gjithmonë do të dëgjosh vetëm lëvdata dhe falënderime, por përgatitu që të dëgjosh edhe kritika, por kjo nuk nënkupton se ju jeni person i keq, porse jeni vetëm njerëz...”

ritmin, madje edhe të shmangesh nga rrugëtimi yt i përcaktuar më parë dhe kështu të zbresësh në pikën zero pa e kuptuar fare...

A je i entuziazmuar për t'i realizuar synimet e tua? A e ke ndierë këtë entuziazëm e dhe më parë?

Shpesh ndjejmë entuziazëm të lartë për ndonjë çështje, por në realitet ai s'është gjë tjetër përveçse entuziazëm i përkohshëm dhe i cili i ekspozohet plogështisë dhe ftohjes. Përse ndodh kjo?

Ka shumë shkaqe që ndikojnë në këtë fenomen, mirëpo me lejen e Zotit, ato do t'i prezantojmë pak më vonë. Mirëpo, s'prish punë që të shtrojmë pyetjen tani, me qëllim që të jeni të përgatitur që të përgjigjeni kur të vijë koha.

Dijenja juaj për të njohur pozicionin aktual është urë që shërben të kaloni nga e kaluara në të ardhmen....

Nëse nuk di çfarë zotëron nuk do të dish se çfarë të nevojitet

Njihi potencialet dhe aftësitë që zotëron, nëse dëshironi që t'i zhvilloni më tutje dhe kjo është bazë nga e cila do të

niseni për të ndërtuar ardhmërinë tuaj të ndritur me lejen e Allahut.

Prezenca e vlerave tek ju tregojnë se ju jeni në gjendje për të ndryshuar dhe për të ecur përpara, ndërsa njohja e tyre do t'i ngjajë llambës, e cila ju ndriçon rrugën, sa herë që jeni në errësi.

Marrja e këshillave nga të afërmit, shokët për pikat e fuqishme dhe gjërat që duhet patjetër t'i përmirësoni është e një dobie jashtëzakonisht të madhe.

Njili aftësitë që të mungojnë dhe ato që ke nevojë t'i arrish dhe t'i mësosh.

Nuk kemi si qëllim këtu t'iu dorëzohemi verbërisht mendimeve të kritikëve dhe të atyre që mendojnë negativisht, mirëpo qëllimi është të njohësh veten nga këndvështrimi i të tjerëve, fjala është për pika të qarta dhe të caktuara, që ke mundësi të veprësh për të ndryshuar. Për këtë arsye mos u shqetëso dhe mos prit që çdo gjë që flitet për ty të jetë pozitive.

Mos prit që gjithmonë do të dëgjosh vetëm lëvdata dhe falënderime, por përgatitu që të dëgjosh edhe kritika, por kjo nuk nënkupton se ju jeni person i keq, porse jeni vetëm njerëz...

Një shembull praktik

Ka ardhur koha t'i mësojmë tani ca pika që sqarojnë këtë hap themeltar në çastin e avancimit personal – njohja e pozicionit tënd. A keni dëshirë të udhëtoni në Mekë që ta kryeni umren? Padyshim se ky është një adhurim i madh, i cili kërkon përgatitjen e duhur.

Ku gjendesh ti tani? Nëse gjendeni në Medinë përgatitja juaj do të jetë më e vogël, se sa nëse gjendeni në Damask.

Cilat janë anët pozitive?

Vetura e mirë. Paratë e mjaftueshme

për të udhëtuar. Caktimi i një shume të caktuar të hollash për t'i paguar faturat e shërbimeve komunale gjatë këtij muaji si: uji, dritat etj? Shëndeti i mirë e tërë kjo është në rregull, mirëpo?

Cilat janë anët negative, çfarë të mungon prej aftësive dhe mundësive?

Mosnjohja e rrugës. Marrja e pushimit nga vendi ku punon? Mosnjohja e rregullave për mënyrën e kryerjes së umres? Pagesa e detyrimeve, si shkolla e fëmijëve etj.

Nga ky shembull të bëhet e qartë se ti zotëron gjëra pozitive, që duhet t'i ruash dhe t'i zhvillosh ato, si p.sh makinën që duhet të bësh rregullimin e saj, ta mbushësh me karburant, ta përgatisësh për udhëtim të gjatë, marrja e parave të mjaftueshme për udhëtim, shlyerja e borxheve ...

Mirëpo ekziston edhe një pikë e zezë, e cila ka nevojë që të punosh rreth saj, e ajo është koordinimi dhe ekuilibrimi në mes të nevojave të udhëtimit dhe rëndësisë së pagesës së faturave të duhura posaçërisht në këtë kohë. Nëse i shtojmë edhe pengesat e tjera që i përmendëm më lart, si dhe puna serioze për të shtuar dijen rreth rregullave të shariatit përkitazi me kryerjen e umres në formën më të mirë, ashtu që të pranohet nga Allahu i Madhëruar, blerja e hartës si dhe njohuritë e nevojshme, veçse do të ndihmonin në realizimin e suksesshëm të udhëtimit...

Kjo është pikërisht ajo që duhet ta veproni në jetë. Jeta është udhëtim, që mund ta shndërroni në eksperiencë të mbushur me sfida e joshje, me qëllim që të lini gjurmë të pashlyera dhe kujtime të mira, në anën tjetër këtë udhëtim keni mundësi ta kaloni përplot me dëshpërime

dhe dështime, duke u mjaftuar vetëm me shikimin e karvanit të njerëzve të suksesshëm.

Çfarë dëshironi në fillim

Hidhini një shikim synimeve tuaja, të cilat i keni përcaktuar deri tani dhe do të vëreni se të gjitha nuk janë të një rangu dhe të një rëndësie. Ka prej tyre që janë urgjente, ndërsa të tjerat më pak urgjente. Synimet ndonjëherë janë të shumta e ndonjëherë të pakta, mirëpo kohën që ua kushton nuk zgjat më shumë se 24 orë. Për këtë arsye duhet të preokupoheni vetëm me ato gjëra, që janë të rëndësishme dhe të menjëhershme, dhe t'i shtyni të tjerat kur t'ju vijë çasti i përshtatshëm për t'i kryer edhe ato.

Vëreni tabelën në vijim që të bëhet sa më e qartë ideja.

Shkalla e urgjencës	Shkalla e rëndësisë		
	Shumë e rëndësishme	E rëndësishme	Jo e rëndësishme
Urgjente. Që kërkon një zgjidhje të shpejt.	1	2	3
-Jourgjente. Që nuk kërkon zgjidhje të menjëhershme.	4	5	6

Katrori i **parë** dhe i **dytë**. Përqendrohu në to, ngase përbëjnë gjëra të rëndësishme dhe urgjente, të cilat nuk pranojnë vonim, për këtë arsye ato marrin hisen e tyre të përkushtimit. Mirëpo duhet të kesh kujdes, që e tërë veprimtaria jote të mos jetë tërësisht

reaksion i përhershëm në këmbëngulje për llogari të katrorit të **katërt** e të **pestë**, të cilat përbëjnë synime të rëndësishme, por i anashkalon ato sepse e ndjen që gjithmonë ke kohë të lirë.

Katrori i **katërt** dhe i **pestë**. Preokupohu me to, ngase ato përbëjnë një sferë që ke mundësi të ndryshosh në të, nuk është e ngutshme dhe janë synime, të cilat pranojnë vonim dhe zvarritje. Këta dy katrorë konsiderohen si fushë e suksesit. **Të gjithë njerëzit përqendrohen në katrorin e parë dhe të dytë, për arsye se janë gjëra që nuk e pranojnë vonimin, mirëpo shenja e parë dalluese e njerëzve të suksesshëm është preokupimi i tyre me përmbajtjen e katrorit të katërt dhe të pestë.**

Katrori i **tretë** dhe i **gjashtë**: largohu prej tyre, sepse ato janë humbje kohe, gjëra që aspak nuk meritojnë vëmendje, të pengojnë në preokupimin me synimet tuaja dhe gjëra të kota, që nuk kanë kurrfarë vlere.

Shenja e **dytë** e njerëzve të suksesshëm është braktisja e këtyre dy katrorëve që vetëm ta humbasin kohën.

E rëndësishme dhe shumë e rëndësishme

Shpresoj që deri më tani keni vendosur për veten tuaj një grumbull synimesh, dhe mbase e keni kuptuar, se këto synime nuk mund t'i realizoni nëse nxitoni vullshëm. Nëse bëni një gjë të tillë, atëherë do të jeni shumë afër dëshpërimit dhe dështimit dhe shumë larg arritjes së suksesit. Prandaj s'do mend që duhet t'i përcaktoni këto synime, në atë mënyrë që disave t'i jepni prioritet karshi të tjerave, duke u shërbyer me tabelën e mësipërme, e cila bazohet në masën e rëndësisë dhe shkallën e urgjencës të secilës prej tyre.

Mos gjuaj bosh

Përzgjedhja juaj për gjërat që dëshironi t'i kryeni në çfarëdo kohë të jetës tuaj të përditshme duhet të kryhet vetëm përmes synimeve, të cilat i keni përcaktuar. Mos fut ndër prioritetet tuaja ato që nuk bëjnë pjesë në synimet, që tashmë i keni vendosur, ose ato që mund t'ju ndryshojnë kursin për ku jeni nisur. Nëse veproni kështu, atëherë jeni futur në katrorin e tretë dhe të gjashtë, që ju humbet kohën dhe ju pengon arritjen e objektivave.

Natyrisht se nuk kemi si qëllim, që të punoni gjatë tërë kohës dhe të anuloni kohën e lirë, ose t'ju largoheni zbatimjeve dhe kënaqësive të lejuara, që na ofron kjo botë, sepse kjo do ta bëjë jetën shumë më serioze se saç kërkohet, do të bëjë të ndjehesh i mërzitur deri në atë masë sa që të shpie deri në depresion, ngase shpirti për nga natyra e tij u largohet gjërave që i urren. Ebu Derda, Allahu qoftë i kënaqur me të, përcjell se i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Qetësojini zemrat herë-herë, sepse zemrat plogështohen, e kur plogështohen mërziten, e kur mërziten verbohen.”* (Ebu Davudi)

Ti je lideri

Ju jeni më meritoret për të përcaktuar prioritetet, sepse ju e njihni më së miri veten tuaj. Kjo nuk do të thotë të mos përfitoni nga përvoja e të tjerëve dhe nga idetë e lehtësirat, që ju ofrojnë ata.

Kur t'i përcaktoni prioritetet, atëherë ju veproni me siguri dhe vetëbesim, e po ashtu siguroheni, se nuk do të jeni viktimë e mendimeve dhe e përpjekjeve të të tjerëve në punët tuaja private. I Dërguari i Allahut thotë: *“Mos të bëhet askush servil, e të thotë nëse përmirësohen të tjerët përmirësohem edhe unë, nëse prishen,*

prishem edhe unë.” (Tirmidhiu)

Është marrëzi t'i pezulloni mendimet tuaja origjinale, e t'u viheni pas ideve të huaja, pavarësisht nga motivet e tyre dashamirëse dhe pa marrë parasysh përvojat dhe njohuritë e tyre për jetën. Nëse ju jeni udhëheqës kjo do të thotë se ju grumbulloni njohuri të domosdoshme për të marrë vendimin e duhur, e pastaj vërtetë e ndërmerrni atë. Edhe përkundër këtij fakti, nëse ju mashtron vetja, që të mos ndërmerrni asgjë, ta dini se edhe kjo në vetvete konsiderohet njëfarë vendimi. **Ju keni mundësi të hyni në botën e dështimit me lehtësi të jashtëzakonshme dhe kjo vetëm përmes dy dyerve: të menduarit pa vepruar asgjë dhe veprim pa menduar fare.**

Mësohuni t'i përmirësoni prioritetet gjatë rrugëtimit tuaj

Shumica e synimeve tuaja u nënshtrohen ndryshimeve varësisht prej rasteve dhe mundësive, si dhe sfidave të mundshme, se si i diktojnë rrjedhat e jetës, të cilat mund t'i hasni në rrugë. Sigurisht që pajtoheni me faktin se kokëfortësia dhe pafuqia për të ndryshuar strategjinë varësisht prej prurjeve të reja është një lloj budallallëku. Prandaj mësohuni ta rishikoni regjistrin e prioritetëve dhe shkallën e rëndësisë herë pas here.

Është me rëndësi të theksojmë se fleksibiliteti për t'i shfrytëzuar rastet dhe për ta ndryshuar strategjinë në çastin kur e kërkojnë rrethanat konsiderohet mençuri themelore. Mirëpo kjo nuk duhet kurrësi të na shpjerë në çorientim të rrugës së suksesit dhe humbjes së mundësisë për të njohur kahen e duhur. ■


PREZANTIM I LIBRIT:

NAMAZI DHE DISPOZITA PËR LËNËSIN E TIJ

SHKRUAN: AGIM BEKIRI

Koha në të cilën po jetojmë po shënon një revolucion të madh të përkthimit të literaturës islame. Për këtë flet më së miri numri i madh i titujve, që mund t'i hasim nëpër librari të ndryshme. Njëherësh kjo kthesë e madhe në kulturën shqiptare, sidomos në pjesën kosovare dhe atë të Maqedonisë, ka shkaktuar që libri islam të jetë ndër më të shiturit në panairat mbarëkombëtare. Si rezultat i kësaj edhe shija e lexuesit sa vjen e përkryhet dhe jo çdo libër mund t'i shërbehet lexuesit shqiptar. Tanimë të gjithë e kanë të qartë, se ka kaluar koha kur Islami prezantohej nëpërmjet një Ilmihali apo një doracaku të censuruar nga ana e regjimeve të shkatërruara. Jemi në një kohë kur çdo besimtar ka të drejtë të njihet me dijetarët më të famshëm islam, të cilët kontribuuan në ruajtjen, sqarimin dhe përcjelljen e fesë ashtu siç ka zbritur prej Allahut të Madhëruar.

Njëri prej kontribuuesve më të mëdhenj në këtë drejtim është eruditi Shemsudin Muhammed b. Ebi Bekër i njohur si **Ibën Kajim el-Xheuzije**. Ky dijetar famëmadh ishte një pishtar i vërtetë i besimdrejtëve. Drita e tij nuk u shua me vdekjen e tij, porse vazhdoi të ndriçojë edhe më tej nëpërmjet trashëgimisë kulturore që la pas vetes. Veprat e tij përfshijnë gati të gjitha lëmit e shariatit, prandaj shumë dijetarë kur shprehën fjalë miradije për atë gjendeshin para një udhëkryqi: ta lavdëronin për studimet e tij të thella, për metodën e edukimit të shpirtave



apo për thesaret që i nxirrte nga ajetet dhe hadithet e ndryshme.

Ibën Kajimi në mënyrë mahnitëse ka bërë harmonizimin e argumenteve të shariatit, e gjithë kohës duke iu përmbajtur metodologjisë së të parëve tanë të mirë.

Një prej veprave të tij të rëndësishme është libri i njohur me titullin e këtij shkrimi, që tani mund të bëhet edhe pjesë e bibliotekës së lexuesit shqiptar. Një fjalë e urtë arabe thotë: “Vlera e një shkence përcaktohet në bazë të asaj që e studion e njëjta”, kurse unë do të thosha “Vlera e një libri përcaktohet në bazë të asaj që përmban i njëjti”. Pra, libri flet për namazin, shtyllën e Fesë Islame, kriterin e dallimit mes besimtarëve dhe jobesimtarëve dhe vendstrehimin e vendprehjen e të gjithë atyre që dëshirojnë lumturinë.

Për vlerën e namazit ka shumë për t'u thënë mirëpo mjafton të përmendet se në dallim nga detyrimet e tjera, namazi është urdhri i vetëm i Allahut, që iu dha Muhamedit, salallahu alejhi ue selem, mbi shtatë qiej.

I tërë libri në fakt vjen si përgjigje e disa pyetjeve, të cilat iu parashtruan Ibën Kajimit, Allahu e mëshiroftë. Ato pyetje në realitet

janë tema të tëra, të cilat autori me mjeshtri të rrallë, me argumente të fuqishme, me sqarime të pasuruara nga fjalët e dijetarëve i shtjellon në këtë libër.

Pyetjet e parashtruara tingëllojnë kështu:

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve

Çfarë qëndrimi mban ulemaja e nderuar, të cilët Allahu i ka udhëzuar dhe i ka forcuar në rrugë të drejtë lidhur me këto çështje:

1. Sa i përket atij, që nuk e fal qëllimisht namazin, a është detyrim që ky njeri të vritet apo jo?

2. Nëse vritet, a vritet ai si murted, renegat e qafir i fesë dhe si i tillë, as nuk lahet, as nuk i falet xhenazja dhe as nuk varroset me muslimanët në varrezat e tyre, apo vritet për shkak të kundërvajtjes, që sheriatit e ka caktuar dënim me vdekje (ar. **had**), por përsëri kësaj ai mbetet musliman?

3. Me lënien e namazit; a shkatërrohen dhe a bien të gjitha veprat e njeriut?

4. A pranohen namazet ditore nëse falen natën dhe a pranohen namazet e natës nëse falen ditën?

5. A është i vlefshëm namazi i atij personi që falet i vetmuar, edhe pse ka mundësi që të falet me xhemat?

6. Nëse namazi i një personi të tillë është i vlefshëm, a është mëkatar për shkak të lëshimit të xhematit?

7. A kushtëzohet shkuarja në xhami për të falur namazin apo është e lejuar kryerja e tij në shtëpi?

8. Cila është dispozita për atë që falet shpejt dhe që nuk e plotëson rukunë dhe sexhden në namaz?

9. Sa ka zgjatur namazi i të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem? Si është kuptimi i vërtetë i lehtësimit, në të cilën i Dërguari salAllahu alejhi ue selem ka treguar me fjalët: *“Fale namazin ashtu siç është më lehtë për ta”!* dhe në çka tregojnë fjalët e Tij, që ia ka drejtuar Muadhrit radijAllahu anhu: *“Vallë*

dëshiron t’i sprovosh njerëzit?”.

10. Pyetja e fundit është të përshkruhet se si ka qenë namazi i të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem - prej tekbitit fillestar e deri në përfundim të tij - dhe të përshkruhet e të paraqitet shkurt, kështu që ai i cili pyet të mundet të përfitojë mbresa sikurse të ishte i pranishëm në namazin e të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem.

Allahu subhanehu ue teala, i ka caktuar në Tokë ata që do të udhëzojnë në Rrugë të Drejtë. Ata që do t’i shpjegojnë dispozitat dhe që do t’i paraqesin argumentet. Allahu nuk i ka detyruar të padijshmit për të shpjeguar, por i ka detyruar dijetarët për të shpjeguar dhe për t’i mësuar edhe të tjerët.

Allahu e mëshiroftë pyetësin, i cili e ka formuluar aq bukur pyetjen e tij!

Aty vërejmë se shumica e problematikave që janë parashtruar kanë të bëjnë me lëmin e Fikhut. Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, gjatë zbërthimit të këtyre temave përmend mendimet e ndryshme të dijetarëve dhe në fund shpreh përfundimin e vet. Mund të ndodhë që ndonjëherë kapitullin e përmbyll duke e lënë çështjen e hapur apo duke mos e prerë për shkak të mospajtimit të madh që ka ndodhur në mesin e dijetarëve.

Nëse them se pjesa më fantastike e librit është kapitulli i parafundit, që në disa versione të librit mban titullin “Fshehtësitë e namazit” dhe këtu besoj se nuk do të gaboja. Këtu Ibën Kajimi në mënyrë mahnitëse flet për pjesët e namazit, kuptimin dhe ndikimin e atyre fjalëve e lëvizjeve që i bën falësi. Fillon me komentimin e fjalës “Allahu ekber” (Allahu është më i madhi), kalon nëpër fshehtësitë e sures Fatiha, rukusë e sexhdes dhe përfundon me selamin. Fjalë të këtilla vështirë se mund të gjenden në tjetër vend. Lusim Allahun e Madhëruar që ta mëshirojë këtë imam të madh, ta fus ne Firdeus së bashku me pejgamberët, dijetarët, dëshmorët dhe të devotshmit. ■



PËR KË DO TË VOTONI O PRINDËR!

Duke e kuptuar këtë vlerë sa më mirë kemi rastet e shumë djemve dhe vajzave, që ambiciet e tyre për dije u forcuan dhe mjafton t'i hedhësh një sy shkollave dhe universiteteve e do të shohësh frekuentimin e madh që ka në këto institucione nga besimtarët muslimanë.

SHKRUAN: AGON SIMNICA

Viti 2009 tashmë ka filluar të quhet viti i zgjedhjeve, për arsye se do të mbahen zgjedhjet në hapësirat kryesore shqiptare: Shqipëri, Kosovë e Maqedoni dhe pritet që bisedat kryesore në familjet shqiptare të jenë rezultatet e tyre. Edhe pse vetëm pak ndryshojnë personazhet e qasja e tyre ndaj problemeve të shoqërisë ndryshon po ashtu fare pak, porse tema jonë nuk do të jetë kjo. Ne do t'u drejtohem prindërve të

dashur me pyetjen, se me cilin “elektorat” do t'i bashkoni fëmijët tuaj në këtë kohë kur vëmendja e shumë qarqeve është e përqendruar tek kjo shtresë e shoqërisë, që me të drejtë konsiderohet shtresa më vitale e shoqërisë! Duhet që prindërit të shtojnë kujdesin në këtë kohë të ligë për fëmijët e tyre, në këtë kohë plot me degjenerim.

Ekzistojnë shumë arsye pse prindërit duhet t'i orientojnë fëmijët e tyre drejt fesë së Allahut (Islamit), por së pari dua të bëjë një vërejtje. Kohët e fundit janë shtuar zërat e shumë dashakeqëve, që nuk ia duan të

mirën këtij populli, se sikur dikush po i paguan të rinjtë të udhëzohen me mësimet e Islamit. Kjo nuk qëndron për shumë arsye dhe unë do të mjaftohem me një. Nëse të gjitha ideologjitë, partitë, sektet shërbejnë me të ashtuquajturit spiunë; në Islam jo që nuk pranohen, por edhe llogariten si pjesa më e dëmshme e shoqërisë dhe në Ditën e Gjykimit do të kenë dënimin më të ashpër siç edhe thotë Allahu në librin e Tij. **“S’ka dyshim, munafikët do të jenë në shtresën më të ulët (në fund) të zjarrit dhe për ta nuk do të gjesh mbrojtës...”** Nisa 145. Pra, duhet ta kuptojnë të gjithë njerëzit, se kjo fe pranohet vetëm ata që duan t’i bashkohen sinqerisht asaj dhe nuk ka vend për njerëz të shitur, dhe interesi është vetëm i njeriut që futet në Islam, dhe askujt tjetër e që pastaj si pasojë e shndërrimeve të tij normalisht do të përfitojë shoqëria dhe rrethi nga sjellja, morali dhe puna e tij e mirë, që ky person do të kryejë i ndikuar nga mësimet Islame.

Meqë e sqaruar pikën e parë do të përmend disa arsye shumë të kapshme për secilin, se përse ata duhet t’i orientojnë fëmijët e tyre drejt mësimave Islame dhe ja pse:

1. Do t’i kthejnë ata tek Ai (Allahu) që i ka krijuar dhe ua do të mirën atyre më shumë sesa prindërit dhe është më i mëshirshëm për ta! Shënohet një thënie profetike, se një nënë i kishte humbur foshnja e saj dhe pasi e gjeti atë e kapi dhe e shtrëngoi fort! Muhamedi alejhi selam i pyeti shokët e tij, se çfarë mendonin ata! *A ka mundësi që kjo nënë ta hedhë fëmijën e saj në zjarr?*, - e ata iu përgjigjën assesi. Atëherë Pejgamberi alejhi selam iu tha atyre *“Allahu është më i mëshirshëm për robin e tij, sesa kjo nënë për birin e saj”*. Më thuaj o prind i dashur, pash Zotin, pse ngurren ta drejtosh fëmijën tënd te Krijuesi mëshirëplotë, çfarë të keqe do ta gjejë tek një Mëshirues i tillë?!

2. Feja Islame është fe e natyrshmërisë, është shumëdimensionale dhe ofron zgjidhje për të gjitha problemet. Ka dhënë një zgjidhje të përkryer në mes shpirtërores dhe materiales. I mban larg njerëzit të shndërrohen në murgj (pra, të izolohen në fatore) dhe në “robot” pa ndjenja, ashtu siç i ka kthyer njerëzit kapitalizmi, ku interesi material është lidhja e vetme ndërmjet tyre.

3. Është i përshtatshëm për të gjitha kohët, si për fëmijën, të rriturin dhe për plakun. Kushdo ka pozitën e vet dhe detyrimet e Islamit ndaj pasuesve janë brenda këtyre dallimeve.

4. Jeta e Muhamedit alejhi selam është shembulli më i mirë në të gjitha aspektet. Me të drejtë ai është quajtur njeriu më transparent, jeta e të cilit dihet në detajet më të imta, duke përfshirë jetën e tij publike dhe private. Është shembulli më i mirë i besnikërisë dhe i virtyeteve të tjera. Ai është shembulli se si duhet të jetojë njeriu i pasur: larg shfrenimit (duke falënderuar dhe duke ndarë pasuri për të vobektit), dhe i varfri larg dëshpërimit (duke bërë durim dhe duke pritur shpërblimin vetëm prej Allahut).

5. Islami është fe, që ka si simbol të saj dijen dhe për këtë na mjafton ta kujtojmë lexuesin tonë, se ajeti i parë që i ka zbritur Profetit Muhamed alejhi salatu ue selam ishte **“Ikre”**-Lexo, mëso, studio, po ashtu një prej thënieve të shumta të Profetit Muhamed alejhi selam për këtë pikë na tregon: *“Me të vërtetë për nxënësin e dijes i shtrijnë melekët krahët, dhe kërkojnë falje për të banorët e Qiellit dhe të Tokës; edhe milingona në vrimën e saj, edhe peshku në fundin e detit për atë që ai u mëson njerëzve të dobishmen”*. Duke e kuptuar këtë vlerë sa më mirë kemi rastet e shumë djemve dhe vajzave, që ambiciet e tyre për dije u forcuan dhe mjafton t’i hedhësh një sy shkollave dhe universiteteve e do të shohësh frekuentimin e madh që ka në këto

institucione nga besimtarët muslimanë.

6. Islami i kanalizon aftësitë e njerëzve për atë gjë që janë më të prirur, duke mos i shndërruar ata në një model “bajat” dhe jo të përshtatshëm për natyrën e tyre. Kjo gjë vërehet më së miri tek ata njerëz, që u edukuan nga Profeti Muhamed salAllahu alejhi ue selem, ku kishte prej tyre që merreshin më shumë me dijen, si Ebu Hurejre, ku kishte prej tyre që merreshin me adhurim, si Abdullah b. Amr b. Asi, ku kishte asketë si Ebu Dherri, ku kishte edhe ekspertë të taktikave luftarake, si Halid b. Uelidi. Megjithëse rrugët ishin të ndryshme qëllimi ishte i njëjtë dhe kjo nuk përbente aspak problem për të gjithë këta njerëz. Këtë e ka shprehur shumë bukur edhe dijetari nga Andaluzia, Ibën Hazmi, që thotë: merru me atë dije që ti ke prirje, edhe nëse është me e ulët për nga vlera, se e kotë është mbjellja e bananeve në Andaluzi (d.m.th., kushtet klimatike nuk janë të mira në atë vend, edhe pse banania mund të duket pemë e mirë.)

7. Islami nuk e sheh moshën si problem në vendime, por dallimin kryesor e sheh në aftësitë e tyre. Këtë mund ta ilustrojmë me disa shembuj nga jeta e shokëve të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Njërin prej haditheve bazë të fesë sonë: “*Ruaje Allahun, të ruan Ai ty...*” e deri në fund Pejgamberi, paqja dhe bekimet qofshin mbi të, ia tregoi Ibën Abasit, edhe pse ai ishte në moshë të vogël. Po ashtu Omeri, kalifi i dytë e merrte Ibën Abasin në takime me pjesëmarrësit e Bedrit (ku diskutoheshin problemet më të rëndësishme të shtetit islam), ndërkohë që ata ishin shumë më të vjetër se ky. Profeti salAllahu alejhi ue selem, e kishte caktuar Usame b. Zejdin udhëheqës e në komandën e tij ishin kalifët e mëvonshëm Ebu Bekri dhe Omeri, ndërkohë që Usamja ishte vetëm 18 vjeç.

7. Dallimi ndërmjet “yjeve” të shokëve të

“...Merru me atë dije që ti ke prirje, edhe nëse është me e ulët për nga vlera, se e kotë është mbjellja e bananeve në Andaluzi...”

Pejgamberit dhe “yjeve” modernë është i dukshëm. Njëri prej objektivave të Islamit është edhe ruajtja e nderit, prandaj rinia muslimane duhet ta marri për shembull dashurinë e Aishes, Zoti qoftë i kënaqur prej saj, ndaj Muhamedit alejhi selam, e cila ishte grua e ligjshme dhe me kurorë e jo “**Romeon dhe Zhulietën**”, që dihet se si filloi (marrëdhënie jashtëmartesore) dhe se si përfundoi (me vetëvrasjen e të dyve). Ndërsa për botën e “yjeve” modernë mjafton të shikosh lajmet e shou bizit në Hollivud dhe do të dëgjosh skandale të vazhdueshme, duke filluar nga tradhtitë bashkëshortore, alkooli, droga, tentim vrasja dhe në fund vetëvrasja!

Si përfundim, ju mbetet prindërve të zgjedhin, nëse duan t’i edukojnë fëmijët në bazë të ajetit 23 të sures Isra: “*Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë, që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre, as “of - oh”, as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese)*”. Apo kur të plaken t’i dërgojnë ata në shtëpitë e pleqve dhe të vdesin atje të vetmuar, ku fatkeqësisht numri i tyre po rritet dita ditës! ■

SI TI EDUKOJMË FËMIJËT QË TA DUAN NAMAZIN

Xhamitë janë shtëpitë e Allahut, ku prodhohen dhe edukohen burra të mëdhenj, të cilët zemrat i kanë të lidhura me Allahun subhanehu ue teala.

LEJLA EN NAXHI

Për çdo prind! Le të jetë dhuratë ky ajet: *“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër, që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar.”* Tahrim 6.

Ahnef b. Kajsî e përkujtonte Muavijën për mirësinë e fëmijës: “O udhëheqës i

besimtarëve, ata janë frytet e zemrave tona dhe mbështetja e shpinave tona. Ne për ata jemi si toka e nënshtruar dhe si qielli që bën hije, ndërsa me ndihmën e tyre kalojmë çdo vështirësi. Pra, kur kërkojnë diçka, atëherë jepu e kur zemërohen, atëherë pajtoji, sepse kështu do ta dhurojnë dashurinë e tyre dhe do të ta bëjnë të dashur mundin e tyre.”

Fëmijët tanë janë freskim dhe kënaqësi për ne. Allahu subhanehu ue teala i këshillon prindërit, që të jenë të kujdesshëm ndaj fëmijëve të tyre. I Dërguari i Allahut Muhamedi salallahu alejhi ue selem i



këshillon prindërit, që të jenë të kujdesshëm dhe të sjellshëm ndaj fëmijëve të tyre, duke u treguar *se më i miri prej tyre është ai që është më i mirë për familjen e vet*. Ndërsa forma më e mirë e edukimit është që atyre t'u mësohet namazi dhe t'u mbillet dashuria e këtij simboli në zemrat e tyre, që ata ta kryejnë me rregull dhe seriozitet.

Pra, namazi është një simbol, të cilin Muhamedi salallahu alejhi ue selem e ka quajtur dritë dhe shtyllë të fesë. Ai është një nyje, e cila e lidh robin me Krijuesin e vet pesë herë në ditë. Ky simbol është edhe stacion në të cilin robi veçohet me Krijuesin e Vet dhe do të jetë shpëtim për të në Ditën e Gjykimit.

Duke e kryer këtë ritual robi i drejtohet Zotit të tij, e Zoti i Tij ia kthen duke iu përgjigjur: *Më falënderoi robi im, më madhëroi robi im... dhe për robin tim ka çka të kërkon ai*.

Gjithashtu ky ritual është çelësi i xhenetit dhe antivirusi më efektiv për mbrojtjen e tij nga mëkatet. Këtë e dëshmon fjala e Allahut subhanehu ue teala kur thotë: ***“...vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe ngacmimet...”*** Ankebut 45.

Muhamedi salallahu alejhi ue selem i ka nxitur prindërit, që ata qysh në fëmijëri të përpiqen e t'ua mësojnë këtë ibadet dhe t'ua bëjnë atyre të dashur, në këtë mënyrë ata ta kuptojnë edhe fshehtësinë që ngërthen në vetvete duke na thënë: *“Urdhëroni fëmijët tuaj për namaz në moshën shtatëvjeçare, ndërsa në moshën dhjetëvjeçare rrihni pak dhe ndani në shtrat.”* E përcjell Ebu Davudi. Duke u mbështetur në aspektin praktik të këtij hadithi desha që vëllezërve të mi baballarë dhe motrave të mia nëna t'u paraqes disa rregulla, të cilat do t'i ndihmojnë ata që t'ua bëjnë të dashur këtë ibadet. Po ashtu duhet të kemi parasysh se këto rregulla studiohen edhe nga pedagogët dhe thirrësit në rrugën e Allahut.

“Shembulli i mirë iu ofrohet fëmijëve në atë formë kur prindi është korrekt në çështjen e namazit, duke mos e vonuar atë nga koha e vet...”

E para: Edukimi me frymën e besimit

Prindi nuk mund të mbjellë tek fëmijët plotësisht dashurinë ndaj namazit, duke pasur ata zbrazëti në sferën e besimit, sepse shumë çështje të besimit kanë të bëjnë me botën e fshehtë, i cili nuk mund të arrihet me anën e shqisave, por vetëm duhet ta besojmë ashtu siç na ka mësuar Muhamedi salallahu alejhi ue selem dhe rolin kryesor në këtë rast e luan prindi.

Në këtë sferë kemi shëmbëlltyrë planin e misionit të të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem, i cili gjatë periudhës së Mekës u mor fillimisht me çështjet e besimit derisa ua mbolli atë në zemër, kështu që sahabët nuk kishin pengesa për t'i zbatuar rregullat e sheriatit. Nëse arrihet kjo atëherë fëmija, që në moshë të hershme mund ta kuptojë se Allahu është Krijuesi i tij; Ai i furnizon dhe i mirëmban krijesat, Ai udhëzon kë të dojë në rrugë të drejtë dhe i do njerëzit e mirë e i urren ata që janë të ligj. Për këtë shkak edhe të dërguarit e Tij kanë qenë njerëzit më të zgjedhur të njerëzimit.

E dyta: T'u ofrohet atyre një shëmbëlltyrë e mirë

Shembulli i mirë iu ofrohet fëmijëve në atë formë kur prindi është korrekt në çështjen e namazit, duke mos e vonuar atë nga koha e vet, si dhe duke u angazhuar nganjëherë edhe në faljen e namazeve nafile në shtëpi me fëmijët etj. Kjo gjë ndikon që

edhe fëmija të ndjekë rrugën e prindit të vet. Është e pëlqyeshme që prindi ta rregullojë orarin e shtëpisë në bazë të kohëve të namazit. Për shembull, nëse do të bëjë ndonjë vizitë, le t'u thotë fëmijëve që po shkojmë për vizitë pas namazit të iqindisë, apo pas namazit të akshamit. Domethënë jeta e tij të lidhet sa më ngushtë me kohët e namazit.

Nëse prindërit e bëjnë shprehi që mos t'u ikë atyre koha e namazit, nuk mbetet hapësirë që fëmijët ta vonojnë apo ta lënë pas dore këtë ibadet. Njëkohësisht duhet që fëmijëve përveç aspektit teorik t'u jepet edhe ana praktike duke i mësuar ata se si të marrin abdes apo si të falen, si dhe duke i përmirësuar ata për gabimet që bëjnë gjatë kryerjes së ndonjë ibadeti.

E treta: Tregimet

T'u drejtohesh fëmijëve me fjalë të drejtpërdrejta do të ishte gjë e rëndë për ta, ngase ai e kupton si një detyrë e cila është vetëm për të rriturit, si dhe një gjë e cila e ndalon atë prej lojës me shokët e vet. Por kur t'ua paraqesim atyre pasqyrën e njerëzve të mirë, të cilët zemrat e tyre kanë qenë lidhur ngushtë me Allahun subhanehu ue tealë, do t'u duket e lehtë kjo gjë. P.sh., duke u treguar atyre se Resulullahu salallahu alejhi ue selem duke u falur natën iu kanë trashur këmbët. Këtë gjë e ka bërë vetëm duke iu falënderuar Allahut për dhuntitë që ia ka dhënë. E dikujt i është prerë ndonjë gjymtyrë nga sëmundja që kishte, por nuk e ka vërejtur derisa e ka përfunduar namazin.

E katërta: Shoqërimi i tyre në xhami

Xhamitë janë shtëpitë e Allahut, ku prodhohen dhe edukohen burra të mëdhenj, të cilët zemrat i kanë të lidhura me Allahun subhanehu ue tealë. Aty gjejnë edhe ligjërata të ndryshme, ku do të

udhëzohen ata në rrugë të drejtë dhe do të shoqërohen me njerëz të mirë. E kjo është privilegj për ta, se marrin pjesë nëpër vende publike me njerëz të mëdhenj.

Duke luajtur këtë rol është edhe më e lehtë për prindin, që t'ua rregullojë orarin e mësimëve fëmijëve dhe t'i nxitë ata që në shtëpi të bëjnë ndonjë bibliotekë, ku të kenë libra të ndryshëm në te dhe ta bëjnë shprehi leximin.

E pesta: Dhurata

Baza themelore për ta motivuar dikë për ndonjë vepër është shpërblimi i tij. E sidomos tek fëmijët është edhe më e dukshme dhe se ky gjest luan rol pozitiv për ta motivuar fëmijën që të jetë korrekt për çdo punë, e sidomos kur është në fjalë namazi.

Mënyra se si duhet t'i jepet dhurata fëmijës. Pedagogët thonë se ajo duhet t'i jepet para anëtarëve të tjerë të familjes, sepse vlera e dhuratës është shkak që ai ta kuptojë edhe vlerën e namazit.

Pastaj dijetarët – pedagogët thonë se fëmija fillimisht duhet të ushtrohet, që të falë një namaz në ditë, pastaj dy e pastaj tre e kështu me radhë deri sa të bindet, se duhet të falet pesë herë në ditë.

Përfundim. Që të arrihet një gjë e tillë prindi duhet t'i kushtojë kujdes kohës dhe të shfrytëzojë të gjitha metodat pozitive, të cilat e ndihmojnë këtë proces e kjo vetëm e vetëm që të arrihet mbjellja e dashurisë ndaj namazit. Kjo dashuri i bënë fëmijët të nënshtruar para prindërve të tyre dhe ata janë faqe të bardha në të cilët shënohet sjellja, mirësia dhe besimi i pastër. ■

Nga arabishtja: Enver AZIZI

“FALE NAMAZIN” URDHËR NGA ALLAHU

“Çfarë u solli juve në Sekar (xhehenem)? Ata thonë: Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin, si dhe nuk kemi qenë që ushqenim të varfrit dhe kemi qenë që përziheshim me të tjerët në punë të kota. Dhe kemi qenë që nuk e besonim Ditën e Gjykimit. Derisa na erdhi vdekja.”

SHKRUAN: BASHKIM BAJRAMI

Allahu i krijoi krijesat për ta adhuruar Atë dhe i detyroi ata me adhurime të ndryshme shpirtërore, trupore si dhe me pasuri. Nga adhurimet më të rëndësishme trupore Ai subhanehu ue teala, bëri namazin, duke e bërë atë si lidhjen më të fort mes robit dhe Krijuesit, me të njeriu e ripërtërin besatimin që i ka dhënë Krijuesit, afrohet tek Ai dhe pastrohet prej mëkateve, si dhe kërkon prej të mirave të dynjasë dhe ahiretit.

Ky adhurim dallohet nga adhurimet e tjera, ngase është i vazhdueshëm, çdo ditë nga pesë herë, për çdo musliman dhe muslimane të moshërritur, që nuk ndërpritet deri në vdekje dhe nuk arsyetohet askush për lënien e tij, edhe nëse është në shtratin e vdekjes. Allahu thotë në librin e Tij fisnik: **“Vazhdoni rregullisht namazet, edhe atë namazin e mesëm, dhe ndaj Allahut të jeni respektues”**. Bekare, 238. Gjithashtu thotë: **“Falenë namazin dhe jepni zekatin.”** Bekare, 110.

Gjithashtu edhe i Dërguari jonë në shumë hadithe na bën me dije për detyrueshmërinë dhe vlerën e namazit, ku e ka renditur menjëherë mbas shehadetit, siç ka thënë: **“Islami është ngritur mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk meriton askush tjetër të**

adhurohet përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit dhe kryerja e haxhit”. Buhariu, Muslimi.

Allahu i Madhëruar e ka lidhur shpëtimin dhe hyrjen në Xhenet me namaz, siç thotë në fillim të sures Muëminun: **“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përlurur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit”**, si dhe në ajetin tjetër: **“...dhe ata që i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre. Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë Firdeusin dhe aty ata janë përgjithmonë”**.

Komentuesit e Kuranit si Ibën Kethiri, Shevkani, Sa’di, e të tjerë thonë se ky ajet ka si qëllim shpëtimin nga zjarri i xhehenemit dhe fitimin e xhenetit.

Dijetari i njohur Abdurrahman Sa’di thotë duke na shpjeguar të përlururit në namaz, se ai nënkupton të kryerit e namazit me zemër të përqendruar, duke e ndjerë afërsinë e Krijuesit duke iu qetësuar zemra dhe shpirti dhe i ndalen lëvizjet në shenjë edukate në raport me Zotin e Gjithësisë, duke qenë i përqendruar në atë që thotë dhe vepron në namazin e tij prej fillimit e deri në mbarim, kështu duke i larguar vesveset dhe mendimet e kota e ky është shpirti i namazit dhe qëllimi i tij, se namazi pa përkushtim dhe pa praninë e zemrës, edhe pse shpërblehet ai është i mangët.

Nuk ka dyshim që shejtani është armiku më i hidhur i njeriut, ai çdo herë mundohet ta shqetësojë besimtarin. Porsa njeriu fillon të falet, papritmas mendjen e tij e gëlltisin kujtimet, problemet, mërzitë, puna dhe familja.

Ndodh që të pushtohet aq shumë, sa që në vetvete ai s'e ka fare idenë se ku gjendet dhe çfarë është duke bërë. Namazi i tij shndërrohet në një seri lëvizjesh automatike dhe shpeshherë e gjen veten të habitur, duke u menduar a i ka falur tre rekate apo katër, kështu shejtani e vjedh namazin e tij. Pejgamberi alejhi salatu ue salam në një rast ka thënë: *se vetëm një pjesë e vogël e namazit, ndoshta një e dhjeta apo një e teta pranohet tek Allahu.* Pjesa tjetër humbet për shkak të pëshpëritjeve të shejtanit.

Sureja Maun tregon gjithashtu për moskujdesin ndaj namazit. Duke na tërhequr vërejtjen në këtë ajet kuranor thuhet: ***"Pra, shkatërrim është për ata që falen, që ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm."*** Maun 4, 5.

Besimtari është i pakujdesshëm ndaj namazit të tij, atëherë kur e vonon atë deri në minutën e fundit, ose kur nuk përqendrohet plotësisht në atë që është duke bërë apo duke thënë.

Nuk ka dyshim se vlera e namazit është shumë e madhe, e kjo shihet edhe nga fakti se ai është prej veprave më të mira dhe më të dashura tek Allahu i Lartësuar, që e afron robin dhe e ngre në shkallë të larta tek Allahu, siç ka marrë përgjigje sahabiu i njohur Theubani radijallahu anhu, kur e ka pyetur Pejgamberin alejhi salatu ue salam, se cila vepër të shpie më shumë në xhenet, ndërsa ai iu përgjigj: *"Të porosis me sexhde të shumta për Allahun, sepse për çdo sexhde që bën, ty të shkruhet një e mirë dhe të fshihet një e keqe."* Muslimi.

Namazi është mburojë kundër të keqes, siç thotë Allahu në Kuran: ***"Fale namazin, vërtet***

namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irrituarat." Ankebut, 45.

Nëse njeriu e sjell vazhdimisht ndër mend, se pesë herë në ditë duhet të qëndrojë në sexhaden e tij, duke iu drejtuar Allahut kjo do ta parandalojë atë në kryerjen e gjynaheve, që shejtani e ka inkurajuar t'i bëjë. Nëse namazi kryhet rregullisht në kohën e caktuar do t'i sigurojë rehati, si dhe fuqi për tejkalimin e telasheve, sepse në zemrën e tij mbillet ndjenja, se është nën mbikëqyrjen Allahut, i kujdesshëm ndaj kohëve të namazit në kohën e vet, e mposht epshin dhe dembelizmin duke e nxitur në vepra të mira dhe duke u larguar nga veprat e këqija.

Muslimani pasi ta kuptojë vlerën dhe peshën e namazit, a ka krim më të madh se lënia e namazit dhe shembja e shtyllës së Islamit? Prandaj kanë ardhur edhe ajete e hadithe kërcënuese për atë që e len pas dore, siç thotë i Dërguari i Allahut: *"Vërtet midis njeriut besimtar dhe mosbesimit është lënia e namazit."* Muslimi.

Muhamedi salaAllahu alejhi ue selem në një hadith sahih ka thënë: *"Gjëja e parë që do të pyetet njeriu në Ditën e Gjykimit është namazi. Nëse namazi është në rregull, të gjitha veprat e tjera të tij do të jenë në rregull, nëse namazi i tij nuk është në rregull, të gjitha veprat e tjera nuk do të jenë në rregull."*

Allahu në Kuranin Famëlartë tregon për një dialog interesant, që do të ndodhë në Ditën e Gjykimit. Besimtarët do t'i pyesin banorët e xhehenemit: ***"Çfarë u solli juve në Sekar (xhehenem)? Ata thonë: Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin, si dhe nuk kemi qenë që ushqenim të varfrit dhe kemi qenë që përziheshim me të tjerët në punë të kota. Dhe kemi qenë që nuk e besonim Ditën e Gjykimit. Derisa na erdhi vdekja."*** Mudethir 42-47.

Pendohu, o lënësi i namazit para se të arrijë vdekja befás, siç thotë edhe një poet: "Sa të shëndoshë kanë vdekur pa sëmundje, sa të sëmurë kanë jetuar gjatë..." ■

“A E DËGJON EZANIN, ATËHERË PËRGJIGJU!”


Nga Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, na përcillet se ka thënë: “Një ditë një njeri i verbër erdhi tek i Dërguari i Zotit, salallahu alejhi ue selem, dhe i tha: O i Dërguar i Zotit, unë jam i verbër dhe nuk kam njeri të më shoqërojë për të ardhur në xhami, e kështu kërkoi nga Profeti, salallahu alejhi ue selem, që t’i jepte leje të mos vijë në xhami, por të falet në shtëpi. Profeti, ia mundësoi një kërkesë të tillë, mirëpo pasi ky njeri u nis për t’u larguar Profeti e thirri prapë që të kthehej dhe e pyeti se: a e dëgjonte ezanin, kur ai thirrej për namaz? Njeriu i verbër iu përgjigj: Po. Atëherë Pejgamberi i tha: “Përgjigju pra (kësaj thirrje).”

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Hadithin e përcjell Ebu Hurejre dhe Abdullah b. Umi Mektumi. Transmetimin e Ebu Hurejres e shënon imam Muslimi në Sahihun e tij nr. 1484 dhe Nesaiu në “Sunenin” e tij, nr. 849, i cili edhe është i shënuar në fillim të kësaj teme. Ndërsa transmetimin e Abdullah b. Umi Mektumit e shënon Ebu Davudi në “Sunenin” e tij, nr. 548 dhe 549. Dy transmetimet e Ebu Davudit kanë pak ndryshime në fjalë nga hadithi i lartpërmendur, por kuptimin e kanë të njëjtë. Abdullah b. Umi Mektumi na tregon se ai ishte personi në fjalë, gjë të cilën nuk e gjejmë te hadithi i Ebu Hurejres.

Rëndësia e hadithit:

Ky hadith është një prej tre haditheve më të rrepta për rëndësinë e namazit me xhemat dhe rrezikun e lënies së tij. Hadithi i dytë është fjala e Profetit, salallahu alejhi ue selem:



“Gati kam vendosur që të urdhëroj dikë nga ju t’ua falë namazin me xhemat e unë t’i marr ca djelmosha dhe së bashku me ta të shkoj në shtëpitë e atyre që nuk vijnë në xhami për t’u falur me xhemat e kështu t’ua djeg shtëpitë e tyre.” (në një transmetim shtohet edhe fjala: *“Ajo që më pengon është familjet dhe fëmijët e tyre”*). Shënon Buhariu, nr. 644, 657 etj. Muslimi, nr. 1480, Ebu Davudi, nr. 548 dhe 549.

Kurse hadithi i tretë është fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *“Kush e dëgjon ezanin dhe nuk ka arsye për të mos ardhur në xhami nuk i pranohet ai namaz”*, shokët e tij e pyetën: Cila konsiderohet arsye? I Dërguari, salallahualejhi ue selem tha: *“Frika ose sëmundja”* Shënon Ebu Davudi, nr. 551, me zinxhir transmetuesish të saktë.

Komentimi i hadithit:

“Një ditë një njeri i verbër erdhi tek i Dërguari i Zotit, salallahu alejhi ue selem”

Sahabët shkonin për të marrë dije dhe për të pyetur tek Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, sepse e dinin rëndësinë e dijetarëve, se vetëm ata duhen pyetur e jo t’i fusë hundët në të çdokush, i cili pretendon se ka lexuar një “Ilmihal”, apo e ka pasur gjyshin haxhi, ose e mban në kokë një kapelë të bardhë (kapuç të haxhilerëve) e me këtë ia lejon vetes të japë fetva pa kurrfarë përgjegjësie. Gjithashtu sahabët shkonin pas dijetarëve dhe e kërkonin dijen jo vetëm ata që ishin të shëndoshë, por edhe ata që kishin ndonjë sëmundje apo mangësi fizike, si rasti në fjalë i këtij të verbëri. Kjo dukuri nuk vërehet në kohën tonë, ku shumica e besimtarëve të kohës sonë tregohen shumë asket ndaj mësimëve të dijetarëve apo hoxhallarëve. Jo vetëm që nuk vrapojnë pas derseve të tyre, por edhe nëse hoxha kërkon nga ata që t’u shkojë në shtëpitë e tyre e t’i mësojë, nuk do të pranonin duke u arsyetuar se janë të zënë. Pra, është një kohë e mjerueshme, ku njerëzit

janë të zënë ku ta dish me çfarë dhe nuk kanë kohë për t’u shkuar hoxha pas që t’i mësojë, zihen me punë sado të thjeshta, që të arsyetohen për mosmësimin dhe në llogari të dijës fetare. Kjo gjendje e përmendur nuk ekziston vetëm tek njerëzit që janë jashtë xhamisë, por edhe tek ata brenda saj, ndoshta për fat të keq tek shumica e tyre, kur i sheh si namazin e falin me vite dhe është në moshën më të mirë të jetës së tij e megjithatë nuk di akoma ta lexojë Kuranin në gjuhën origjinale, ashtu siç ka zbritur. Sahabët ishin të etur për dituri, etje kjo e cila nuk shuhej kurrë edhe atëherë kur ishin të verbër, ndërsa sot njerëzit janë të etur bile edhe të uritur pas kësaj bote mashtruese dhe kalimtare, kurse mësimi i fesë së tyre është harruar. Pikërisht i asaj feje në të cilën gjendet ardhmëria e vërtetë, pra, fitimi i botës tjetër, ardhmëri kjo e garantuar.

Përmendëm në fillim të komentimit se Ebu Hurejre e përcjell hadithin pa e zënë në gojë emrin e personit, që i kishte ndodhur rasti. Kjo tregon edukatën e sahabëve që kishin me njëri-tjetrin dhe me besimtarët në përgjithësi, pasi në këtë hadith u kërkua një leje, e cila nuk u aprovua nga i Dërguari salallahu alejhi ue selem, Ebu Hurejre e pa të arsyeshme të mos e tregonte se kush ishte ai njeri, sepse kishte frikë mos po e merrte nëpër gojë personalitetin e tij, apo ndoshta njeriu i verbër dëshiron të mbetet anonim e për të qenë më i sigurt nuk përmendi asnjë emër.

Në transmetimin e vet Abdullahut, pra personit që i ndodhi ky rast, ai e përmend se ky rast i kishte ndodhur atij, duke mos e pasur problem se çfarë kishte ndodhur, por për të ishte me rëndësi, që ky hadith t’u mbetej brezave të ardhshëm sa më i plotësuar dhe sa më i detajuar, duke mos i interesuar se në të ai tregonte për veten e tij, pra, ai sakrifiko personalitetin e vet për hir të dijës dhe të brezave të ardhshme që informatat t’i kishin

sa më të sakta.

Fjalja në hadith:

“I tha: O i Dërguar i Zotit, unë jam i verbër dhe nuk kam njeri të më shoqërojë për të ardhur në xhami”

Ky sahabi, Allahu qoftë i kënaqur me të, i tregoi Profetit, salallahu alejhi ue selem, për rastin e tij dhe arsyeën pse kërkonte një leje të tillë. Kjo është prej kushteve dhe edukatës gjatë pyetjes, pra, së pari t’ia sqarosh mirë pyetjen, t’ia tregosh mirë historinë dhe gjendjen e caktuar për të cilën dëshiron të pyesësh. Nuk lejohet që pyetja të bëhet duke bërë lajka në të dhe duke mos e përmendur rastin mu ashtu si është. Nuk lejohet që ajo të rregullohet në atë mënyrë që pastaj përgjigja të jepet ashtu si dëshiron pyetësi dhe si i leverdis atij. Një njeri dëshironte të mbante qen, por e kishte kuptuar se mbajtja e qenit pa nevojë nuk lejohet, atëherë vendosi ta pyesë një hoxhë duke i bërë lajka në pyetje që hoxha t’i jepte një fetva me të cilën ai do të arsyetohej para të tjerëve, ku edhe i tha: Hoxhë, a lejohet mbajtja e kafshëve në shtëpi? Pra, ai bëri një pyetje të përgjithshme me të cilën po të mos ishte ai hoxhë largpamës do t’i jepte një përgjigje të përgjithshme duke i thënë: po. Mirëpo hoxha nuk ra në grackë dhe i tha: Cilën kafshë ke si qëllim?...

Prandaj pikë së pari kushdo besimtar duhet të jetë i sigurtë gjatë pyetjes së tij, dhe ta tregojë të gjithë rastin duke mos fshehur asnjë detaj të tij, dhe të jetë sa më i sigurtë në të, sepse nëse ndodh e kundërta, atëherë kur t’i jepet fetvaja jo e duhur, le të mos e akuzojë aspak dijetarin e as të mos mendojë se ajo fetva do ta arsyetojë para Allahut, ashtu siç mund ta arsyetojë atë para njerëzve.

Fjalja në hadith:

“Kështu kërkoi nga Profeti, salallahu alejhi

“Pyetja e Profetit për dëgjimin e ezanit sikur na jep shenjë, se ai që nuk e dëgjon ezanin për shkak të largësisë së xhamisë e ka një arsye të justifikueshme për të mos marrë pjesë në namazet me xhemat...”

ue selem, që t’i jepte leje të mos vijë në xhami, por të falet në shtëpi”

Kjo fjali na tregon se ky sahabij, pra, Abdullah b. Umi Mektumi, edhe pse ishte duke e bërë këtë pyetje ai deri në atë moment nuk kishte lënë pa falur asnjë namaz në xhami, mirëpo kërkonte ndonjë lehtësim, i cili do të vlente për të pasi ai mendonte se kishte arsye për t’iu dhënë një leje e posaçme. Ajo që vërteton faktin se Abdullah b. Umi Mektumi i kushtonte rëndësi faljes në xhami dhe nuk mungonte nga ajo, janë disa transmetime të tjera të këtij rasti, të cilët nuk i përmendëm për shkak të hapësirës së vogël, në të cilat thuhet, se ai mes shtëpisë së tij dhe xhamisë kishte një luginë që duhej ta kalonte, shtëpinë e kishte larg, ishte në moshë të shtyrë, shoqëruesi që i tregonte rrugën nuk kujdesej sa duhej për të, rreth Medinës kishte kafshë, të cilat mund ta sulmonin si gjarpinjtë gjithashtu edhe insekte të rrezikshme si akrepat etj., por ai megjithatë deri në atë çast me gjithë vështirësitë vazhdonte të vinte në xhami, madje ai ishte njëri prej dy myezinëve të xhamisë së Profetit, salallahu alejhi ue selem.

Disa dijetarë mendojnë se ky sahabi, kur e

bëri këtë pyetje përmes saj kishte si qëllim që t'i arsyetohej mosardhja në xhami dhe në të njëjtën kohë t'i shkruhej sevapi i xhematit, ngase sipas tyre ai kishte mjaft arsye të mos merrte pjesë, por ngaqë dëshironte shpërblimin e xhematit e bëri këtë pyetje.

Ka edhe një mendim tjetër pse ky sahabi kërkoi leje për mos paraqitjen në xhami, ku në të thuhet se Ibën Umi Mektumi pasi ishte muezin i xhamisë kërkoi nga Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, që ta largonte nga kjo detyrë për shkak të vështirësive të tij për ardhje në çdo kohë në xhami (për këtë pikë do të flasim më vonë).

Fjalja në hadith:

Profeti, ia mundësoi një kërkesë të tillë, mirëpo pasi ky njeri u nis për t'u larguar Profeti e thirri prapë që të kthehej dhe e pyeti se: a e dëgjonte ezanin, kur ai thirrej për namaz? Njeriu i verbër iu përgjigj: Po. Atëherë Pejgamberi i tha: "Përgjigju pra (kësaj thirrje)."

Në këtë fjali shihet se si i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, fillimisht ia dha një leje të tillë, por a thua pse e ndryshoi prapë fetvanë e tij? Rreth kësaj pike ka disa mendime ndër të cila do të veçoja këto:

- Disa mendojnë se i Dërguari i Zotit, salallahu alejhi ue selem, pasi e dha këtë fetva, Allahu i dërgoi shpalljen, që ta ndryshonte atë me një fetva më të mirë, pra, Allahu e përmirësoi. Mirëpo mendoj se sikur të ishte diçka e tillë, atëherë këtë gjë do ta tregonte i Dërguari, salallahu alehi ue selem, sepse ishte njeri modest, aq më tepër kur ka të bëjë me një njeri për të cilin Allahu disa vite më parë sa ishin në Mekë e pat kritikuar përmes ajeteve të kaptinës "Abese" e me këtë rast Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, i kërkoi të falur Ibën Umi Mektumit dhe sa herë që takohej me të kishte një respekt të veçantë.

- Disa mendojnë se të Dërguarit, salallahu

alejhi ue selem, i lejohet ixhtihadi (dhënia e mendimit të tij) për çështje të caktuara, ku si rezultat i saj edhe mund të ndryshonte ixhtihadin (mendimin) e caktuar, mu ashtu si ndodhi në këtë rast.

- Disa tjerë thonë se i Dërguari ia lejoi mospraninë në namazin me xhemat, ngase kishte arsye, por me këtë mungesë këtij të verbëri do t'i mungonte edhe shpërblimi i xhematit, i cili në fakt është njëzetë pesë apo njëzetë e shtatë herë (sipas dy transmetimeve) më i madh se falja vetëm, kështu që ai e dinte se ky njeri i verbër me gjithë arsyen e tij ishte prapë në gjendje dhe kishte mundësi e vullnet të vinte në xhami, prandaj edhe i kërkoi atij një gjë të tillë, që të mos i mungojë shpërblimi i xhematit.

Pyetja e Profetit për dëgjimin e ezanit sikur na jep shenjë, se ai që nuk e dëgjon ezanin për shkak të largësisë së xhamisë e ka një arsye të justifikueshme për të mos marrë pjesë në namazet me xhemat, edhe pse disa dijetarë nuk pajtohen me këtë mendim, duke mbajtur qëndrimin se mosdëgjimi i ezanit nuk është justifikim për mosparaqitje.

Fjala: "Përgjigju", nënkupton se në çastin që dëgjohej ezani, besimtari duhet t'i përgjigjet thirrjes për namaz në xhami dhe ta lërë çdo punë tjetër, të hyjë në xhami dhe ta falë namazin.

Fjalja e Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem; "Atëherë përgjigju thirrjes (ezanit)" është argument për dijetarët, të cilët mbështesin mendimin se falja e namazit në xhami është farz (detyrim). Dijetarët rreth dispozitës së sheriatit për paraqitjen në xhami gjatë faljes së namazeve apo jo, janë ndarë në katër mendime:

1- Grupi i parë thonë se falja në xhami është farz individual (ajn) për çdo besimtar.

2- Mendojnë se është farz kolektiv (kifaje), ku nëse një grup besimtarësh shkojnë në xhami për t'u falur të tjerët nuk e kanë detyrim paraqitjen në xhami.

3- Disa mendojnë se ai është sunet i fortë.

4- Pati të tillë që shkuan deri në ekstremizëm dhe mendojnë se falja me xhemat është kusht për pranimin e namazit, ashtu sikurse është kusht abdesi, hyrja e kohës së namazit etj.

Sido që të jetë, mendimet të cilat janë diskutuar më shumë dhe që kanë pasur argumente më bindëse janë dy, ai i pari dhe i treti.

Imam Buhariu në kapitullin që përmend hadithin e djegies së shtëpive të personave që nuk vijnë në xhami për t'u falur me xhemat e emëron me titullin: **“Kapitulli që argumenton detyrueshmërinë e namazit me xhemat”**. Ata u argumentuan me disa hadithe ndër të cilat ishin edhe tre hadithet që i përmendëm në fillim të kapitullit. Sipas tyre njeriu që falet në shtëpi pa arsye ka bërë gjynah, edhe pse namazin e ka kryer, ngase prezencën në xhami nuk e konsiderojnë kusht për pranimin e namazit. Ata thonë se një njeri i tillë është mëkatar për këtë mungesë në xhami. Personin e tillë e konsiderojnë mynafik, por jo me besim, mirëpo në veprat apo punët e tij, ngase thonë përderisa ai falet edhe kur është vetëm kjo tregon se ka besim në zemër, sepse po të ishte mynafik në besim, atëherë nuk do të falej kur mos ta shihte askush, mirëpo përderisa falet edhe kur është vetëm, atëherë ngrihet nga ai dyshimi i dyfytyrësisë në besim, mirëpo jo edhe ai i dyfytyrësisë në veprat e tij.

Dijetarët që mendojnë se kjo punë është sunet i fortë i Profetit, salallahu alejhi ue selem, argumentet e grupit të parë i kundërshtojnë kësisoj.

Për hadithin e cekur në fillim, pra për fjalën: *“A e dëgjon ezanin, atëherë përgjigju atij.”* thonë se Ibën Umi Mektumi dëshiroi mospraninë në xhami duke mos i munguar shpërblimi.


Hadithi i djegies së shtëpive me zjarr sipas

tyre, pasi nuk ndodhi kjo gjë do të thotë, se sikur të ishte një mendim i tillë, që me të vërtetë duhej praktikuar medoemos, atëherë i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, do ta bënte menjëherë duke mos u vonuar në kryerjen e urdhrave të Allahut.

Sa i përket hadithit, se ai që e dëgjon ezanin e nuk i përgjigjet nuk i pranohet ai namaz e arsyetojnë se në të u përmend fjala *“përveç atij që ka arsye”* e përderisa paska përjashtime, atëherë tregon se ky kërcënim nënkupton se nuk është për qëllim farzi, por inkurajimi tek e mira, sepse po të ishte farz, nuk do të kishte kurrfarë arsytimi për mosparaqitjen, sepse lënia e farzeve nuk arsyetohet me asgjë.

Unë nuk dua të fokusohem duke mbajtur qëndrim të prerë për njërin apo tjetrin mendim, se cili do të ishte më i sakti dhe i vetmi i pranuar, sepse këtë gjë do t'ia lë çdo besimtari ta konstatojë për vete. Mirëpo dua të theksoj se mendimi që thotë se namazi me xhemat është farz ka shumë argumente, përveç atyre që i përmendëm të tillë. Ndërsa mendimi se falja në xhami është sunet, sipas asaj që kam lexuar unë, nuk ka ndonjë argument që do ta mbronte fuqishëm mendimin e tyre, por ata e mbrojnë këtë tezë me komentimin e argumenteve të mendimit të parë.

Lusim Allahun të na bëjë prej atyre që jo vetëm e falin namazin, por prej atyre që nuk mungojnë nga falja e namazit me xhemat në xhami, sepse ajo që më së paku mund të thuhet është fakti se paraqitja nëpër xhami është lidhje më e fortë me Allahun, afrim dhe futje e dashurisë mes besimtarëve, lidhja e zemrës me xhaminë është shkak për futjen nën hijen e Arshit të Allahut atë Ditë, kur nuk ka hije tjetër pos asaj hije të vetme. ■



FETVA DHE KËSHILLA RRETH NAMAZIT¹

ME PËRGJIGJE NGA: ALI SHABANI

Pyetje: Në rastet kur falemi me xhemat dhe pasi imami ka marrë tekbirin fillestar, hasim që nga xhemati (d.m.th., atë që e kemi pranë) e thotë tekbirin në vete, nuk dëgjojmë zë apo të pëshpëritë shprehjen e tekbirit. A llogaritet hyrje në namaz me shprehjen në vetvete.

Përgjigje: Në emër të Allahut Mëshirëplotit Mëshirëbërësit. Shprehja e tekbirit kur e fillojmë namazin është nga shtyllat e namazit dhe ai (tekbiri) duhet të shprehet qartë (Allahu Ekber). Së paku sa të dëgjojë vetë falësi d.m.th., të lëvizë gojën (gjuhën), se përndryshe nuk llogaritet shprehje, por atëherë është e menduar. Namazi është ibadet në vepra dhe në shprehje. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“dhe kryejeni me rregull faljen,”** d.m.th., vepër dhe po ashtu ka thënë: **“pra, faluni duke lexuar Kuran sa t’ju vijë më lehtë prej namazit”** Muzemil 20, pra, leximi është kur e shpreh. I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem,

kur ia ka përmirësuar namazin atij që nuk diti të falet i tha: *Kur të ngrihesh për t’u falur merr mirë abdes, pastaj kthehu nga kibla dhe thuaj “Allahu Ekber”.* E përcjell Buhariu dhe Muslimi. Edhe Aisheja tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, kur e ka filluar namazin i ka ngritur duart në lartësinë e supeve dhe ka thënë “Allahu Ekber”, d.m.th. e ka dëgjuar kur e ka shprehur këtë.

Në një hadith të Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, thuhet: *“Allahu ia ka falur atyre që i përkasin umetit tim për atë që pëshpëritin në vetvete”.* Për shkak se nuk e kanë shprehur e si do të jetë halli i atyre që falen pa e shprehur tekbirin, falen duke lexuar me vete pa e lëvizur gojën (apo gjuhën)?! Imam Neveviu ka thënë: ... të tjerët përpos imamit, është Sunet ta thonë tekbirin fshehurazi, e më e ulëta është sa të dëgjojë ai vetë dhe kjo është e përgjithshme për tekbirin, tesbihin në ruku, teshehud, dua, salam e kështu me radhë. Imam Shafiu në “El-Um” ka thënë: I shpreh sa të dëgjojë vetë dhe ai që vijon pas tij dhe jo më shumë. (Shiko “El-Mexhmu” 3/ 295)

¹ Pyetjet janë parashtruar nga besimtarët vendas dhe diaspora nëpërmjet internetit.

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në revista@albislam.com

Pyetje: Në disa xhami hasim në çardakë ku rrinë muezinët me disa pjesëtarë të tjerë nga xhemati dhe ata kur falet farzi, nuk i bashkëngjiten xhematit, por falen në atë çardak, edhe pse ndodh që të ketë një largësi të madhe mes tyre dhe safit të fundit. Ndonjëherë ndodh që muezini të falet në mafil, ndërsa poshtë janë dy apo tre safe. Na tregoni a është në rregull kjo?

Përgjigje: Kjo që shpikin xhahilat nga bidatet nuk merr fund asnjëherë. E njëjta gjë është që nëpër xhamia i vendosin këto çardakë dhe faljen e kryejnë aty, edhe nafilet (sunetet), po edhe farzet pa marrë parasysh se ku ka arritur safi i fundit. Kjo gjë has së paku në dy ndalesa të të Dërguarit salallahu alejhi ue selem, E para: I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, e ka ndaluar që të caktojë dikush një vend në xhami dhe të falet vetëm aty siç bën deveja. E përcjell Ahmedi dhe tjerët. Shiko Silsile Sahiha nr. 1168. E dyta: Se bien në kundërshtim me urdhrin e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, në lidhje me safet. Ai salallahu alejhi ue selem, kur i ka parë disa nga sahabët, që nuk iu kanë bashkangjitur safit të fundit iu tha: *Ecnî përpara dhe më pasoni mua dhe plotësoni vendet e safeve që vijnë pas. Nuk do të ndalen njerëzit të rinë mbrapa e kështu Allahu do t'i lejë mbrapa* (do t'i vonojë). Do t'i vonojë, d.m.th. nga mëshira, apo nga hyrja në xhenet.

Në këtë gjë duhet të kenë kujdes edhe ata që falen në mafil lart, ndërsa poshtë nuk është e mbushur xhamia. Këtë gjë e bëjnë zakonisht disa myezinë, që i kanë lart mjetet e zërit dhe e dirigojnë xhematin nga lart.

Pyetje: Në këshillat e hoxhallarëve në lidhje me namazin kemi dëgjuar shpesh, se duhet përqendrim në namaz dhe mos të shikohet rreth e rrotull. Ata që shikojnë në drejtime të ndryshme në namaz, si e kanë hallin?

Përgjigje: Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët; ata që janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë*

faljes së namazit.” Muminun 1, 2 dhe e kundërta e kësaj në suren Maun: *“Pra, shkatërrim është për ata që falen, të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.”* Maun 4, 5. Nëna Aishe e ka pyetur Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, për kthimin e shikimit në namaz dhe ai ka thënë: *“Ajo është vjedhje që e vjedh shejtani nga namazi i robot.”* E përcjell Buhariu dhe tjerë. Edhe për ata që i ngrenë shikimet lart i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Le të ndalin ata që i ngrenë shikimet nga qielli gjatë namazit, ose nuk do t'u kthehet më (të shikuarit).”* E përcjell Muslimi.

Këto janë qortime të rrepta, por megjithatë pjesa dërrmuese e dijetarëve janë të mendimit, se namazi nuk prishet me kthim të shikimit, nëse është pak apo me shikim anash.

Hadithet për shikimin në namaz udhëzojnë që të shikohet poshtë, apo në vendin e sexhdes, përveç në etehijat, kur shikimi duhet të jetë tek gishti tregues i dorës së djathtë me të cilën bëjmë shenjë. Në hadithin që përcjell Ebu Davudi dhe të tjerë thuhet: *Shikimi i tij nuk e kalonte gishtin tregues.*

Në këtë temë dua të shtoj edhe atë që për të arritur përqendrimin në namaz nuk duhet të mbyllim sytë, siç veprojnë disa dhe mendojnë se ashtu është më mirë.

Pyetje: Hoxhë i nderuar na tregoni për ata që vazhdojnë bisedën në xhami edhe pasi është bërë ikameti dhe imami ka filluar namazin, a e kanë në rregull këtë veprim?

Përgjigje: Ndonjëherë ndodh që shejtani ua zbukuron disave bisedat e iu duken aq të rëndësishme, se sa edhe namazi, kështu që muezini e bën ikametin e ata e vazhdojnë bisedën e tyre. Hyjnë të fundit në xhami dhe dalin të parët. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, e ka ndaluar edhe namazin nafile të falet, nëse bëhet ikameti. Ai salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *Kur të bëhet ikameti, nuk ka më namaz, përpos namazit farz.* E përcjell

Muslimi 710. Pra, nënkuptohet se edhe gjërat e tjera duhet të ndërpriten në vend dhe besimtari t'u bashkohet safeve e të fillohet me namaz. Po ashtu ajo bisedë i pengon ata që kanë filluar namazin. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Me të vërtetë secili prej jush flet me Zotin e tij, prandaj mos e pengoni njëri tjetrin dhe mos e ngrini zërin ndaj tjetrit me lexim (të Kuranit) [apo ka thënë] në namaz.”* E përcjell Ebu Davudi dhe Ahmedi. Meqë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, i bën këto vërejtje për besimtarët, që mos të pengojnë njëri-tjetrin kur janë në namaz, atëherë jashtë namazit qortimi duhet të jetë edhe më i rreptë.

Nga rastet më të shëmtuara që kam hasur është rasti kur kam takuar në oborr të xhamisë disa njerëz duke biseduar, në kohën kur faleshin sunetet e para farzit. Pastaj është bërë ikameti dhe ka filluar farzi. Pas faljes së farzit kur jemi kthyer i kemi parë ata se si ngrihen ta vazhdojnë namazin edhe një rekat që u kishte ikur. Këta njerëz janë të dëmshëm për xhematin. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka porositur të largohemi nga të tillët. Ai ka thënë: *“Në kohët e fundit do të ketë njerëz të tillë, që rrinë në xhami rrathë-rrathë (grupe-grupe), imam kanë dynjanë, mos rri me ata, se Allahu nuk ka nevojë për ta.”* Silsile Sahiha nr. 1163. Ne sot po i shohim këto shenja nëpër xhamitë tona, ku zhvillohen biseda të tilla mes atyre që falen derisa përleshën në xhami, se nuk e kanë ndarë drejt atë, që e kanë vjedhur së bashku (duke u bazuar në fetvatë e atyre “hoxhallarëve” që thonë se bën të vidhet pasuria e jobesimtarëve), bëhet përgojim, shpifje dhe biseda të tjera, Allahu na ruajt.

Pyetje: A duhet t'i ketë gruaja të mbuluara edhe këmbët (shputat) kur falet në namaz?

Përgjigje: Shejhul Islami, Allahu e mëshiroftë ka përmendur se gruaja nuk është e detyruar t'i mbulojë edhe shputat gjatë namazit, pasi nuk janë auret.

Ndërsa për sa i përket hadithit të Umu Selemes, e cila e kishte pyetur Pejgamberin, salAllahu alejhi ue selem: *“A mund të falet gruaja vetëm me mantel dhe shami, por pa izar (veshjen e poshtme)?”*. Ai u përgjigj: *“Po, nëse manteli është i gjerë dhe i mbulon shputat e saja”*. Ky hadith edhe pse aludon se mbulimi i shputave gjatë namazit është detyrim shumë dijetarë këtë hadith e kanë vlerësuar si të dobët, madje kanë thënë: Nuk është i saktë nga Pejgamberi, salAllahu alejhi ue selem, e as nga sahabët, prandaj argumentimi me të nuk është i saktë.

Prandaj nëse dikush thotë se gruaja gjatë namazit duhet t'i mbulojë duart dhe shputat e saj, atëherë duhet të sjellë argument. Mbetet urdhri që ajo të ketë veshur rroba të gjata së bashku me shaminë, por hadithi tjetër: *“Gruaja është auret”* aludon që nëse ajo mbulon edhe shputat e saja në namaz është më mirë. Allahu e di më së miri.

(kjo përgjigje është nga Abdullah Feuzan. Marrë nga libri “el-Fetava el-xhamia lil mer’etil muslimë 1/182).

Pyetje: A lejohet të falet namazi me kapelë dimri, e cila e mbulon ballin, apo edhe me doreza, meqë disa e mohojnë namazin e atij që falet më kapelë që mbulon ballin, apo me doreza.

Përgjigje: Kapela që mbulon ballin apo dorezat nuk e pengojnë namazin dhe lejohet të falemi me to. Në hadithin që Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë, se *është urdhëruar të bëjë sexhde me shtatë gjëra dhe ka bërë shenjë nga fytyra (d.m.th., balli dhe hunda se janë një gjë e vetme), dy shuplakat, dy gjunjët dhe anët e gishtërinjve të këmbës.* Po të kushtëzohej se duhet që balli d.m.th., lëkura të preki në shesh dhe me duart po ashtu, atëherë edhe te këmbët do të duhej të mos veshim çorape. Po një gjë të tillë dhe këtë lloj kushtëzimi nuk e kemi dëgjuar nga i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, Allahu e di më së miri. ■

METODOLOGJITË BASHKËKOHORE NË SHKRIMIN E HISTORISË SË PERANDORISË OSMANE



Historianët, që punuan për njollosjen e Perandorisë Osmane u bazuan në falsifikimin e fakteve, gënjeshttrat, shpifjet, futjen e dyshimeve dhe intrigave. Në këto libra e studime mbizotëron fryma e inatit të verbër dhe motivet jo të mira, larg nga objektiviteti në çdo aspekt

DR. ALI MUHAMED SALABI

Historianët evropianë, çifutët, të krishterët dhe laikët (shekullaristët) keqdashës nuk u lëkundën aspak në sulmin e tyre mbi historinë e Perandorisë Osmane. Përdorën modelet e sulmit, shpifjes, kundërshtimit, shtrembërimit dhe futjes së dyshimit në tërë atë që bënë osmanlinjtë në shërbim të Akides dhe Islamit.

Këtë rrugë të gabuar e pasuan shumica e historianëve arabë me gjithë ndryshimet e tyre në përkatësinë dhe orientimin nacional e laik. Po ashtu këtë rrugë e ndoqën edhe historianët turq, të cilët u ndikuan nga orientimi laik, që udhëhiqej nga **Mustafa Kemal**. Andaj dhe është e natyrshme që këta njerëz ta dënojnë periudhën e kalifatit osman, për këtë gjetën shumë materiale të

shkruara nga të krishterët dhe çifutët për të ndihmuar përpjekjet e tyre nacionaliste e laike në Turqi pas Luftës së Parë Botërore.

Qëndrimi i historianit evropian karshi historisë osmane është për shkak të shqetësimit të tij për çlirimet (pushtimet) e mëdha që realizuan osmanlinjtë, e posaçërisht pas rënies së kryeqytetit të Perandorisë Bizantine, Kostandinopojës, qytet të cilin osmanlinjtë e shndërruan në Vend Islam (Daru Islam), madje ia vunë edhe emrin “Islam Boll” (që do të thotë: vend islam – daru islam).

Shpirtrat e evropianëve u mbushën me vrer e u helmuan dhe tendenca e tyre keqdashëse e zemërimi u trashëguan brez pas brezi kundër Islamit. Këto inate u reflektuan në fjalët, veprimet dhe shkrimet e tyre.

Osmanlinjtë vazhduan dërgimin e ekspeditave dhe përpjekjet e tyre për

bashkimin e Romës me shtetin islam, vazhduan xhihadin derisa depërtuan në mes të Evropës, dhe u përpoqën të arrijnë edhe në Endelus (Spanja e sotme) për t'i shpëtuar muslimanët atje. Evropa jetonte në frikë, në një shqetësim të vazhdueshëm, në drojë dhe nuk u qetësuan zemrat e tyre derisa vdiq Sulltani Muhamed Fatihu. Prijësit fetarë të krishterë, priftërinjtë e murgjit dhe mbretërit i ushqenin evropianët me urrejtje e nxitje kundër Islamit dhe muslimanëve. Puna e njerëzve të fesë krishtere ishte që të mblidhnin sa më shumë pasuri dhe njerëz vullnetarë për t'i luftuar muslimanët (të pafetë sipas mendimit të tyre) berberë. Sa herë që osmanlinjtë fitonin kundër këtyre grumbullimeve e ekspeditave, aq më tepër shtoheshin vala e urrejtjes dhe zilisë ndaj Islamit dhe ithtarëve të tij. Paria e krishterë i akuzonte osmanlinjtë me pirateri, brutalitet dhe egërsi, tërë këto akuza u shënuan dhe hynë në kujtesën e evropianëve.

Sulmet propagandistike nga prijësit e krishterë bëheshin për shkak të ruajtjes së përfitimeve të tyre politike e materiale, dhe për shkak të urrejtjes ndaj Islamit dhe ithtarëve të tij.

Çifutët iu bashkuan evropianëve me penat e tyre të helmuara, dhe me idetë e tyre të tërbuara në fushatën e sulmeve të vazhdueshme kundër Perandorisë Osmane në veçanti, dhe kundër Islamit në përgjithësi. Armiqësia e çifutëve kundër Perandorisë Osmane u shtua edhe më shumë pasi ata dështuan në të gjitha përpjekjet e tyre për të grabitur ndonjë pëllëmbë toke nga prona e kësaj Perandorie për të ngritur qenien e tyre politike (shtetin) përgjatë katër shekujve, sa zgjati jeta madhështore dhe krenare e Perandorisë Osmane.

Çifutët arritën me ndihmën e shteteve të krishtera dhe të shteteve kolonizatore perëndimore, dhe përmes lozhës së tyre masone, t'i realizojnë qëllimet e tyre për

llogari të sistemeve dhe organizimeve nacionale, që u ngritën në Botën Perëndimore dhe në Botën Islame, në të cilat ata e përshkruanin veten me përparim e civilizim, dhe e akuzonin Kalifatin Osman gjatë tërë historisë së tyre me prapambetje, jozhvillim, amulli, përkeqësim e dështim etj. Madje lozhat masone, organizatat sekrete, që u përkisnin çifutëve dhe forcat botërore kundërshtare të Islamit e muslimanëve u shprehën qartë se njollosja e epokës së famshme historike të Perandorisë Osmane është njëri prej synimeve më të rëndësishme të tyre.

Ndërsa, historianët arabë në Botën Islame pasuan këtë orientim sulmues ndaj epokës së Kalifatit Osman të shtyrë nga shumë shkaqe (arsye e faktorë). E para, iniciativa e turqve nën udhëheqjen e Mustafa Kemal Atatürkut për largimin e Kalifatit Islam në vitin 1924, duke e zëvendësuar me një pushtet laik turk, i cili në tërësi ishte i bazuar në programin laik në të gjitha segmentet shoqërore, ekonomike dhe politike, në disfavor të Sheriatit Islam, i cili kishte sunduar në Turqi, që nga ngritja e Perandorisë Osmane. Ky pushtet bëri aleancë me politikën evropiane, që ishte kundërshtare e shteteve islame e arabe. Një sërë aleancash ushtarake evropiane u bënë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, e të cilat i refuzuan popujt arabë e muslimanë dhe disa qeveri të tyre. **Turqia ishte prej vendeve të para, që e pranoi ngritjen e qenies politike të shtetit izraelit në Palestinë në vitin 1948, gjë që i bëri popujt arabë dhe muslimanë të jepen pas qeverive të tyre nacionale në mungesë të Perandorisë Osmane, e cila gjithmonë luftonte kundër çdokujt që kërcënonte ndonjë pëllëmbë të tokave muslimane.**

Pastaj vijon shkaku i nënshtrimit dhe i pasimit të studimeve të shkollës së historisë arabe, e cila e pason shkollën e historisë me plan-program perëndimor, që është një

faktor i rëndësishëm në orientimin ndaj sulmeve kundër Kalifatit Osman, veçanërisht meqë pikëpamjet e historianëve evropianë dhe të atyre arabë përputhen lidhur me njoftosjen dhe luftimin e Kalifatit Islam Osman.

Shumë historianë arabë u ndikuan nga civilizimi evropian material, dhe për këtë ata mbështetën gjithçka dhe çdo gjë që shkëlqente në historinë e vendeve të tyre, deri në fillimin e fërkimit të këtij civilizimi të largët me të gjitha përmasat e më pas të përplasjet me Programin Hyjnor. Fillimin e historisë së tyre të re e llogaritin, që nga arritja e ekspeditës franceze në Egjipt e në Sham, që rezultoi me shkatërrimin e murit izolues mes Lindjes e Perëndimit, e si pasojë u ngrit i pari shtet kombëtar në kohën e Muhamed Aliut në Egjipt. Tërë këtë e shoqëroi edhe orientimi i tyre për dënimin e Perandorisë Osmane, e cila ishte e angazhuar për mbrojtjen e besimit të popujve muslimanë, fenë e tyre-Islamin, nga sulmet e egra që iu bënin evropianët e krishterë.

Fuqitë evropiane inkurajonin idenë e kundërshtimit të Kalifatit Islam, dhe ndihmonin historianët e mendimtarët në Egjipt e në Sham për të rrënjësuar këtë ide në kuadër të strukturës nacionale atdhetare dhe forcimin e saj, si El-Bestani, El-Jazexhi, Xherxheri Zjednani, Edib Is'hak, Selim Nekash, Ferah Antoan, Shibli Shemil, Selame Musa, Henri Korijel, Helil Shvarc etj. Vërehet se shumica prej tyre janë të krishterë dhe çifutë, sikurse vërehet që shumica prej tyre, jo të gjithë, edhe pse nuk i takonin lëvizjes mase punonin për interesat e tyre, lëvizje e cila filloi të përhapej në Lindjen Islame që nga koha e Muhamed Aliut, dhe rrënjët e para i lëshoi me ardhjen e Napoleonit me ekspeditën e tij.

Armiaqtë e Islamit e kuptuan se përkrahja e ideologjisë nacionale dhe ndihma e ideatorëve të saj është një sigurim për dobësimin e Umetit Islam dhe shkatërrimin e Perandorisë Osmane.

Lozha masone arriti të dominojë në kokat e liderëve të orientimit nacional përbrenda popujve muslimanë, këta iu nënshtruan ndikimit të lozhës masone më tepër se sa kërkesave të popujve të tyre, e sidomos me qëndrimin e tyre ndaj Fesë Islame, e cila edhe pasqyron formën reale të civilizimit musliman, kulturës dhe shkencave të tij. Kjo metodologji e devijuar nuk ndryshoi te historianët arabë as pas grushtit të shtetit ushtarak që ndodhi në Egjipt dhe që në fillim si shumica e pushteteve ushtarake përkrahu orientimin nationalist. Shumë prej këtyre pushteteve u përqendruan në themele që thuajse ishin tërësisht laike në të gjitha aspektet, ndër to edhe aspekti kulturor e ideologjik. Ata e konsideronin Kalifatin Osman dhe pushtetin e tij mbi popujt muslimanë e arabë si një luftë dhe një pushtim. Ia veshën këtij pushteti të gjitha fajet dhe faktorët e ngecjes, dobësimit, ngurtësisë dhe prapambetjes, të cilat e përfshinë Botën Arabe dhe atë Islame. Lëvizjet për shkëputje e kryengritje gjatë kohës së Perandorisë Osmane, e që në fakt si motiv kishin lakmitë personale, ose ishin të nxitura nga forcat e jashtme, që ishin kundërshtarë të Kalifatit Islam, i konsideruan si lëvizje çlirimtare për pavarësi, duke iu dhënëtribute kombëtare; si lëvizja e Ali Bej el-Kebirit në Egjipt, kirmanilët në Libi, Dhahir el-Umer në Palestinë, husejnitët në Tunis, manitët dhe shihabitët në Liban, e të tjerë. Tërë kjo u bë që të rrënjësojë orientimin nacional kombëtar, të cilin ata e futën si ide, madje pretenduan se Muhamed Aliu ishte një udhëheqës kombëtar, që u mundua ta bashkojë Botën Arabe, por dështoi sepse nuk ishte arab me origjinë. Ata harruan se Muhamed Ali kishte lakmi personale, arsye për të cilën ai u lidh me politikën kolonizuese, e cila ndihmoi në ekzistencën e tij. Përmes tij u realizuan synimet e tyre të dëmshme duke sulmuar shtetin saudit dhe duke dobësuar Kalifatin

Osman. Ai pati si mbështetje edhe lozhën masone, e cila e ndihmoi në goditjen e forcave islame në rajon dhe parapërgatiti për push-timin perëndimor të krishterët keqdashës.

Lozha çifute bëri aleancë me fuqitë kolonizatore perëndimore, si dhe me forcat vendore që ishin agjentë e spiunë, e cila u mundësoi atyre nënshtrimin e këtyre njerëzve përmes lakmisë. U mblohdën që të gjithë për shkatërrimin e forcës islame dhe heqjen e lirisë për popujt e saj (islamë), grabitën të mirat e saj, vendosën një pushtet diktator të pajisur me armatim modern perëndimor, e të cilin e përfaqësonte Muhamed Aliu. Disa historianë në Lindjen Arabe u bashkuan me të tjerët në sulmet e tyre ndaj periudhës osmane të shtyrë nga qëndrimi armiqësor, që pati roli i Kalifatit Osman kundër thirrjes selefite në disa etapa të saj për shkak të kompleteve të vendeve kolonizatore perëndimore, gjë e cila i bëri sulltanët osmanë të përplasen me forcat islame në Nexhd për ta mbytur thirrjen selefite. Po ashtu edhe për shkak të mbështetjes, që i dha Perandoria Osmane orientimit sufist, i cili filloi ta shoqërojë atë, dhe i jepte një pamje që nuk përkonte aspak me aspektet themelore të Sheriatit Islam. Përveç kësaj në vitet e fundit të Perandorisë, nacionalistët turq mbizotëruan në të, dhe ishin ata që e larguan pushtetin nga praktikimi i programit islam, me të cilin u shqua Perandoria Osmane për një kohë të gjatë të historisë, dhe që kishte nxitur të gjithë muslimanët të lidheshin me të, ta përkrahnin dhe ta ndihmonin. Ndërsa historianët marksistë nisën një luftë të ashpër kundër Perandorisë Osmane, duke e konsideruar kohën e pushtetit të saj, si një epokë dedikuar udhëheqjes feudale, e cila dominoi mbi historinë e etapave të kaluara të mesjetës, se osmanlinjtë nuk shpikën asnjë përparim në mjete apo në fuqinë prodhuese. Se historia moderne filloi me shfaqjen e klasës borgjeze,

pastaj të kapitalizmit, e cila kontribuoi në ndryshimin e aspekteve ekonomike dhe shoqërore në fillim të shekullit XIX. Ata u takuan në këtë pikë me historianët evropianë ithtarë të liberalizmit, si dhe me ithtarët e botëkuptimit nacionalist. Disa historianë dhe ideologë të krishterë e çifutë filluan t'i vënë në qarkullim të dy pikëpamjet, perëndimore dhe marksiste, përmes shkrimeve dhe përkthimeve të veprave të tyre, gjë të cilën e mbështeti edhe lozha masone.

Ata u përpoqën që të largohen nga çdo gjë që i përket konstruktit unik islam, duke i dhënë vlerë e përparësi thirrjes për nacionalizëm në botëkuptimin vendor-lokal apo arab, si projekti Gjysmëhëna pjellore në Sham, apo projekti për bashkimin e Luginës së Nilit, që është e ndarë mes Egjiptit dhe Sudanit, duke i shtuar kësaj edhe aktivitetet e tyre për qarkullimin e pikëpamjeve nacionaliste të kufizuara, si thirrja për faraonizëm në Egjipt, ashurizëm në Irak, fenikizëm në Sham etj. Ndërsa historianët turq, të cilët u shfaqën në kohën e thirrjes nacionaliste turke, e diskriminuan shumë epokën e Kalifatit Osman, që ishte në pajtim me pikëpamjen politike e ideologjike, e cila mbretëronte në vendin e tyre, dhe e cila e fajësonte epokën paraprake për të gjitha aspektet e dobësisë e të dështimit. Apo për shkak të ndikimit të turqve nga gjendja e turpshme në të cilën kaloi autoriteti i Kalifatit, dhe që ishte krejt formal pas rrëzimit të Sulltan Abdulhamitit në vitin 1909, ku pësoi disfatë në disa beteja me hyrjen në Luftën e Parë Botërore, që si pasojë pati humbje të mëdha të tokave të saj dhe dorëzimin e saj me nënshkrimin e marrëveshjes më 1918, e cila në realitet ishte disfatë e njerëzve të Bashkimit dhe Përparimit dhe si rezultat i politikës së tyre. Ndërkohë që lëvizja nacionaliste nën udhëheqjen e Mustafa Kemalit arriti ta shpëtojë Turqinë nga ky ofendim dhe rimori shumicën e tokave

turke, dhe e detyroi Greqinë së bashku me forcat që e mbështetën, të marrë anën e influencuar të mendimtarëve turq lidhur me qëndrimin e disa arabëve, të cilët i mbështetën aleatët e tyre perëndimorë gjatë Luftës së Parë kundër shtetit të Kalifatit dhe shpallja e kryengritjes më 1916.

Pavarësisht nga ndryshimet dhe dallimet e shkaqeve, shumica e historianëve bashkohen në pikëpamjen e tyre për njollosjen, shtrembërimin dhe falsifikimin e historisë së Kalifatit Islam Osman. Historianët, që punuan për njollosjen e Perandorisë Osmane u bazuan në falsifikimin e fakteve, gënjeshtat, shpifjet, futjen e dyshimeve dhe intrigave. Në këto libra e studime mbizotëron fryma e inatit të verbër dhe motivet jo të mira, larg nga objektiviteti në çdo aspekt. Kjo shkaktoi paraqitjen e kundërveprimit islam për t'i prapësuar dyshimet dhe akuzat drejtuar Perandorisë Osmane, e ndoshta libri më i rëndësishëm e më i spikatur me këtë shtjellim të hollësishëm është libri në tre vëllime të mëdha i **dr. Abdulaziz Shenavit** me titull: "Perandoria Osmane është një shtet islam që i është bërë shpifje". Edhe pse ka dhënë një kontribut të çmueshëm me motive islame dhe me një objektivetet që e shquan në shumicën e punës së tij, prapëseprapë nuk ka arritur t'i trajtojë të gjitha aspektet e historisë osmane. Ai ka edhe disa vërejtje, si rasti kur flet për jeniçerët, gjë e cila nuk qëndron dhe nuk përkon me një studim shkencor të paanshëm. Prej arritjeve të çmuara në këtë fushë është puna e shkencëtarit të madh dhe profesorit të njohur i specializuar në historinë e Perandorisë Osmane **dr. Muhamed Harbit**, i cili shkroi për Umetin Islam disa libra me vlerë, si: "Osmanlinjtë në Histori dhe në Civilizim", "Sulltani Muhamed Fatih, Çlirimtari i Kostandinopojës dhe Ngadhënjimtari mbi romakët", "Sulltan Abdulhamiti, i fundit i sulltanëve të mëdhenj osmanë".

Puna e **dr. Muvefak Beni el-Merexhe** është

shumë e vlefshme në shërbim të historisë së Perandorisë Osmane në punimin shkencor me të cilin ka mbrojtur titullin e magistraturës me titull: "Ndërgjegjësimi (zgjimi) i njeriut të sëmurë, apo Sulltan Abdulhamitit, apo Kalifatit Islam". Ky libër arriti të shpjegojë shumë fakte, i ndihmuar edhe me dokumente, argumente e prova të pakundërshtueshme. Ka edhe shumë autorë të tjerë bashkëkohorë, që kanë shkruar në këtë fushë, por ekzistojnë disa aspekte në historinë e Perandorisë Osmane, dhe në historinë tonë islame në kohën e re, që duhet të rishikohen nga pikëvështrimi islam, dhe që do të kontribuonin në paraqitjen më të mirë të fakteve, ngase mbledhja dhe formimi i këtyre gjërave, që po lulëzojnë vijnë si rezultat i thurjes së historisë sonë nga pikëvështrimi nacional ateist, dhe që u shërbejnë armiqve tanë në radhë të parë, madje edhe i kanë shfrytëzuar si një prej mjeteve për përçarjen e popujve muslimanë.

Prandaj kur të shkruajmë historinë e re duhet të shpjegojmë e të spikasim rolin e lozhës masonë, planet dhe projektet perëndimore në orientimin e kësaj thurjeje të keqe historike, gjë të cilën e organizojnë një grup agentësh çifutë e të krishterë, e të cilët kanë si orientim sistemin liberal e laik, ku bëjnë shfaqjen e elementeve masonë në sheshin historik, si dhe duke e vendosur rolin e lëvizjes masonë përkrah me lëvizjet çlirimtare. Historia e vjetër dhe e re islame është cak i sulmeve nga forcat armiqësore ndaj Islamit, duke pasur parasysh se ajo është një anije ideologjike dhe edukative me dekada në ndërtimin dhe formimin e identitetit të popujve muslimanë.

Allahu është prapa synimeve të secilit dhe Ai është Udhëzuesi për në Rrugën e Drejtë!

Marrë nga libri: "Ed devletul uthmanijetu, avamilun nuhudi ves sukut" ■

Nga arabishtja: Bahri Curri